

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7733 E diel 9 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës
Mbrëmjen e 7 dhjetorit, 1001 delegatët e Kongresit të Partisë Kristian-Demokrate gjermane (CDU) zgjidhën në Hamburg me 51,7 për qind të votave ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE
Pse dhe si fitoi zonja AKK, pasardhësja e Angela Merkel?


Opinion i Ditës
Ky vend ka shpresë! Po, këtë gjë mund ta them me shumë bindje dhe kurajë sot, 5 ditë pasi studentët qëndrojnë në shesh. Ky vend ka shpresë! Po, ka ...
Vijon në faqen 22

Nga BLENDI FEVZIU
Pas protestës së studentëve, ky vend ka prapë shpresë




“Përse bien këto daulle” e nxeu Mehmetin

Kujtimet e Piro Milkanit: Kritikat për filmin, Kadare tha “E kanë me mua”

“Dasma ime me pianisten Margarita Kristidhi dhe penalizimi se mungoi në punë dy ditë”

FATMIRA NIKOLLI

Një vajzë e bukur çeke, që shkollohet me të e fle një kat më lart në konviktin e tij dhe me të cilën ka pasur dikur një flirt të bukur dashurie, tashmë ka humbur prej dyzet vjetësh në ndarjen e madhe të ideologjisë së dy ...
Në faqet 10-11

TE RINJTE PARALAJMEROJNE: PO NUK U PLOTESUAN KERKESAT, GREVE URIE

STUDENTET, REFUZIM NIKOLLES NE PROTESTE: S'KA KOMPROMIS

Ministrja e Arsimit zbret të takojë të rinjtë: ‘Ejani të dialogojmë’. Mediat e huaja pasqyrojnë protestën. Studentët rreshtojnë emrat e pedagogëve të korrumpuar



(Në foto) Studentë duke protestuar përpara Ministrisë së Arsimit

Në faqet 2-3

PRESIDENTI

Meta: ‘E duam Shqipërinë si gjithë Europa’ mbetet aspiratë

Në faqen 4

VAZHDON PROTESTA

Basha: Projekti i Unazës, janë bërë pazare të dyshimta me kompaninë

Në faqen 5

KOMPANIA E DYSHIMTE

Unaza/ Gjikhuri: Zgjidhim kontratën, nëse do konfirmohet falsifikimi në SHBA

Në faqen 12

RASTI “KAÇIFAS”

Tension në Bularat, nëna e ekstremistit grek kërcënon Edi Ramën: Do të të vras

Në faqet 6-7

“MILOSAO”



Po sikur të bënim modelin irlandez për historinë, që ia shkroi pushtuesi

Suplement

EMRAT/ Ndërtimet pa leje, ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë

Legalizimet, 350 familjet që marrin lejet

Ndërtimet pa leje, procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga Agjencia

ALUIZNI publikon listën me 350 pronarët që kanë gati lejet e legalizimeve në qarkun Tiranë. Sipas ALUIZNI, të gjithë personat që gjejnë emrin në listat e afishuara duhet të paraqiten pranë Drejtorisë për të tërhequr lejen. Bazuar te ndryshimet e fundit ligjore, qytetari duhet të



marrë një kopje për të vërtetuar përmbartimin e procesit të legalizimit. Ndërsa, lidhur me procedurën vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ajo do të bëhet nga Agjencia.TAPIA Procedurat për marrjen e tapisë janë ...

Në faqet 8-9

PROTESTA KERKESAT



KRYEMINISTRI

Në Tiranë ka disa protesta, por kryeministri Rama sipas mediave turke, ndodhet në Turqi, ku ka zhvilluar edhe një takim me presidentin Rexhep Tajip Erdogan, i cili e prit në Pallatin Beylerbeyi në Stamboll. Nuk ka një njoftim të vizitës së Ramës në Turqi, ndërsa kjo është bërë e ditur nga faqja zyrtare e presidentit turk.



AXHENDA

Studentët do të dalin sërish sot në protestën e nisur prej disa ditësh, duke kërkuar që të plotësohen kushtet e tyre dhe pastaj do të tërhiqen. Ata premtuan se do të protestojnë derisa të plotësohen kërkesat që kanë shtruar. Studentët publikuan axhendën për sot, ku sërish do të mblihen tek Ministria e Arsimit.

Ministrja, studentëve: Më kërkuat, dola! Kur do flasim për problemet?

Studentët në shesh, Nikolla për "News 24": Ejani të dialogojmë

"Biseda me kryeministrin për zgjidhjen e situatës"

Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla thekson se është shumë e rëndësishme të nisë sa më shpejt dialogu me studentët. Deklaratat Nikolla i bëri në një lidhje telefonike për "News 24". "Ne do të ecim përpara me komunikim për të adresuar të gjitha shqetësimet që studentët kanë. Nuk dua të komentoj ngjyrimet politike. Në sytë e mi sot prevalojnë studentët dhe shqetësimet e tyre. Shqetësimet e studentëve janë shqetësimet e mia", theksoi Nikolla. Lidhur me përgjysmimin e tarifave studentore, ajo bëri të qartë: "Të ulemi ta diskutojmë me rektorët e dekanët, pasi tarifat nuk përcaktohen nga qeveria, por nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Kemi dëshirë për një proces konkret për shqetësimet që ata kanë". Një ndër kërkesat e studentëve është ndryshimi i ligjit të arsimit të lartë dhe për këtë ministrja u shpreh: "Nuk ka reformë perfekte, por çdo gjë është e mundur kur ka komunikim dhe dialog". Nëse studentët nuk ulen për komunikim? "Nuk dua të ngre hipoteza mbi një shtresë që është pasuria e kombit. Ata janë djem e vajza të rritur në demokraci, që e dinë që komunikimi e konsensusi janë armët më të forta", deklaroi ministrja e Arsimit. Zj.Nikolla pyetjes nëse protesta e studentëve është apolitike, iu përgjigj: "Nuk dua të komentoj fare



Ministrja e Arsimit,
Lindita Nikolla

ngjyrimet politike, i kam ndjekur edhe reagimet politike, por ajo që më shqetëson janë vetëm kërkesat e studentëve. Ato janë kryesorja". Dhe nëse do ulen tarifat, si do bëhet kompensimi? Nikolla iu përgjigj: "Nuk është një përgjigje që jepet me një fjali, por do flasim specialistët, studentët e familjet". E pyetur nëse do të dorëhiqet Lindita Nikolla, dha këtë përgjigje: "Kam menduar shumë gjëra, por ajo që shqetëson është zgjidhja e problemit dhe studentët të kthehen sa më shpejt në klasa". Ndërsa lidhur me bisedën që ka bërë me kryeministrin Rama për çështjen e studentëve, ajo deklaroi: "Rama ndjek me

shumë shqetësim dhe seriozitet protestën. Patjetër që ka komunikim dhe kryeministri është i hapur për komunikim e dialog me studentët. Nuk flasim për negociata, flasim për komunikim për të ecur para me shumë çështje që studentët ngrënë". Më herët ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla, u shpreh për vetingut në arsim, ndërsa tha se do të verifikohen shqetësimet e tyre dhe më pas, nëse ato vërtetohen, do vepronë organet. "Unë duhet të marr informacionin e plotë se kush janë emrat, por janë institucionet që do ta ndjekin këtë shqetësim dhe për ta vërtetuar sa përpunet shqetësimi i tyre me realitetin. Për këdo që ka

DEKLARATA

"Dëgjova thirrjet nën dritare 'Lindita dil në shesh!' dhe dola. Dola dhe jo që nuk më tha kush pse u thirra, por u refuzova! S'ka asnjë problem, por pyetja ime është e thjeshtë: Kur do të ulemi të flasim për problemet dhe të bashkërendojmë forcat për të adresuar zgjidhjet?", deklaroi ministrja Nikolla.

ushtruar korrupsion, organet e drejtësisë do vepronë", theksoi zj. Nikolla. Ministrja e Arsimit pasi u refuzua nga studentët, reagoi në "Facebook". "Prej tri ditësh jam në zyrë e gatshme të takohem me studentët për të biseduar sy më sy. Si ka mundësi që të protestohet dhe të mos dialogohet, kur je i ftuar t'i shtrosh në tryezë kërkesat? Si mund të bëhet një punë e mbarë me ultimatumet dhe si mund të adresohet për më tepër problematika komplekse e universitetit, me kërkesa ultimative për tema shumë serioze, që meritojnë të trajtohen seriozisht? Si mundet që një protestë kaq e mbarë në qëllimin e saj të afishuar, të mos artikulojë akoma një përfaqësi për dialog me qeverinë?", deklaroi zj.Nikolla.



Protesta e djeshme e studentëve

SHKURT

Studentët në "Kjo Javë": Pse e përzumë ministrin nga protesta

Në ditën e katërt të protestës studentore, të ftuar në studi non e emisionit "Kjo javë" ishin dy studentët, Agref Tafaj dhe Skerd Nazifi, të cilët komentuan edhe largimin e ministres së Arsimit, Lindita Nikolla. Njëri nga ata u shpreh se studentët u acaruan për faktin që ajo doli nga hiçi, pa një njoftim paraprak apo organizim, ndaj edhe e larguan nga protesta. "Ne e kemi thirrur prej ditësh, ndërsa sot pa asnjë lajmërim u shfaq. Ky është problemi, se ajo nuk doli pa lajmëruar. Nuk mund të dilte nga hiçi, aty duhet të ketë një organizim. Të gjithë ishim të hapur që zonja ministre të ishte aty. Ç'problem do kishte që një person të dilte dhe të njoftonte se kjo do të dilte", u shpreh studentit.

Aktorja Andrea mbështet studentët: Uroj t'ia dalin, të bëjnë ndryshimin

Në mbështetje të studentëve është edhe aktorja Ema Andrea. Aktorja tha se më në fund rinia nuk është më ajo e "Instagram"-it. "Kam ardhur sepse më në fund nuk është më rinia e Instagram-it që e kemi gjykuar dhe paragjykuar, por është një rini me aksione të vërteta. Kam ardhur t'i mbështes dhe t'i shikoj. Nuk dua të marr protagonism, por nëse fjala ime shërben, do të doja që kjo rini të vazhdojë kështu dhe kjo protestë të dalë me përfundime konkrete, në mënyrë që arsimi të krijohet individë edhe jo konkursin kush është më i miri për të mbërritur diku. Uroj që ata t'ia dalin të bëjnë ndryshimin në mënyrë qytetare. Uroj që të jetë fillim i mbarë për një demokraci të vërtetë. Unë uroj që kërkesat e tyre të bëhen edhe më thelbësore se ato bazike që kanë", deklaroi zj.Andrea.

Thirrja



PEDAGOGIA
Pedagogia Entela Kasi u bëri dje thirrje studentëve të qëndrojnë të bashkuar, të luftojnë pa kompromis për kauzën e tyre dhe të mbajnë larg të gjithë ata që vetëquhen shoqëri civile, apo pedagogë të paguar nga qeveria për t'u prishur protestën.

Ushqimet



BANORJA
Një banore u premtoi banesë studentëve, teksa u sollti ushqime dhe ujë. Ajo u tha të rinjve se të gjitha ata që janë nga rrethet dhe nuk kanë ku të flenë, mund të shkojnë tek shtëpia e saj të kalojnë natën.

Shoferi



MARSHIMI
Një shofer autobusi ndali dje në rrugë dhe e shoqëroi marshimin me rënie borie dhe duke shtrënguar duart me të rinjtë si një shenjë solidarizimi dhe kurajoje për të mos hequr dorë deri në arritjen e synimeve të tyre.

Inkurajimi



KISHA
Ne inkurajojmë studentët dhe institucionet arsimore dhe universitare në gjetjen e një gjuhe dialoguese për të mirën e të rinjve universitarë".

PROTESTA

"Turp"! Studentët para ministrisë denoncojnë emrat e pedagogëve të korruptuar

7 orë protestë, studentët s'ndalin rezistencën: Edhe grevë urie

Policia ndan banorët e "Astirit" me të rinjtë



Valentina Madani

Jo vetëm nuk i ndali shiu që binte dje në Tiranë, por përkundrazi, studentët paralajmëruan se nuk do t'i ndalë as bora deri në plotësimin e kërkesave të tyre. "Nuk na ndal shiu/ Nuk na ndal bora/Ne jemi studenta, juve jeni hora", thërrisnin studentët. Për 7 orë me radhë, ata qëndruan dje para godinës së Ministrisë së Arsimit për të kërkuar plotësimin e kërkesave të tyre, që kanë të bëjnë me përgjysimin e tarifave dhe përmirësimin e kushteve. Kërkesat e tyre kanë avancuar duke kërkuar dhe veting të pedagogëve. Protesta e studentëve ka hyrë në ditën e saj të pestë. Edhe dje, pas mbledhjes përpara fakulteteve, ata marshuar në drejtim të Ministrisë së Arsimit. Në këtë rrugëtim, ata morën edhe mbështetjen e qytetarëve. Të shumtë ishin qytetarët që i janë bashkuar protestës së tyre për arsim cilësor, kushte më të mira në konvikte dhe uljes së tarifave vjetore. Plotësimi i dy kërkesave, për investime dhe heqja e pagesës për kredite në lëndët e mbartura nuk e kanë zbehur fuqinë e protestës. Edhe dje, ata kanë shprehur vendosmërinë për të mos u tërhequr deri në realizimin e çdo kërkesë drejtuar Ministrisë së Arsimit.

DENONCIMI
Studentët denonuan edhe disa prej pedagogëve, të cilët i kanë akuzuar për korrupsion. Një student me megafon lexoi emrat e pedagogëve që ata i denoncojnë se marrin lekë për provimet. Madje, ngjitur me emrin ata kanë vendosur dhe shifrën që duhet paguar që varion nga 100-1000 euro. "Pedagogë të korruptuar jeni murtaja e shoqërisë", - thërrisnin studentët. Duke u përgjigjur edhe akuzave të Edi Ramës, studentët ironizuar ndaj tij. Një prej tyre



MBËSHETETJA
Në ditën e katërt të protestës së tyre, studentët janë mbështetur edhe nga banorët të shumtë të kryeqytetit. Taksistët dhe shoferët e autobusëve u solidarizuan dje me studentët në protestën e tyre. Të bllokuar në trafik, shoferët dhe taksistët kanë inkurajuar studentët, duke përhëndur dhe mbështetur protestën e tyre.

është edhe një studente e Mjekësisë, e cila shkruan se "është ngelëse, sepse ka ngelur në Shqipëri". "Çohuni nga kafet, çohuni nga kafet, bashkohuni me ne", ishin thirrjet në kor të studentëve, të cilët shmangën Kryeministrin dhe marshuan drejt Ministrisë së Arsimit.

REFUZIMI
Po ashtu, studentët refuzuar edhe bisedën me ministrin e Arsimit, Lindita Nikolla, e cila tentoi të takohet me ta përpara Ministrisë së Arsimit. Ata u shprehën se nuk janë të hapur për asnjë negociatë dhe se do të rikthehen në auditorë vetëm kur çdo kërkesë e tyre të plotësohet. "Nëse nuk plotësohen të gjitha kërkesat, protesta do të përshkallëzohet dhe do të futemi edhe në grevë urie", kanë lëshuar ultimatumin studentët. Gjatë fjalimeve të tyre ata

ripërsëritën edhe 3 (nga katër) kërkesat e panegociueshme për qeverisë "Rama": Përgjysmimi i tarifave vjetore, përmirësimi i kushteve në konvikte dhe përfaqësimi i studentëve në bordet e universiteteve. Studentët qëndruan para ministrisë me thirrje për protesta: "O ministre që s'di këndim je ministre për Arsim", thërrisnin studentët. Të tjera thirrje janë "Bashkohuni me ne, jemi shumë, nuk tërhiqemi!"

"ASTIRI"
Protestës së studentëve dje tentuan t'i bashkoheshin edhe banorët e "Astirit", të cilët preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe. Por studentët nuk pranuan pasi i druhen politizimit të saj. Një kordon policor ndau studentët me banorët e "Astirit". Por, edhe vetë studentët krijuan kordonë nëse dalin me pankartat

Unazës së Re. Studentët e konsideruan protestën e tyre politike. "Nëse do të vinin të bashkoheshin me ne, ata të bashkoheshin që në mëngjes protestës tonë", thanë studentët ndërkohë një banor shprehet: "Protesta jonë është pasdite, ne kemi ardhur për solidaritet. Kërkesat tona janë ekonomike, po mbrojmë shtëpitë". Për një moment pati përplasje dhe konfrontim mes tyre dhe ndërhyri policia. Ndërkohë që banorët e "Astirit" u bënë thirrje që të bashkoheshin, pasi aty janë si qytetarë dhe prindër studentësh. "Nuk jemi me politikanë këtu me vete, shikoni, jemi prindër, unë kam djalin student, ma ka ndaluar policia", - deklaroi një nënë. "Jo ne do bëhemi gardh studentësh. Dhe nuk ndalojmë. Ata mund të na bashkoheshin vetëm nëse dalin me pankartat

tona dhe thirrjet në mbështetje tonë", thanë studentët.

SOLIDARIZIMI
Paralelisht me protestën e madhe që po zhvillohej përpara Ministrisë së Arsimit në kryeqytet, edhe studentët e Universitetit të Shkodrës, Luigj Gurakuqit, mëngjesin e djeshëm vijuan protestën. Pavarësisht nga shiu i madh, qindra të rinj u mbledhën sërish në sheshin "2 Prilli" dhe kanë deklaruar, se nuk do të ndalen deri në plotësimin e të gjithë kërkesave të tyre. Studentët e Luigj Gurakuqit përveç solidarizimit me kërkesat e protestës në Tiranë kërkojnë edhe uljen e notës mesatare në shkollë, sponsorizimin nga buxheti i Universitetit të Shkodrës i eks-peditave shkencore, si dhe vendosjen në efektivitet të plotë të godinës së re brenda janarit të vitit 2019.

"Sfiduan shiun dhe shtuan kërkesat", mediat e huaja për protestën e studentëve

Protesta e studentëve, e cila ka hyrë në ditën e katërt u pasqyrua edhe dje nga mediat e huaja. Mediat në Amerikë i kanë kushtuar një hapësirë protestës së studentëve dhe vendosmërisë së tyre për të arritur të ndryshojnë VKM-në për uljen e tarifës së studimit dhe përmirësimin e kushteve. Ato shkruajnë se studentët vazhdojnë protestën e tyre pa ndikime politike dhe nuk pranojnë asnjë dialog, nëse nuk plotësohen kërkesat e tyre. Duke iu referuar medias "Associated Press", në artikull thuhet: "Kërkesa kryesore është një përgjysmim i tarifave të shkollimit, të cilat për kurset bachelor variojnë nga 20,000 në 45,000 lekë në vit. Disa studentë kanë lënë të kuptohet se mund të fillojnë një grevë urie. 8 dhjetori konsiderohet si një festë kombëtare në Shqipëri, duke shënuar datën në vitin 1990, kur një protestë studentore rrëzonte regjimin komunist".

DITA E RINISË MESAZHET

PD kujton lëvizjen studentore '90. Basha: Ose veting, ose rrëzojmë parlamentin

Berisha: Dhjetor i dytë, studentët në betejë kundër regjimit të Ramës

Rudina Hajdari: Lë mandatin për t'iu bashkuar studentëve...

28 vite pas protestës studentore që rrezoi regjimin komunist, drejtuesit e PD-së kanë bindjen se ka ardhur koha që ajo të përsëritet. Kur protesta e studentëve ka hyrë në ditën e saj të 5 përpara Ministrisë së Arsimit, për ish-kryeministrin Sali Berisha dhe kryetarin e PD, Lulzim Basha shihet si shpresa për të risjellë ndryshimin që mori rrugë 8 dhjetorin e '90-ës. Tetë dhjetorin Ditën Kombëtare të Rinisë, Partia Demokratike dhe FRPD e përkujtuan dhe Qytetin Studenti, aty ku 28 vite më parë filloi edhe lëvizja studentore, që solli edhe rrëzimin e diktaturës komuniste e pluralizmin në Shqipëri. Një nga figurat kryesore të dala në atë kohë, ish-kryeministri Sali Berisha, risolli në kujtesë emocionet e atyre ditëve, ndërsa i quajti studentët e '90-ës heronj të pamposhtur. Me të njëjtat nota vlerësoi dhe protestat aktuale të studentëve. Berisha u bëri thirrje studentëve të vijojnë rezistencën dhe të mos dëgjojnë manipulatorët. Gjithashtu, u bëri thirrje shqiptarëve t'i mbështesin në të drejtë e tyre legjitime. "Sot kemi një dhjetor të dytë. Si asnjëherë tjetër universitetet e vendit kanë nisur një betejë të vendosur kundër një regjimi që quhet kaktivitë, një nga regjimet më të këqija dhe ky regjim është ai i Edi Ramës, i cili ka përdorur të gjitha pushtetet në duart e veta. Ky regjim ka varfëruar dhe largon shqiptarët nga Shqipëria. Studentët në lëvizjen e tyre po ngjallin shpresat shqiptarëve dhe unë duke u shprehur atyre mbështetjen më të fuqishme, u bëj thirrje shqiptarëve t'i mbështesin me të gjitha mundësitë e tyre. Mos dëgjoni ata manipulatorë që kërkojnë t'ju shkëpusin", theksoi z. Berisha. Ndërsa kreu i opozitës, Lulzim Basha, deklaroi se kjo është dita ku ne nderojmë studentët e dhjetorit, për kurajën për të sjellë lirinë politike për shqiptarët, ndërsa vlerësoi lart figurën e Azem Hajdarit, që siç thotë Basha, u bë shpirti i protestës. Lulzim Basha kish të njëjtin ultimatum për qeverinë e Ramës. "Mësimi i bashkimit të tyre është i qartë. E keqja s'rapset, e keqja mposhtet sa herë që shqiptarët e ndershëm janë bashkë. Këtë bënë qytetarët tek Unaza e Re, këtë bënë studentët sot. Le të bashkohemi të gjithë për të pastruar



Ish-kryeministri Sali Berisha, djete në Qytetin Studenti

BELIND KËLLIÇI

"Ky dhjetor po shndrit më i bukur se asnjëherë tjetër pas atij të vitit 1990. Ky dhjetor u tregoi edhe njëherë shqiptarëve se rinia është këtu, e fortë dhe e vendosur për të ndalur çdo padrejtësi që u bëhet atyre dhe vendit tonë. Ky dhjetor tregoi se vendi ynë ka shpresë!", tha kreu i FRPD.



Aktiviteti i PD-së me rastin e 8-dhjetorit në Qytetin Studenti

Presidenti inkurajon studentët e sotëm

Meta: "E duam Shqipërinë si gjithë Europa", aspiratë e perealizuar

Presidenti Ilir Meta u shprehur gjatë mirënjohje të gjithë studentëve, të cilët 28 vite më parë vërshuan në rrugët dhe sheshet e Tiranës me thirrjen "E duam Shqipërinë si gjithë Europa". Kreu i shtetit inkurajoi dhe mbështeti rininë e sotme, veçanërisht studentët që të marrin aktivisht pjesë në proceset demokratike për europianizimin e plotë të vendit dhe për ndërtimin e një të ardhmeje të sigurt të tyre në Shqipëri. "Mirënjohje të gjithë studentëve, të reja e të rinjve, të cilët 28 vite më parë vërshuan në rrugët dhe sheshet e Tiranës, me thirrjen që kumbonte 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa' dhe 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa', aspiratë e perealizuar".



ASPIRATA

"Jehona e thirrjeve 'Liri-Demokraci' dhe 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa' të 8 dhjetorit 1990 është ende një aspiratë, jo plotësisht e realizuar", - shprehet z. Meta.

duam Shqipërinë si gjithë Europa' dhe 'Liri-Demokraci', për të shndërruar 8 dhjetorin në ditën e tyre, Ditën e Rinisë, Ditën e Lirisë, Ditën e Europës. Kujtojmë me nderim veprën e Azem Hajdarit, liderit të lëvizjes studentore, i cili me guxim, kurajë e shpirt sakrificë frymëzoi ato minuta e orë vendimtare për mijëra

studentë, të rinj, pedagogë e intelektualë, për të kthyer në Shqipëri lirinë e munguar. Jehona e thirrjeve 'Liri-Demokraci' dhe 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa' të 8 dhjetorit 1990 është ende një aspiratë jo plotësisht e realizuar. Inkurajoj dhe mbështeti rininë e sotme, veçanërisht studentët, të cilët me shpirtin e tyre të lirë, energjinë, guximin e kurajën e pashembullt të marrin aktivisht pjesë në proceset demokratike për europianizimin e plotë të vendit dhe për ndërtimin e një të ardhmeje të sigurt të tyre në Shqipëri", shprehet z. Meta.

Monika Kryemadhi: Studentët na dhanë një leksion mua dhe Bashës

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, nuk e fsheh faktin se studentët i dhanë një leksion asaj dhe kreut të opozitës, Lulzim Basha, me rezistencën e tyre para qeverisë. "Studentët tanë na dhanë një mësim ne si politikanë, mua të parën dhe Bashës, për të na thënë se nuk kanë nevojë për të pritur kushtet për të ngritur zërin e protestuar, për të na thënë që qytetarët janë me ne, por duan besim, forcë dhe alternativë. Studentët na dhanë një mësim ne, klasës politike. Lëvizja studentore ishte leksion demokracie dhe shpresës", deklaroi zj. Kryemadhi gjatë një takimi me strukturat e LSI. Ajo u bëri thirrje drejtuesve të shtabeve elektorale në çdo qytet që të ndihmojnë dhe të përkrahin studentët me infrastrukturë. "Të ndihmojmë e të përkrahim studentët në çdo moment pa asnjë lloj kompleks. Jo vetëm t'i përkrahim, por edhe t'i ndihmojmë në infrastrukturë, dhe t'i bëjmë liderë të ardhshëm të politikës shqiptare", deklaroi zj. Kryemadhi.

Shoqëria përmbarimore JUSTITIA
Shoqëria përmbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e dytë, për shitjen e pasurisë së palajshme, për të cilat ka vënë hipoteke NGB Bank/ABI BANK, me këto të dhëna:
Lloji njësi me sip. 189 m2 nr.pasurie 5188nd-n1, z.8350 vol 28 fq.146 RR.Pj.Mezqari TIRANE në pronësi të z.Jejan Rahmi BAKULLI
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 179.760 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë) EUR
Lloji apartament sip.132m2 z.8350 nr.pas.5188nd-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Mezaqari TIRANE në pronësi të z.Jejan Rahmi BAKULLI
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 73.920 (shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë) EUR
Ankand zhvillohet në datën 09.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor, me adresë: Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studijustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria përmbarimore JUSTITIA
Shoqëria përmbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e dytë, për shitjen e pasurisë së palajshme për të cilin ka vënë hipoteke NGB Bank/ABI BANK, me këto të dhëna:
Lloji i pasurisë Aret-Trull (magazine dy kate) me sip. arë 3000 m2 / trull 1661/ ndërtesë 234,9 me nr.pasurie 58/9 vol 8 fq.78, z.1475, Dervan, KRUIJE në pronësi të Haki Ahmet MAVRICI
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 67.200 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) EUR
Ankand zhvillohet në datën 09.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studijustitia.com, tel. +355 4 2270890



Kreu i PD: Qeveria kërkon të përçajë studentët, çelësi i fitores është bashkimi

"Unaza", Basha: Qendro dhe Gjijnuri duhet të futen në burg

"Për projektin janë bërë pazare me kompaninë"

Valentina Madani

Banorët e Unazës së Re kishin sërish mbremë në krah të tyre kreun e opozitës, Lulzim Basha dhe garancinë e tij se do t'i mbështesë edhe pas 30 ditëve proteste. Me parullat "Shtëpia jonë, jeta jonë", "Këtu vendosim ne", "Shtëpitë tona i mbrojmë me gjak", "Me gjakun tonë ushqehet krimi", banorët kërkojnë plotësimin e kërkesave të tyre. Duke folur për projektin e Unazës së Re, Basha kërkonte që të merret në hetim kryeministri Edi Rama. "Duhet të merret në hetim urgjentisht Edi Rama, duhet të hetohet pasuria e tij dhe personave të lidhur me të. Duhet të veprojë drejtësia dhe këtë kërkon populli. Nëse nuk veprom drejtësia, historia na ka treguar që populli merr në dorë fatin e tij", theksoi kreu i PD-së. Me akuzën se për projektin e Unazës së Re janë bërë pazare me kompaninë, Basha ka bindjen e plotë se Edi Rama duhet të hetohet, pasi pas vjedhjes fshihet vetë kryeministri i vendit. "Sa herë që shqiptarët bashkohen, e keqja s'rapret. Është zbuluar në faqe të botës që këtu kemi të bëjmë me një vjedhje, ndërkohë që mbajmë në qeli banorët e Unazës së Re. Për të vjedhur 40 mijë euro tek Unaza, Rama së bashku me Veliajn kanë hedhur këtu dhunë, helmim e përçarjes. Kjo është një pjesë e helmimit që derdh Edi Rama me paratë e vjedhura këtyre banorëve. Armiku i së keqes është bashkimi i shqiptarëve. Ndonëse është zbuluar se këtu kemi një vjedhje rekord, banorët e thonë vetë se u kanë sjellë në shtëpi letra për t'i prishur: Në ato qeli që mbajnë këta banorë, Dorianin dhe shokët e tij, duhet të jetë Afrim Qendro e Daimian Gjijnuri. Ka më shumë se 24 orë për këtë vjedhje, tashmë nuk është vjedhje, por edhe një pastrim parash", theksoi Basha. Kreu i PD shprehu mbështetjen edhe për studentët protestues, por akuzoi se Rama dhe Lindita Nikolla po mundohet që t'i përçajë studentët. "Edi Rama dhe Lindita Nikolla po mundohen t'i përçajë, t'i helmojnë, por e kanë të pamundur. Pro-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dhe me banorët e 'Astirit'

ARRESTIMET

"Të burgosurit janë politikë e Ramës, në atë qeli nuk duhet të jetë Dorjani, por Damian Gjijnuri. Pse nuk fillon hetimi për personat që kanë ideuar këtë skemë korruptive? Pse nuk fillon hetimi për Ramën që ka bërë bisedime kokë më kokë me 'Dida X'? Nuk duhet të lini prokuroren e përgjithshme dhe vartësit pa një përgjigje?", tha Basha.

jekti i tyre për t'i mbajtur studentët në inorancë për të vazhduar vjedhjen dhe mashtrimin ka vazhduar, prandaj studentët vazhdojnë të jenë aty. Nuk janë vetëm për çështjen e tarifave, nuk janë vetëm për çështjen e bordeve të universiteteve. Ata ua kanë thënë sh-

qiptarëve dhe çdo njeriu që sistemi ka degjeneruar dhe është i kalbur: Nuk punon për arsimin e studentëve, por punon për pasurimin e qeveritarëve. Kjo është arsye që bordet i kontrollon qeveria. Paratë që duhet të shkojnë në financim arsimin e lartë, shkojnë

për të financuar skema të tilla korruptive. Paratë që duhet të shkonin për qytetarët, shkojnë për Edi Ramën", deklaroi kreu i PD-së. Basha hodhi poshtë zërat se PD hyri në protestë, duke thënë se mbështet protestën dhe aspiratat e studentëve.

Tabaku, apel Veliajt: Mos u fshih, por jepu zgjidhje banorëve të bulevardit

Banorët e Bregut të Lumit protestuan sërish dhe në mbrojtje të banesave të tyre, që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe. Ata kërkuan dëmshpërblimet nga shpronësimet për ndërtimin e bulevardit të ri. Në mbështetje të banorëve të kësaj zone ishin edhe deputetët e PD-së. Deputetja Jorida Tabaku, e cila ka qenë një nga mbështetëset e kësaj proteste, i bëri dje kryebashkiakut Erion Veliaj që të mos fshihet, por të vijë t'u japë zgjidhje banorëve të bulevardit. "U bëj thirrje të gjithë atyre deputetëve të Partisë Socialiste që kanë ardhur dhe u kanë premtuar se do ta vlerësojnë pronën e tyre. I bëj thirrje kryetarit të bashkisë të mos fshihet, por të vijë të ballafaqohet këtu me premtimet e tij. Këta njerëz, ashtu si unë, ashtu si Partia Demokratike, besoj ashtu si kryetari i bashkisë, duan që të vazhdojë të zhvillohet qyteti, por jo në kurriz të pronës së tyre. Këta njerëz duan që djersa dhe kontributi i tyre të vlerësohet. Këta fëmijë janë sot pasditë këtu, në këtë ditë të ftohtë dhjetorit, ditë e shtunë, ndoshta duhet të ishin duke luajtur si të gjithë moshatarët e tyre, por kanë ardhur të protestojnë për shtëpitë e tyre. Ditën e hënë ne do të jemi prapë këtu, përsëri në orën 4. I bëjmë thirrje kryetarit të bashkisë që të sjellë përfaqësues, të vazhdojmë procesin e vlerësimit të banesave, të nxjerrim VKM-në dhe të trajtohen ashtu si 200 familjet e tjera, që janë trajtuar që nga fillimi i bulevardit. Këta banorë do të vazhdojnë të protestojnë deri kur prona e tyre të jetë e mbrojtur", deklaroi zj.Tabaku..

Përfundon verifikimi i shtëpive në "Astir"

ARRSH: Ulet numri i objekteve që preken nga projekti i Unazës

Autoriteti Rrugor Shqiptar, ALUIZNI, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, IKMT dhe Bashkia Tiranë kanë përmbyllur fazën finale të konstatimit në terren të objekteve që preken nga projekti i rehabilitimit të Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti Pallati me Shigjeta - sheshi "Shqiponja" dhe statusin e tyre ligjor nga ana dokumentare. Ndonëse puna në Unazën e Re është pezulluar, ARRSH njofton se ka përfunduar vlerësimin total i objekteve që preken nga

projekti i Unazës së Madhe. Në njoftimin fillestar është bërë e ditur se 240 objekte do të shembeshin, por pas verifikimeve, numri është ulur në 195 objekte që do të preken nga ndërtimi i tri loteve. Prej tyre, 71 rezultojnë të jenë të pajisura me dokumentet e pronësisë, të cilat do të përfillojnë shpërbllim sipas ligjit, ndërsa 124 objekte janë pa dokumente pronësie. Në deklaratën për mediat bëhet e ditur se ka edhe qytetarë, objektet e të cilëve preken pjesërisht nga projekt. Në 72 raste, ARRSH ka kryer piketimet në terren

dhe për këto objekte është gjetur dakordësia me pronarët. Ndërsa pjesa tjetër do të vazhdojë të qëndrojë, me kusht që të garantohet konfirmimi nga inxhinierët konstruktorë për qëndrueshmërinë konstruktive të objektivit. ARRSH njofton se ka autorizuar vetëm pezullimin e aktivitetit ndërtimor nga kompanitë për loti nr.1, ndërsa institucionet shtetërore do të vazhdojnë normalisht aktivitetin edhe në këtë segment për hapjen e hapësirës për zbatimin e projektit.

STRATI Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankaad të pasurive të paluajtshme:

"Aparamenti Nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m², i ndodhur në katin e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Dajç, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 19.516 Euro. **Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 10.12.2018.**

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. bazuar në nr.568 e vlljes të K.P.I.C shqall ankandin e pare për pasuritë e palës debitore Sh"Strati Construct" sh.p.k. K Strati dhe L Strati. Pasuria perbehet nga:

"Ara", Nr. pasurie 172223 ndodhur ne Drag dhe Durres, Z.K.Nr. 1522, volumi 3, faqe 219, me sipërfaqe totale 1.000 m². Ankandi fillon me çmim fillestar ne masen 3.200.000 lekë.

"Aparamenti", Nr. pasurie 11661-1-19 ne Kryemadhor Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, me sipërfaqe 33.19 m². Ankandi fillon me çmim fillestar ne masen 1.520.000 lekë.

"Aparamenti", Nr. pasurie 11661-1-20 ne Kryemadhor Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, sipërfaqe 59.24 m² dhe Ankandi fillon me çmim fillestar ne masen 2.720.000 lekë.

Ankandi qendron n'hapur 15 ditë dhe do te zhvillohet ne date 24.12.2018 ne ora 15:00 ne Bulevard "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5, Tiranë. Ofruesit duhet te ketheqen dokumentacionin te konsullatës me tel: 00355 47 20 82 543 ose e-mail: ir_derdshaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice.com

Njoftim për shitje me ankand

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. do të zhvillojë ankandin e pare të pasurisë të palës debitore Shoqëria "General Polymeren Recycling Albania" sh.p.k. e përbërë nga:

"ARE", Nr. pasurie 3153, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m², ne Koxhas, Durres. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar ne masen 163.615, 7 Euro.

"ARE", Nr. n pasurie 3114, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12.900 m², ne Koxhas, Durres. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar ne masen 300.105, 6 Euro.

"ARE", Nr. pasurie 3113, Z.K.Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4.300 m², ne Koxhas, Durres. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar ne masen 100.035, 2 Euro.

Ankandi do te zhvillohet ne date 24.12.2018 prej orës 15:00 në shtëpi Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kntakto tel. 00355672082543 ose ne faqen WEB www.powerjustice.com

CEREMONIA PER KAÇIFAS NDALIMET

Arrestohet 1 polic grek për armë pa leje. Të kthyerit përplasen me policinë në Kakavijë

Ceremonia përkujtimore për Kaçifas, ndalohet hyrja në kufi e 120 grekëve

Shoqërohen 20 persona, mes tyre 2 deputetë,
3 gazetarë si dhe kreu i OMONIA-s për Himarën

Brikena Metaj

GJIROKASTËR

Në fshatin Bularat të Gjirokastrës, është zhvilluar ditën e djeshme ceremonia e të 40-tave të Konstandinos Kaçifas, i cili u vra më 28 tetor të këtij viti gjatë shkëmbimit të zjarrit me forcat RENE. Rreth 100 persona kanë marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore që zgjati afërsisht 90 minuta. Pas mesës në kishën e Bularatit dhe vizitës në varreza, rrethi i ngushtë familjar ka vijuar me drekën, ndërsa nuk ka pasur manifestime ashtu si në ceremoninë mortore. Të pranishëm kanë qenë edhe deputeti Dule dhe ish-deputeti Spiro Ksera. Për të shmangur incidentet e mundshme, policia shqiptare ka marrë masa të rrepta paraprakisht. Forca të shtuara policore dhe të Antiterrorit ka pasur në Pikën Kufitare të Kakavijës për gjatë gjithë vijës së gjelbër si dhe disa postblloqe, ku kryeshin kontrollë të imtësishme të automjeteve, në pikat kryesore të aksit Gjirokastrë-Kakavijë dhe Gjirokastrë-Sarandë. Kthime masive të shtetasve grekë që kanë dashur të hyjnë në territorin shqiptar për të marrë pjesë në ceremoninë e të 40-tave të Kaçifas ka pasur jo vetëm në doganën shqiptare, ku të dhënat zyrtare pohojnë për 120 shtetas grekë të ndaluar të hyjnë në territorin shqiptar, por mësohet edhe për rreth 30 persona të ndaluar dhe të kthyer edhe nga pala greke. Të dhënat jozyrtare flasin për një shifër prej më shumë se 200 personash të kthyer. Ndryshe nga sa ndodhi në ditën e varrimit të Konstandinos Kaçifas, kur në Bularat mbërritën 11 autobusë me shtetas grekë nga qytete të ndryshme të Greqisë, ditën e djeshme ka mbërritur vetëm një autobus me jo më shumë se 30 pasagjerë. Pothuajse të gjithë shtetasit e kthyer kanë pasur si destinacion Bularatin, ndërkohë që mësohet se një pjesë e tyre kanë qenë në



35-vjeçari i vrarë,
Kostandinos Kaçifas

200

PERSONA

Burime zyrtare bëjnë me dije se 120 shtetas grekë janë ndaluar të hyjnë në territorin shqiptar. Ndërkohë burime jozyrtare flasin për një shifër prej më shumë se 200 personash të kthyer.

Pengesat në kufi, reagon OMONIA: Skenar terrorist për të na shfarosur

Pas përfundimit të ceremonisë përkujtimore të 40-tave të ndjerit Kostandinos Kaçifas, OMONIA i ka cilësuar terroriste masat e marra nga Policia e Shtetit për gjatë gjithë ditës së djeshme. Ndallimet në pikat kufitare dhe shoqërimin e shtetasve grekë nga ana e policisë shqiptare, OMONIA e ka komentuar si një përpjekje graduale për shfarosjen e minoritetit grek në Shqipëri. Nuk mungon edhe paralajmërimi se ata do të kërkojnë nga ndërkomitëtarët marrjen e masave që qeveria të ndërpresë këto "praktika të rrezikshme". "Forca të shtuara dhe të përforcuar të policisë me grupe speciale të ardhura nga Tirana në stacionin kufitar të



Kakavijës dhe Qafë Botës (Mavromati) nuk lejuaun numër të konsiderueshëm qytetarësh dhe kjo pa arsye të qenësishme, për të hyrë në Shqipëri. Arsyet janë pa bazë ligjore, ndërsa sjellja në zyrat e stacioneve kufitare i ka të gjitha ato cilësi të hetimit dhe më së shumti shkelin të

drejtat e qytetarit, veçanërisht atyre të Bashkimit Evropian, që janë plotësisht të sanksionuara për nga përkatësitë e tyre të lirisë. Posaçërisht denoncimë se pengimi dhe refuzimi i hyrjes për pjesëtarët e MEG që kanë edhe nënshtrësi shqiptare përbën shkelje të patolerueshme të të drejtave të tyre themelore dhe plotësisht të sanksionuara. Qëllimi i gjithë këtij skenari terrorist është e lehtë të kuptohet dhe ka të bëjë jo thjesht me manipulimin e MEG, por me izolimin e tij esencial nga tokat amtare, me objektiv shfarosjen e tij graduale", thuhet ndër të tjera në reagimin e OMONIA-s.

listën e personave të shpallur më herët si 'non-grata', mes të cilëve edhe të gazetarit Panajotis Savidis, të cilit i është mohuar hyrja në Shqipëri gjatë mbërrmjes së të premtës, me argumentin se përbën kërcënim për sigurinë publike. Po kështu, gjatë të shtunës policia shqiptare ka ndaluar edhe dy gazetarë të tjerë të hyjnë në territorin shqiptar. Të revoltuar që nuk

mundën të hyjnë në Shqipëri, grekët për rreth një orë bllokuan anën greke të kufirit duke shkakuar edhe tensione me policinë kufitare. **NDALIMET** Mes të ndaluarve nga policia e Gjirokastrës kanë qenë edhe dy deputetë grekë. Shogruesi i Vasilis Jojaka, deputet i Demokracisë së Re, është arrestuar në postbllokun e Kranesë në Sa-

randë. Bëhet fjalë për Marios Gogolos, banues në Gumenicë, Greqi, me detyrë punonjësi policie në Igumenicë. 35-vjeçari është kapur në flagrancë nga shërbimet e policisë me një armë zjarri pa leje dhe tipit "pistoletë" me 6 fishekë. Sipas burimeve nga pala greke, polici deklaroi në kufi se kishte me vete armën e tij, ndërsa policia shqiptare deklaroi se ai akuzohet për



Ceremonia e djeshme përkujtimore në Bularat të Gjirokastrës

GAZETARI "NON GRATA"

Panajotis Savidis, gazetari i së përditshmes greke "Protothema", është shpallur person i padëshirueshëm në Shqipëri. Mbrëmjen e së premtës, ai nuk u lejua të hynte në Shqipëri përmes pikës kufitare të Kakavijës dhe u kthye pas. Gazetari grek kishte planifikuar ardhjen në Shqipëri për të marrë pjesë në mesën e ditës së djeshme për Kostandinos Kaçifas në fshatin Bularat të Gjirokastrës, pasi ka qenë më parë edhe në funeralin e 35-vjeçarit.

"Patriotët" mblidhen në Gjirokastrë për shqiptarët e vrarë në Greqi

GJIROKASTËR - Në të njëjtën kohë me ceremoninë përkujtimore për Konstandinos Kaçifas, në qendër të Gjirokastrës në sheshin "Çerçiz Topulli", Shoqata e Patriotëve organizoi një tubim paqësor. Të veshur me veshje dhe simbole ushtarake shqiptare, patriotët u mblodhën në shenjë proteste për shqiptarët e vrarë në Greqi ditë e fundit. Ata kanë bërë thirrje për qetësi nga pala greke. "Të rindërtojmë marrëdhëniet e mira mes dy palëve, por shqiptarët po trajtohen në mënyrë jo dinjtoze", deklaruan ata. Disa policë monitoruan zhvillimin e kësaj proteste. Me flamujt kuqezi dhe me tingujt e këngës himn "Shqipëri o nëna ime", aktivistët hodhën valle pranë memorialit të Çerçiz Topullit si dhe mbajtën fjalime, ku dënuan vrashjen e shqiptarëve në Greqi dhe qëndrimin e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, që nuk ka reaguar. "Sot marrim pjesë në këtë protestë për të kujtuar viktimat shqiptare në Greqi, që janë vrarë padrejtësisht dhe pse kanë qenë të pafajshëm", pohuan protestuesit.

armëmbajtje pa leje. Ndërsa Nikos Nikolopoulos, një deputet tjetër i parlamentit grek u ndalua për 1 orë e gjysmë në polici. Ai është shprehur se do ta ngrrejë këtë çështje në Parlamentin Evropian. Të paktën tre deputetë grekë kanë marrë pjesë në ceremoninë e djeshme në Bularat. Mes personave të ndaluar nga policia shqiptare është edhe kreu i OMONIA-s në Himarë, Fredi

Bejleri si dhe 5 anëtarë të kësaj organizate. Mësohet se policia i ka ndaluar të shoqëruarit në Jorgucat, ndërsa ata po shkonin drejt fshatit Bularat, ku edhe do të zhvillohej ceremonia përkujtimore e të ndjerit Konstantino Kaçifas.

Kanë qenë rreth 20 persona që janë shoqëruar nga uniformat blu shqiptare për t'u verifikuar në polici.



GJIROKASTËR - E ndërsa kunati i 35-vjeçarit Konstandos Kaçifas përcolli mesazhe paqeje, krejt ndryshe kanë qenë deklaratat e bëra nga nëna dhe motra e tij. Të ngarkuara emocionalisht për humbjen e të dashurit të tyre më 28 tetor të këtij viti, ato kanë përdorur një gjuhë të ashpër kundër shqiptarëve. Nëna e 35-vjeçarit të vranë nga forcat e RENEA-s ka dalë në qendër të Bularatit me një flamur grek në dorë, ndërsa është shprehur në greqisht para kamerave se do të marrë hakun e të birit. Fjalët e para të së ëmës pas përfundimit të ceremonisë në varrezat e kishës Shën Athanasi në Bularat ishin: "Të vranë qentë shqiptarë që jetojnë këtu. Ata qenë që nuk lanë vëllezërit tanë të vijnë për kujtimin e Konstandinos tim. Pse na pret të drejtat tona?", tha nëna e Kaçifas. Më pas ajo është shprehur se "do të bëhem si Xhaveli. Do të vras Edi Ramën. Më mori trimin tim. Pse ma vrau djalin? Nuk e dija që kisha lindur një trim të tillë. Ne

Motra: E vranë barbarisht, dikush të marrë përgjegjësinë

Shpërthen nëna e Konstandinos Kaçifas: Do të ta marr unë hakun, do vras Edi Ramën!



Motra dhe nëna e Konstandinos Kaçifas

duam drejtësi. Të çohem 10-15 si t'i të pastrojnë vendin. Do të ta marr unë gjakun, biri im", - tha Vasilija Kaçifas. Ndërkaq, fjalët e saj janë mbështetur nga të pranishmit, të cilët kanë përsëritur thirrjet: "Konstandinos je i pavdekshëm!". Ndërsa, motra e minoritarit grek, Ermioni Kaçifas u shpreh

para mediave se qeveria duhet të marrë përgjegjësi mbi ta. "Dua të jetojmë në harmoni. Nuk po shikojmë që të ndodhë kjo edhe nga ana e autoriteteve shqiptare. Kërkojmë respekt. Nuk shikojmë të ndodhë kjo. Ta dëgjojmë të tërë, qeveria greke dhe Europa. Dikush duhet të marrë përgjegjësi.

Turp, fyejnë ndjenjat tona fetare, historinë tonë, rrënjët tona. Vëllai im është martir. E vranë barbarisht", bërtiti jashtë kishës motra e 35-vjeçarit të vranë. Ndërkohë që nëna e saj vijoi: "Konstandinos ynë është në qiell dhe na sheh. Jetoni për Greqinë, jetoni për Epirin e Veriut".

Vangelis Saqellaraqis: Konstandinosi nuk është drejtuar kurrë kundër një shqiptari, ja çfarë i tha nënës së tij

"Shqipëria e Greqia janë një familje, të mos ndërhyjë Turqia"

Kunati i Kaçifas: Kryeministrat Rama e Cipras të qetësojnë situatën

Brikena Metaj

GJIROKASTËR

Unë e kuptoj që në të dyja anët e kufirit ekzistojnë njerëz që nuk duan miqësinë mes dy popujve, por unë kam një mesazh për t'u transmetuar drejtuesve të shteteve nëpërmjet jush, që e ardhmja jonë është Evropa. Shqipëria dhe Greqia janë një familje. Problemet që kemi i zgjidhim vetë dhe nuk ka nevojë për të tretë. Turqia po nxit përplasje mes dy vendeve". Kështu deklaroi dje për mediat kunati i Konstandinos Kaçifas. Pas ceremonisë përkujtimore të zhvilluar për këtë të fundit në Bularat, Vangelis Saqellaraqis dha mesazhe paqeje mes dy vendeve, ndërsa u bëri thirrje kryeministrave Rama dhe Cipras të gjejnë gjuhën e përbashkët për qetësim të situatës. Ndërkohë, në një intervistë ai mohoi që në ceremoninë mortore të Kaçifas të jenë hedhur parulla e thirrje antishqiptare. Madje, ai deklaroi se Konstandos Kaçifas nuk është drejtuar asnjëherë



Vangelis Saqellaraqis duke folur për mediat

kundër një shqiptari. **Çfarë problemi keni pasur?** Personalisht nuk kisha asnjë problem, por kishin problem të tjerët. Në 10 veta, 8 u kthyen mbrapsht. **Përse mendoni se ka ndodhur kjo gjë, për sa kohë ju vetën nuk kishit probleme?** Unë e kuptoj që në të dyja anët e kufirit ekzistojnë

njerëz që nuk duan miqësinë mes dy popujve, por unë kam një mesazh për t'i transmetuar popullit dhe drejtuesve të shteteve nëpërmjet jush, që e ardhmja jonë është Evropa. Ne duhet të bashkëpunojmë, duhet të kemi flamurin tuaj. Ne duhet të kemi besimin tonë, ju duhet të kemi besimin tuaj, por ama duhet ta shikojmë veten të

Dy banorë nga fshati Bularat i Gjirokastrës dje deklaruan se policia nuk e ka lejuar të hyjë djalin e tyre në Shqipëri. Ata kanë thënë se policia e ka marrë me pranga në duar që në Kakavijë dhe e kanë shoqëruar djalin e tyre 30-vjeçar në komisarjat. "Në komisarjat e kanë pyetur për qëllimin e ardhjes, nëse ka qenë i pranishëm në varrim, nëse ka dëgjuar thirrje kundër shqiptarëve. Ai nuk pranoi që ka pasur thirrje antishqiptare", thanë për

lidhur bashkë dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin. **Me këto që thonë, do të thotë se ju nuk jeni dakord me thirrjet antishqiptare që u hodhën në ceremoninë për Kaçifas?**

Parulla antishqiptare nuk u dëgjuan, u dëgjuan parulla të tjera. Por u dëgjuan nga të dyja anët. Ne duhet t'i ndalojmë ato. Edhe Konstandinos të njëjtën gjë ka thënë, nuk është drejtuar asnjëherë kundër një shqiptari. Edhe kur mamaja e tij i tha që çfarë po bën, do të të vrasin. Ndër-

Prindërit e 30-vjeçarit : Djalin e mori policia



sa, ai i ka thënë që nuk më vrasin se edhe policët kanë fëmijë dhe marrin një rrogë shumë të vogël në muaj. Pra, edhe Konstandinos nuk shfaqti qëndrim të kësaj natyre. Dua t'i lutem kryeministrit tuaj, zotit Rama dhe kryeministrit tonë, zotit Cipras të gjejnë një gjuhë të përbashkët për të kapërcyer këto probleme. Ne duhet të jemi bashkë, duhet të punojmë bashkë dhe duhet të gjejnë një gjuhë të përbashkët. Dua t'ju them edhe diçka tjetër, është se Turqia në rastin

"GSH" prindërit e 30-vjeçarit nga Bularati. Mësohet se djali i tyre është kryetar i komunitetit të banorëve të Bularatit në Athinë. I pyetur nga policia se cili është qëllimi i shoqatës që kanë krijuar në Athinë, iriur ka deklaruar se është një traditë.

konkret nuk ndihmon miqësinë mes dy popujve. Ne dhe Shqipëria jemi një familje dhe familja i zgjidh problemet brenda vetes dhe nuk pret ndihmën e të tretëve. Në këtë rast Turqia nxit përplasjen mes nesh. Gjithashtu, dua të them edhe diçka të tjetër, vetëm të vërtetën. Ju e patë që këtu nuk ndodhi absolutisht asgjë, por ishte e papranueshme dhe e dënueshme me ajo që ndodhi me policinë, e cila ndaloi dhe ktheu të gjithë ata njerëz që donin të vinin sot (dje) këtu.

ALUIZNI publikon 350 emrat e rinj. Procedurat për marrjen e tapisë ndiqen nga 'Agjencia'

Legalizimet, emrat e përfituesve në Tiranë

Kush merr lejen në Petrelë, Kashar, Dajt, Pezë, Vaqarr e Baldushk

ALUIZNI publikon listën me 350 pronarë që kanë gati lejen e legalizimit në qarkun Tiranë. Sipas ALUIZNI, të gjithë personat që gjejnë emrin në listat e afishuara duhet të paraqiten pranë drejtorisë për të tërhequr lejen.

Bazuar te ndryshimet e fundit ligjore, qytetari duhet të marrë një kopje për të vërtetuar përmbimin e procesit të legalizimit. Ndërsa, lidhur me procedurën vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ajo do të

bëhet nga Agjencia.

TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të aplikojnë për tapinë. Pas ndry-

shimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar përmbimin e procesit të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia'. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës,

për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit, dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave

ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vite për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

EMRAT ME PËRFITUESIT E LEGALIZIMEVE NË TIRANË

Nr	EMER	ATESI	MBIEMER	KOMUNE	PAJA, SHPATA, LUSHA	ZALL-HERR	HAKA	PETRELE	
1	IBRAHIM	OSMAN	G.JATA	BALDUSHK	72	XHAFERR	OSMAN	HAKA	PETRELE
2	DASHNOR	XHEMAL	G.JICI	PETRELE	73	BILIK.FATOS	MUSTAFA	ZYBERAJ	FARKE
3	NEXHAT	ZLJA	BIBA	VAQARR	74	MUSA	MUHARREM	ALLA	FARKE
4	RAMIZ	HAMZA	HAROKU	KASHAR	75	SKENDER, ELIDA	MUSA, SKENDER		RRUSHI FARKE
5	QEFSERE	SHABAN	SHIMA	DAJT	76	XHAVIT	MALIQ	SMUCA	DAJT
6	ADIL QAMIL	GJINI		KASHAR	77	HAXHI	DALIP	HOXHA	DAJT
7	HYSEN	RAMAZA	DOKA	DAJT	78	RAMAZAN	MEXHIT	MEMA	DAJT
8	HASAN, XHETAN	FEZ	HASA	DAJT	79	BIBE DODE	MARKAJ		KASHAR
9	MUHAMET	IBRAHIM	HAJDARI	KASHAR	80	IDLIR RAMAZAN	VOGLI		FARKE
10	VLADIMIR, LULEZIM	DED	NDUO	VAQARR	81	XHAFERR	XHEMAL	GURORI	FARKE
11	ARDIT	FATLI	MALKOLLARI	KASHAR	82	ILIR JASHAR	BALLIU		KASHAR
12	GEZIM	MELAIM	DAKU	VAQARR	83	BLERIM	ENVER	KODRAGJINI	KASHAR
13	ARDJAN	SHYQERI	DUMI	VAQARR	84	ARTJAN	ADEM	MALOLLARI	KASHAR
14	MUHAMET	MUHARREM	VATHI	PETRELE	85	AGIMSAMI	RAMUSHI		FARKE
15	BARDHYL	SHABAN	HAMATI	KASHAR	86	MUHARREM	SALI	MUCALLA	PEZE
16	LAVDIRIM	ISMAIL	KURTI	ZALL-HERR	87	KRISTO	QEMAL	GOGA	FARKE
17	ARTAN	HAMIT	PEQINI	PETRELE	88	DALIP	ABAZ	SINANI	KASHAR
18	HAMZA	HAMDI	SORRA	KASHAR	89	BUKURIJE	XHEMAL	GRORI	FARKE
19	FADIL	MUSTAFA	HOXHA	ZALL-HERR	90	ARTUR	HALIM	ÇOÇKA	FARKE
20	DRITAN	QAZIM	LAMAJ	KASHAR	91	FAIK XHELIL	MANGAJ		FARKE
21	DRINI	HALIT	CAJKA	KASHAR	92	ESAT AZEM	MURATAJ		FARKE
22	SHPETIM	PETRIT	TRESA	BALDUSHK	93	XHELAL, JONUZ	JONUZ, XHELAL	ALMADHI	KRRABE
23	XHEMAL	AGIM	DUMI	VAQARR	94	DURIM	RAMAZAN	BELBA	VAQARR
24	KIMET	RRAHIM	LASHI	DAJT	95	ALI SALI	DOJKA		FARKE
25	MAKSUT	LIVAN	LICOLLARI	KASHAR	96	NAPOLAN	SKENDER	GJANA	BALDUSHK
26	MYRTEZA	HETEM	KASMI	KASHAR	97	DRITAN	FERID	SEJDINI	FARKE
27	SAMI BERSIM	NUREDINAJ		KASHAR	98	NEIMSELIM	CELMETA		PEZE
28	SEFER	HAKI	LULJA	BALDUSHK	99	SAID QAZIM	GJOSHI		FARKE
29	ISMAIL	IBRAHIM	CAKA	KASHAR	100	GANI MYSLIM	ALLMUCA		FARKE
30	GANI HAXHI	ZHLIJA		FARKE	101	SERVET	ZAIM	UKA	DAJT
31	HALIM	HUZRI	PERZHILLA	FARKE	102	PELLUMB	FAIK	HOXHA	KASHAR
32	MALIQ	SEFER	XIXI	FARKE	103	TAQO VANGJEL	JANKULLA		KASHAR
33	SHPETIM	PETRIT	G.JOKMELI	VAQARR	104	ALKET	GEZIM	LIVADHI	ZALL-HERR
34	DASHNOR	VEIS	BERZANI	VAQARR	105	ISUF QAMIL	SHKURTI		FARKE
35	ARDIAN	MUHARREM	MUCA	KASHAR	106	ALTIN	ABDULLA	SINANI	BERZHITE
36	SKENDER	SELM	BEGU	FARKE	107	HALIT	ADEM	LIKA	DAJT
37	SURI HAXHI	KRROCI		FARKE	108	FEIM RUSHIT	SULAJ		KASHAR
38	ADHURIM	XHEMAL	MALI	FARKE	109	DURIM	SULEJMAN	DUMI	VAQARR
39	ARDIAN	BILAL	LILLO	KASHAR	110	FASLIHAZIS	MARKU		KASHAR
40	BEQIR	IDRIZ	DRIZA	VAQARR	111	SILVANA	SHYQERI	OSMANI	PEZE
41	KOSTANDINO	DEMUSH	BALAJ	KASHAR	112	MUHARREM	IBRAHIM	VOGLI	FARKE
42	SHERIF	DULE	XHIXHO	KASHAR	113	AGIM SEFER	LALA		KASHAR
43	TEFIK	ZIA	BIBA	VAQARR	114	ARBEN	SEFER	GRORI	PEZE
44	VALMIR, BUKUROSH	MEFAIL	FEJZULLAHI	KASHAR	115	GENC	HALIM	ELEZI	DAJT
45	FESTI	SHEFQET	ZIKA	KASHAR	116	NEBI SHEFQET	LACI		DAJT
46	SHKELQIM, GAZMEND	BEQIR, SHKELQIM	DRIZA	VAQARR	117	AVNI BEQIR	BIRACI		FARKE
47	XHAVIT	QAMIL	VALISI	KASHAR	118	BAFTJAR	KAMBER	HASLIKA	ZALL-HERR
48	GAZMEND	JAKUP	AGA	VAQARR	119	EGEREM	HALIL	SORRA	KASHAR
49	HAZIZ	RAMADAN	LANI	KASHAR	120	ARSEN	FADIL	RUSHIT	KASHAR
50	SEFEDIN	HYSEN	HYSENI	KASHAR	121	BESNIK	ALI	HAXHIMALI	PETRELE
51	AFRIM	BAJRAM	DUMI	FARKE	122	ALBERT	SHERIF	SHIMA	KASHAR
52	ASLLAN	SHEFIT	FERHATI	KASHAR	123	REMZI	HALIM	PECA	PEZE
53	BEXHET	SULEJMAN	NOZLLAKU	KASHAR	124	SEHIT	MUSTAFA	MJESHTRI	KASHAR
54	RIFAT	TAHIR	DEMA	FARKE	125	KUJTIM	MUHARREM	CANJA	FARKE
55	MEVLUD	HAJRULLA	HAFUZI	FARKE	126	NIKO ISMAIL	SALLAKU		KASHAR
56	SOKOL	BEDRI	LAMI	PEZE	127	ARJAN	RAMAZAN	SOLLAKU	KASHAR
57	SHEFQET, AGRON	SULEJMAN	TOSHI	FARKE	128	GENTIAN	PETRIT	TRESA	BALDUSHK
58	ARDJAN	FEJZULLAH	MEREPEZA	NDROQ	129	ERVIS	BAJRAM	GJYLA	FARKE
59	ARBEN	HASAN	KARAJ	KASHAR	130	MISIM	QERIM	MACI	FARKE
60	XHEVAHIR	NEZIR	BOSHNJAKU	FARKE	131	FATMIR	SHEME	XHAFERRI	VAQARR
61	GANI XHELIL	DAUTI		FARKE	132	SHYQYRI	HYSEN	ENESI	NDROQ
62	SEFER	SINAN	XHANI	FARKE	133	DASHAMIR	HAXHI	MYFTARAJ	FARKE
63	MUHAMED	KADRI	GOGA	PEZE	134	ESAT XHAFERR	SEFERI		DAJT
64	DYLAVER	RRAHMAN	LOSHI	PEZE	135	SHAHIN	IMER	GJORLLAKU	DAJT
65	JOLAND	JEMIN	BALLA	FARKE	136	PAVILLO	PILO	DAKA	PETRELE
66	XHEVIT	SHEFKI	DURRA	FARKE	137	NAZMIE	SHABAN	CEKA	DAJT
67	KASEM	HAZIS	KENGA	FARKE	138	HASAN	MERSIN	SHURDHI	KASHAR
68	CAN SHEFKI	DURRA		FARKE	139	BESNIK	SHYQERI	STAJAJ	KASHAR
69	MUSTAFA	SADIK	HYSA	PEZE	140	XHEVAHIR	SHYQERI	STAJAJ	KASHAR
70	HAKI MUHARREM	MEMA		PEZE	141	XHEVAHIR	SAKIP	SHEHI	KASHAR
71	LIRIE, SADETE, MARIAN, GANIMETE, HAZRET			MUS	142	METE	SEIT	NELI	DAJT

143	RAMAZAN	GANI	Tafa	BERZHITË	244	MUSA	AHMET	MUCOLLARI	FARKE
144	YLLI MUHARREM	CANIA		FARKE	245	FESTIM	DOSTAN	DAFKU	FARKE
145	SHKELQIM	FATOS	BAJRAKTARI	KASHAR	246	QAZIM,FATOS	VELI,QAZIM	VANI	FARKE
146	SKENDER	QAMIL	LILA	DAJT	247	NAMIK	TELHA	TRESA	VAQARR
147	BASHKIM	XHEMAL	MUSAJ	FARKE	248	NAMIK	TELHA	TRESA	VAQARR
148	EDUART	GEZIM	LIVADHI	ZALL-HERR	249	SEJDIR	XHAFERR	TAFANI	VAQARR
149	MYZEJEN	XHEMAL	GRECA	FARKE	250	EKREM	DALIO	BRESHANI	PEZE
150	MENTOR	HAXHI	MYFTARAJ	FARKE	251	AGIM HAXHI	ALLGJATA	HASA	VAQARR
151	FESTIM	EMIN	KOBOCI	FARKE	252	XHAVIT	TAHIR	PRENG	GJONAJ
152	FATOS	XHEVAT	CERA	FARKE	253	PJETER	PRENG	HAMDI	DAMJANI
153	SHEFKLASTRIT	SEFER	DUQI	FARKE	254	FADIL	RESHIT	RESHIT	HIMA
154	HAMIT	XHEMAL	KOCI	VAQARR	255	AFRIM	XHEVIT	IBRAHIMLLARI	KASHAR
155	BASHKIM	BAKI	MALLIKU	VAQARR	256	LAVDRIM	SULE	HALI	CULLHAJ
156	SHYQYRI	ADEM	BRAHAJ	FARKE	257	BAJAME	HALI	FADIL	CAVELI
157	PELLUMB	HASAN	SHKALLA	FARKE	258	GAZMEND	FADIL	ALLAMAN	NURJA
158	ANESTI	REXHEP	NEBI	KASHAR	259	AHMET	TRESA	KADRI	KARAJ
159	SHKELQIM	AZEM	MURATAJ	FARKE	260	SABRI	KADRI	SELMAN	KODUMI
160	MUHARREM	ISMAIL	STafa	KASHAR	261	AGIM HAMDI	RAMADAN	JONUZ	AGA
161	HYSEN	BRAHIM	TAHIRAJ	FARKE	262	SHERBET	DAJT	XHELAL	DORZI
162	SHEFQET	HYSNI	PIRA	DAJT	263	RAMADAN	DAJT	LATIF	HIDRI
163	AGIM SUL	KUCANA		DAJT	264	ALEKO	FLAMUR	FERIT	SHAQIR
164	BILAL	BEQIR	BENGA	KASHAR	265	FLAMUR	KASHAR	RRAPUSH	SULE
165	KRISTAQ	REXHEP	POTKA	KASHAR	266	RAKIP	VAQARR	IDRIZ	SULEJMAN
166	HOD MET	MYRTA		VAQARR	267	FERIT	VAQARR	SELMAN	XHELAL
167	FATMIR	GJON	GECAJ	VAQARR	268	REFIK	VAQARR	HYSNI	MUSALLARI
168	PERPARIM	GJON	GECAJ	VAQARR	269	JONUZ	VAQARR	AZEM	MANALLARI
169	RIZA HALIM	DRIZA		VAQARR	270	FLUTURA	VAQARR	MEXHIP	CERPJA
170	SKENDER	HAXHI	DRIZA	VAQARR	271	TAHIR	VAQARR	AZEM	MANALLARI
171	FUAT ALI	AJASLLARI		VAQARR	272	DASHAMIR	VAQARR	BEXHET,SHABAN	MUHARREM
172	AVNI MUSTAF	SULAJ		KASHAR	273	RUSHIT	VAQARR	MUSTAFA	MALOLLARI
173	ALFRED	HOD	MYRTA	VAQARR	274	SELMAN	VAQARR	ADEM	MURATI
174	MEHMET	SEIT	BATHORJA	FARKE	275	HEKURAN	VAQARR	ABIDIM,QAMIL	ISLAMAJ
175	HAXHI	HALIT	PALUSHI	FARKE	276	NEZIR	VAQARR	DRITAN	CEKREZI
176	MERSIN	XHEVDET	SHURDHI	KASHAR	277	NJAZI,BEXHET	VAQARR	BANUSH	TELHALLARI
177	MICHAEL JOHN	GEORGE	ROBINSON	FARKE	278	JETNOR	VAQARR	NAZMI	KULLLOLLI
178	MICHAEL JOHN	GEORGE	ROBINSON	FARKE	279	ZEQINE	VAQARR	RAMAZAN	STafa
179	BAKI FADIL	BAKALLI		VAQARR	280	ARJAN	VAQARR	HAYSEN	HARIZI
180	XHEMAL	HYSEN	DRITA	VAQARR	281	QAMIL,ALIDIM	VAQARR	MUSTAFA	BALOSHI
181	PELLUMB	RESHIT	HIMA	VAQARR	282	DRJON	VAQARR	HAFUZI	RAMAZAN
182	XHEVAHIR	GANI	KARAJ	VAQARR	283	ARDIAN	VAQARR	RIFAT	CAKRI
183	SELIM	QAMIL	VODHA	FARKE	284	DRITAN	VAQARR	SKENDER	KARAJ
184	DILE ALI	ALIU		KASHAR	285	ALBAN	VAQARR	FETAH	ZHOLI
185	FESTIM	JONUZ	AGA	VAQARR	286	SHEFQET	VAQARR	QAMIL	XHECUKA
186	TASIM,HAJRI	ILMI	LLESHI	KASHAR	287	BEHAR	VAQARR	MAKSUT	HAFUZI
187	ULQINAK	XHEMAL	ALLMUCA	BALDUSHK	288	QEMAL	VAQARR	DAUT	DAUTI
188	PERPARIM	IBRAHIM	QEMALLI	BALDUSHK	289	ZIJA MAKSUT	VAQARR	HAMIT	SHKALLA
189	KADRI	SHABAN	ZENELI	BERZHITË	290	XHEVAHIR	VAQARR	RAHMAN	LIKA
190	REXHEP	ISMAIL	AHMATI	VAQARR	291	ALBAN	VAQARR	CARA	KASHAR
191	ARSIM	ISAK	PARLLAKU	FARKE	292	MIFTAR	VAQARR	RUSHIT	DANGA
192	DENIS	AIGM	IMERI	FARKE	293	ALBAN	VAQARR	HALIL	HAKRAMA
193	SHKELQIM	RAMAZAN	BELBA	VAQARR	294	ASLLAN	VAQARR	RAIF	XEGA
194	NAIMSULEJMAN	XHEPA		ZALL-HERR	295	YMER	VAQARR	RAIF	XEGA
195	ALTIN	RAMAZAN	BUNOCA	DAJT	296	ZYBER	VAQARR	MURRAKU	FARKE
196	KAJMAK	ILMI	CENGA	KASHAR	297	PETRIT	VAQARR	MURRAKU	FARKE
197	HETEM	TAKE	SALIANJI	KASHAR	298	AVNI ASLLAN	VAQARR	HALLI	FERATI
198	NEXHAT	HALIT	DAJA	BALDUSHK	299	ELMAZ	VAQARR	QAMIL	Tafa
199	KAPLLAN	HALIT	PALUSHI	FARKE	300	MALIQ	VAQARR	BESIM	DEDA
200	BEQO	QAZIM	JAUPI	FARKE	301	ANDREA	VAQARR	HAMDI	SORRA
201	BORO	BELUL	ISUFI	VAQARR	302	ANDREA	VAQARR	VILA	SEFEDIN
202	BAJRAM	SERAN	LLAKA	KASHAR	303	RIZA MEHMET	VAQARR	BAJRAM	NOZLLI
203	BEDRI	MUHARREM	BARZIU	VAQARR	304	RIZA MEHMET	VAQARR	ABDYL	PLLOCI
204	VELBI	MEHMET	KACOLLJA	BALDUSHK	305	SOKOL	VAQARR	KADRI	RAMAZAN
205	SELMAN,MAKLAN ,MIREL	SINAN,SELMAN	ALLMUCA	BALDUSHK	306	HARIZ	VAQARR	MANE	XHELILI
206	YLBER	MUSTAFA	HOXHA	KASHAR	307	FESTIM	VAQARR	ARIF	MULAJ
207	MARIGLEN	BASHKIM	SPAHIU	PEZE	308	BELUL	VAQARR	IBRAHIM	DORZI
208	KOL GJUR	KOLA		DAJT	309	ZAIM HAXHI	VAQARR	MUSTAFA	TAHIRAJ
209	IMER BAFTJAR	PASHAJ		VAQARR	310	SAZAN	VAQARR	OSMAN	BALLA
210	BLERIM	SABRI	BERZIU	VAQARR	311	FATOS,YMER	VAQARR	IBRAHIM	KAMBERI
211	MEHDI	ZENEL	CANAJ	VAQARR	312	QAMIL	VAQARR	MUHARREM	NOZLLI
212	GAZMEND	ABDULLA	NOZLLI	VAQARR	313	KADRI	VAQARR	SELMAN	BRAMILLARI
213	IDRIZ SAID	DEDA		KASHAR	314	SHKELQIM	VAQARR	SHEIP	ISLAMAJ
214	ASLLAN	TELHA	TRESA	VAQARR	315	ADEM	VAQARR	SHABAN	SEFA
215	GANI SELMAN	XHAFERRI		VAQARR	316	GENC	VAQARR	JUSUFI	DAJT
216	FIQIRI	HAKI	DEDJA	VAQARR	317	SELAM	VAQARR	SADI	BARDHI
217	MERSIN	ZYBER	KODRA	BALDUSHK	318	NAZMI	VAQARR	HASAN	SALLUFI
218	GANI SELMAN	BERZIU		VAQARR	319	BASHKIM	VAQARR	ASLLAN	PERGJEG-JA
219	BEHAR	HAXHI	LANA	DAJT	320	RAMAZAN	VAQARR	ISLAM	HASIBRA
220	SHINE	XHEMALI	GJINI	FARKE	321	MURAT	VAQARR	AHMET	CAKA
221	GEZIM	BEKTASH	SPAHIU	KASHAR	322	JAKUP	VAQARR	MUSTAFA	MECKAJ
222	NAZMI	SHABAN	TROKSI	DAJT	323	ADEM	VAQARR	MUHARREM	KOLA
223	QERIM	HAMID	TRESA	FARKE	324	SALI MUSTAFA	VAQARR	ENVER	DORZI
224	DASHAMIR	XHAVIT	SULA	BALDUSHK	325	ASLLAN	VAQARR	BANUSH	BANUSHI
225	RUSTEM ,ABDYL	MEXHIT	TOCILLA	FARKE	326	FATOS,PETRIT	VAQARR	BEKTASH	VELILLARI
226	IRFAN	MUSTAFA	TRESA	BALDUSHK	327	OSMAN	VAQARR	FADIL	TROKSI
227	NDRICIM	HAXHI	LANA	DAJT	328	XHAFERR	VAQARR	PELLUMB	BULKU
228	EDUART	SAMI	SALIU	BALDUSHK	329	YMER	VAQARR	SHPETIM	SULAJ
229	SAID HYSEN	RAMA		BALDUSHK	330	JEMINE	VAQARR	MUSTAFA	HOXHA
230	QANI JAHJA	BALI		BALDUSHK	331	PELLUMB	VAQARR	RAMAZAN	REXHEP
231	AGRON	ALLAMAN	BRAJA	BALDUSHK	332	BLERTI	VAQARR	RAMAZAN	RAMAZAN
232	VULLNET	ADEM	KOCIAJ	KASHAR	333	VLADIMIR	VAQARR	AGIM	KONDI
233	DASHAMIR	ABDURAHIM	TORBA	KASHAR	334	QEMAL	VAQARR	QAMIL	SULEA
234	KUJTIM	SHAQIR	RAMA	FARKE	335	OSMAN	VAQARR	KASHAR	XHEKA
235	SABRI	RAMAZAN	HOXHA	KASHAR	336	KLODJAN	VAQARR		
236	NAZIF	FERIT	SULAJ	KASHAR	337	GRANIT	VAQARR		
237	DEFRIM	SULEJMAN	TOTA	FARKE	338	SHKELQIM	VAQARR		
238	ISMAIL,HAJREDIN	NIMET	KASA	BERZHITË	339	ALI NEZIR	VAQARR		
239	FATMIR	RAMADAN	MURATAJ	KASHAR	340	ASLLAN	VAQARR		
240	SALI QEMAL	SHKALLA	FARKE	KASHAR	341	QERIM	VAQARR		
241	RRAHIM	SULEJMAN	MARKU	KASHAR	342	KOSTA	VAQARR		
242	ILIR SHEFQET	VALISI		KASHAR	343	NAZMI	VAQARR		
243	SADIK	IBRAHIM	HANI	KASHAR	344	AFRIM	VAQARR		

PËRVJETORI

PIRO MILKANI:

Kritikat për filmin "Përse bien këto daulle", Kadare: E kanë me mua

Fatmira Nikolli

Një vajzë e bukur çeke, që shkollohet me të e fle një kat më lart në konviktin e tij dhe me të cilën ka pasur dikur një flirt të bukur dashurie, tashmë ka humbur prej dyzet vjetësh në ndarjen e madhe të ideologjisë së dy shteteve. Një telefonatë pas rënies së komunizmit drejt shoqësisë së tij bukurshme nuk i kujton asgjë Emës në Pragë. Ajo e ka harruar emrin e djaloshtit korçar me të cilin ka shkëmbyer ca puthje të zjarra dikur. Por ironia e fatit dhe kripa e rrëfimit nuk mbaron këtu, vazhdon të tallet si në legjenda edhe më tej. Pas 20 vjetësh të tjerë (domethënë plot pas 60 vjetësh), një natë, në Festivalin e Butrintit, pas shfaqjes, Piro dhe Bebi, gruaja e tij, marrin me dëshirë dy aktore çeke në makinë. Rrugës flet me çekishten e tij të shkëlqyer me të renë dhe me gruan e moshuar gjithfarë bisedash zbatimëse. Pastaj ndahen në hotel. Të nesërmen kap një fletë katalogu dhe risheh emrat e aktorëve të trupës çeke. Mos! Gruaja që solli prej Butrintit në Sarandë dhe u shkruan në qeshuri gjithë rrugës paska qenë vetë Ema Çerna, vajza e ëmbël me të cilën puthje gjasthite dekada më parë... Petrit Ruka ndan një mal me detaje nga libri i mikut të tij Piro Milkani, tekta në parathënien e josh dhe e grisht lexuesin të përpjije kujtimet e regjisorit. Milkani, tani kur mbush të tetëdhjetat, ka moshën e artë të kujtimeve. Në këtë libër, që vjen në 80-vjetorin e tij për lexuesin shqiptar, parakalon një pjesë e vogël, shumë e vogël ngjarjesh nga gjithë ajo jetë e madhe, duke përzgjedhur me një kujdes "shumë koprac" ca ngjarje të bukura që lexohen me një frymë e të tronditimit me bukurinë e tyre të rrallë, me gjetjet e tyre poetike që i ka servitur vetë jeta me koincidenca e saj të befta e të pabesueshme, me tekat e fatit, rinjohjet e befta pas dekadash të tëra terri e izolimi me miq të rinisë, takime me artistë të mëdhenj botërorë, fama e të cilëve të mek mendjen e frymën sapa u lexon emrin. Petrit Ruka shënon në parathënien se Milkani ka xhiruar episode që i ka diktuar kujtesa e një jete. Kohë xhirimesh, debatesh në mbledhjet artistike, rrëfime për skenarët, për kritikë e frikërat nga mbledhjet e stafëve të ndryshme, parakalojnë duke e rrëfyer të shkuarën për të treguar se në ç'kushte punohej dhe krijohje. Me poshtë po shkëpusim vetëm një pjesë nga kujtimet ku rrëfehet dasma e Milkani dhe ekranizimi i romanit "Dasma" të Ismail Kadarese me kritikë para e pas xhirimit.

"Dasma ime me pianisten Margarita Kristidhi dhe penalizimi se mungoi në punë dy ditë"

Regjisorin feston 80-vjetorin me librin me kujtime "E pabesueshme, por e vërtetë"




Piro Milkani dje në promovim

"PËRSE BIE KJO DAULLE" (Pjesë nga libri)

Tamam në kohën kur po përfundim xhirimet e filmit "Ngadhënjim mbi vdekjen", Kadareja hidhte në treg romanin e tij të dytë të titulluar "Dasma". Vinte pas "Gjeneralit të Ushtrisë së Vdekur", që kishte filluar të përkthehej në disa gjuhë të huaja. Filmi "Ngadhënjim mbi vdekjen" ishte pritur mjaft mirë si nga spektatori, ashtu edhe nga kritika zyrtare. Bash për këtë shkak, në një ceremoni kombëtare, krahas çmimeve për vepra artistike të gjinive të ndryshme, Peçi Dadas, Gëzim Erëbarës, Feim Ibrahimit dhe mua na ngulën në gjoks Çmimin e Republikës. Lajtmotivi i muzikës së filmit u bë aq i pëlqyer, sa sigla e hapjes dhe mbylljes së programeve tingëlloi për shumë vjet, tek i vetmi televizion shtetëror shqiptar (RTSH). Ish-te kompozuar nga Feim Ibrahimit, i sapodiplomuar në Institutin e Lartë të Arteve, dega e muzikës. Po e filloja mbarë karrierën e re, atë të regjisorit. Falë këtij filmi, pas një telefonate që iu bë kryetares së Lagjes, nga zyrat më të larta të Partisë, në fund të dhjetorit të 1967-ës e mora autorizimin për një banesë modeste. Një dhomë e kuzhinë në pallatin e ri 202 në fund të rrugës "Mine Peza". Kisha pritur për këtë banesë shtatë vjet, nga dita e kthimit nga studimet e pas katër vjet fejeje me pianisten Margarita Kristidhi apo Bebi, si e thërrisnin të gjithë. Ishte viti që shënoi dhe botimin e romanit "Dasma" të Kadarese. Ndërsa unë kërkjoja skenar për filmin tim të dytë. Ja, për shembull "Dasma" do

të ishte një roman që mund të përshtatej për një skenar filmi, por, ah! Ksenofon Dilo, piktor në Kinostudio, veç të tjerash botonte në gazetën "Drita" shkrime interesante dhe kishte vendosur ta provonte transkriptimin e romanit "Dasma" në skenar filmi. Më keq akoma. Dhimitër Anagnosti, në kërkim të filmit të tij të dytë si regjisor, e kish kopsitur marrëveshjen me Dilon. Do ta bënte ai "Dasmën"....

Sikur të mos mjaftonin lavdërimet, që po bëheshin nga zyrat e rëndësishme të Komitetit Qendror të Partisë, e as elozhet në gazetë e revista politike apo letrare të kohës për vlerat e romanit, ja ku njoftohemi se të nesërmen në mbremje, në Klubin e Shkrimtarëve dhe Artistëve do të kishte një diskutim të gjerë për romanin "Dasma". Salla plot e përplot. Në presidium,



FILMI

Rolin kryesor, atë të Xhavitit, ia kisha besuar 19-vjeçarit Timo Flloko, atë të Katrinës e fitoi maturantja e Politeknikut, Adelina Xhafa. Në rolin e babait të Katrinës zgjedha baritonin e shquar Lukë Kaçe etj., ndërsa bashkëpunëtor shkencor, Fehmi Hoshafin.

Kadareja, Fadil Paçrami, sekretar për kulturën në Komitetin e Partisë të Tiranës, Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve Dhimitër Shuteriqi etj. Diskutantët, njëri pas tjetrit, zbërthenin vlerat, novacionet, metaforat e personazhet interesante të romanit. Dhe tamam kur nuk pritej, del para podiumit Bilal Xhaferrri. Shkrimtar jo pak i njohur, që kishte ngjallur interes edhe ndër në kineastët. I adresoi Kadarese dhe romanit vërejtje të rënda, veçanërisht në kapitujt ku ai e trajton apo më mirë e shtrembëron Kanunin, këtë Kushtetutë të lash-të që ka rregulluar në shekuj marrëdhëniet njerëzore në zonat e thella të Shqipërisë. Asnjë duartrokje nga të pranishmit. Habi dhe stepje. Qetë-qetë u ul në vendin e tij, diku në rrethtin e tretë. Heshjen e theu Fadil Paçrami. - Ti atje, - foli Fadili, pa ia thënë emrin Bilalit, - dil nga salla menjëherë. Dhe i padëshirueshëm për ne. Dhe ashtu u bë. Kokulur doli jashtë. Mbledhja solemne u zhbë. Sesi sh-

koi jeta e Bilalit pas kësaj, do të duhej një kapitull më vete. Pas disa ditësh në oborrin e Kinostudios takoj Ksenofonin.

I shqetësuar më njofton se Anagnosti ka ndërruar mendje. Nuk do që të jetë pjesë e filmit të ri që Ksenofoni ishte duke e përfunduar dhe që e kishte titulluar "Përse bie kjo daulle" (as "Dasma", as "Dasmë e çuditshme", as "Lëkura e daulles" dhe as "Dasma dhe fantazma", si e quajtën më vonë anglezët në radiodramatizimin që i bëri veprës së Kadarese në BBC-në e Londrës). Më propozoi të punonim bashkë për këtë. Nuk e zgjata shumë dhe pranova. Drejtori i Kinostudios, Vaskë Aristidhi, e pranoi këtë ndryshim. Për Kadarenë romani i dytë, për mua filmi i dytë. Ishte shkurti i vitit 1968. U krijua shtabi i filmit dhe filloi puna përgatitore. Të shtunën e parë të marsit (edhe e shtuna ishte ditë pune), mora leje në drejtori. Do të marthoheja. Pas katër vitesh të gjata fejeje, në pritje të një banese. Dasmë i thëncin. Erdhën nga Korça prodhërit e mi, kushëriri i babait, Todi Gjata; vëllai i madh, Bertti, oficer nëndeteseje në Pasha Liman bashkë me gruan e tij, Marieta. Vëllai tjetër, Vaska, kishte një vit që ishte transferuar në Tiranë, si punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë, banonte te ne. Të afërm, vetëm ata që jetonin në Tiranë. Të shtunën në mbremje shkua për vizitë të Kristidhit. Të ardhur nga Maqedonia në vitet tridhjetë, veç Anetës e burrit të saj Genci, ishin edhe disa miq të familjes Kristidhi. Urimet për martesën tonë shoqëroheshin me një gotë raki e ndonjë çokollatë. Vetëm kaq. Pas disa orësh shdreh te ne për vizitë krushqit e gruas. Edhe se të pakta karriget, nuk mjaftonin për të gjithë. Të nesërmen, ditë e diel, 7 prill, shkuam të merrnim nusen. Dolëm në oborr të vilës dhe bëmë disa fotografi. Bebi ishte më e bukur se kurrë. Nuk donte të vishte fustan nusërie, edhe pse deri në ato momente nuk kishte ndonjë urdhëresë që ta ndalonte atë veshje. Ashtu e kishte vendosur vetë. Xhaketa dhe fundi i bardhë ishin qepur me porosi nga një copë e bukur dhe e shtrenjtë, dërguar nga dajë Joni, mjek gjinekolog në Selanik. Dy taksitë e porositura na shpunë të Kodra të Shqipërisë. Asnjë kishës së Shën Prokopit për të shkrepur edhe disa fotografi të tjera. Ramë të flemë në dhomën e gjumit 3,2 me 3,7 metra, ndërsa të tjerët në kuzhinën me aneks. Të martën filloi "muaji i njaltit". Në "Gazin" shtatë vendesh të Kinostudios, veç meje dhe Bebit, që e ulëm në sediljen e parë, u ul edhe Ksenofoni, Todi, Petraçi dhe

asistenti i regjisë Fehmi Hoshafi. Kur mbërritëm në Fier, neve të sediljeve të pasme, na ishte shtrembëruar qafa, se sediljet e 'Gazit' sovjetik, të përshtatshme për luftë, ishin anësore. Të nesërmen, "muaji i mjaltit", përfshinte vizitën dhe fotografimin e Uzinës moderne të plehrave azotike, TEC-in e qytetit dhe barakat e vullnetarëve të hekurudhës Fier-Vlorë, në Mbrostar. Vullnetarë e vullnetare të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë. I fotografonim për të gjetur ndoshta ndër ta edhe ndonjë aktor për film-in e ardhshëm. Në Mbrostar, edhe pse romanin e dija përmendësh, takova një shokun tim që kishte studiuar dikur me mua në Çekosllovakia. Quhej Agim Pirdeni dhe ishte i dërguar i Komitetit Qendror të Rinisë në punimet e hekurudhës. Kureshtja ime ishte të dija se si ndikon qëndrimi i vajzave malësore që në këtë moshë kanë kaluar për herë të parë pranë të shtëpisë dhe të fshatit të tyre.

Ç'të të them, Piro. Përprijnë çdo gjë me kureshtje. Janë po aq të habitura ashtu si ne dikur, kur udhëtonim me vapor, përshkonim me tren gjysmën e Europës për të mbaruar gojëhapur me Pragën magjike. Ja, për shembull, në mbremje, në atë sheshin aty, instalojmë një ekran të madh dhe ato ulen në tokë për të parë film për herë të parë. E kupton? Për herë të parë. T'i lëmë reagimet gjatë shfaqjes, por kur mbaron filmi, tufa-tufa, me marifet, i afrohen ekranit gjithë kureshtje dhe pas pak e hedhin shikimin pas tij. Nuk e kuptojnë se ku i shprehin gjithë ata njerëz që ishin aty në ekran pak më parë. Ekspedita në kërkim të vendeve të xhirimit dhe, eventualisht, të ndonjë aktori të teatrit të Fierit apo vizitat në Berat në Kombinatin e Tekstileve aty, vazhdoi të ditë. U kthyem në Tiranë. Në mëngjes herët i hipa biçikletës për të shkuar në Kinostudio, ndërsa Bebi pak më vonë, po me biçikletë shkoi në Institutin e Arteve. Pasdite u takuam përsëri në shtëpi. Unë i pari i tregova si më pritën dhe më uruan shokët. Pastaj Bebi. Edhe ajo po të njëjtat urime nga kolegët e studentët e saj. Po rreth orës 11:00 drejtori i Institutit lajmëroi degën e muzikës për një mbledhje urgjente. Tematika e mbledhjes: "Shkelje e rëndë disiplinore nga ana e shoqes Margarita Kristidhi Milkani!" Çfarë kishte bërë?... Ishte paraqitur në punë me dy ditë vonesë. Rregullat ishin të qarta: për martesë jepen vetëm pesë ditë leje nga puna. Shkelje e rëndë e disiplinës në punë. Çfarë do të bëhej me të? Ulje në detyrë, dërgim për riedukim apo... Varej shumë sesi do të reagonte vetë ajo. Pra, si e kuptonte këtë gabim. Si do të ishte autokritika e saj. U ngrit në këmbë dhe foli shumë shkurt: - E kuptoj gabimin dhe e pranoj. Por sinjerisht nuk e dija se leja e martesës ishte vetëm për pesë ditë. Ndaj ju premtoj: nëse do të martohem një herë tjetër nuk kam për ta përsëritur këtë gabim. Salla qeshi.



Ismail Kadare, Adelina Xhafa (Katrina), Piro Milkani dhe Ksenofon Dilo, në setin e xhirimit në Kinostudio, 1978

pesë "malësoret", shoqë të Katrinës. Me Irenën. Falë këtij filmi, nga martesë e Bertit me Irenën, lindi Aulona. Ndërsa unë prisja të lindje djali im i parë, Eno. 86 Kur filmi përfundoi, pasi kaloi gjithë filtrat e kohës, këshill artistik, komision nga Ministria e Kulturës e Komiteti i Partisë, vizionimin nga kolektivi i Kinostudios e kaloi me sukses edhe provimin më të rëndë: shikimin e tij, atje në Bllok, nga shefi i madh i propagandës, Ramiz Alia. Edhe Kadareja nuk doli i zhgënjyer.

- Është filmi më i çuditshëm i "Botës së Tretë". Dukshëm bënte dhe humor me teorinë e Mao Ce Dunit, që e ndau botën në tri pjesë (si të ishte një tortë e madhe). Më botën kapitaliste, në atë revizioniste (Bashkimi Sovjetik dhe satelitët e saj në Europën Lindore) dhe në Botën e Tretë (Kina në vend të

MARGARITA
Tematika e mbledhjes: "Shkelje e rëndë disiplinore nga ana e shoqes Margarita Kristidhi Milkani!" Çfarë kishte bërë?... Ishte paraqitur në punë me dy ditë vonesë.... Varej shumë sesi do të reagonte vetë ajo. U ngrit në këmbë dhe foli shumë shkurt: - E kuptoj gabimin dhe e pranoj. Nuk e dija se leja e martesës ishte vetëm për pesë ditë. Ndaj ju premtoj: nëse do të martohem një herë tjetër, nuk kam për ta përsëritur këtë gabim. Salla qeshi.

kishte pasur rast ta shikonte film-in e ri që po shfaqje në të gjitha kinematë e Shqipërisë. Kur ai i tha se ende nuk e kishte parë, atëherë punëtori i thotë se në film ka disa shfaqje të rënda idesore që bien në kundërshtim me orientimet e Partisë.

- Po ç'janë këto shfaqje? - e pyeti kryeministri - Po ja, në atë film ka një skenë dasme në një barakë vullnetarësh të hekurudhës Fier-Vlorë. Ajo malësorja martohet me një montator dhe ata të filmit, pa një pa dy e veshin atë nuse me vello. A nuk janë këto shfaqje të mentalitetit borgjez? Pasi u mendua një copë herë kryeministri, i thotë atij:

- Po ju, pse rrimi duarkryq? Shkoni atje në Kinostudio dhe u tregoni atyre se si bëhen filmat. Lajmi u përhap në qytet si kolerë. Në të gjitha gazetat e kohës, në këndin e rubrikës kulturore, shkrime rënduese. Gazetari më i zellshëm doli ai i gazetës "Luftëtari", M. Shehu quhej. Përveç mendimit të punëtorëve të Kombinatis, shtoi edhe ca "thagma" të tjera për shfaqjet e huaja në film. Gruaja ime, Margarita, pati një lindje të vështirë me Enon. Kështu që mjekët e këshilluan të qëndronte edhe disa ditë në maternitet. Mua më ishte përmbystur bota. E, megjithatë, çdo ditë shkoja te trotuari i maternitetit që të shihja atë dhe krijesën tonë të përbashkët. Në dritaren e katit të katërt shfaqje Bebi e lumtur me Enon e vogël. Më duhej të luaja "babane e lumtur". Në maternitet nuk shkonin gazetat as lajmet e fundit të pazarit. Një ditë, duke u larguar nga materniteti, filloi një vesë shiu pranveror. Eçja kuturu, këmbët më çonin drejt qendrës së qytetit. Një burrë me çadër, më afrohet dhe ma fut kokën poshtë saj.

Të nesërmen, në hollin e Kinostudios, erdhën ata, kontrolli punëtori i Kombinatis të Autotraktorëve. Takim i akullt me mua. Më thanë se donin ta shikonin edhe një herë film-in. Ishim të përgatitur për këtë. Filmi ishte vendosur që më parë në ingranazhet e aparatit të projeksonit në sallën e vogël të projeksonit. Gjatë shfaqjes, heshtje varri. Kur u ndezën dritat e sallës, i pari e mori fjalën ai, më i zoti i të gjithëve. I kam harruar me kohë emrat e tyre, po emrin e atij e mbaj mend akoma. Quhej Harilla.

- Po si ka mundësi, mo shoku Piro, të biesh në gabime të tilla? I pezmatuar sa s'ka, mundohesha t'u shpjegoja se fustani i malësore Katrinë, nuk ishte fustan dasme, po një copë gri e çelët terital, prodhim i Kombinatis të Tekstileve. Se ajo copë e vogël fare nuk ishte vello, po një copë tili bardhë. Se gjatë gjithë filmit Katrina dhe shoqet e saj ishin të veshura me kominoshe. Si të bënim? Ta martonim me kominoshe?



Dita e dasmës së Piro Milkani, me Margaritën dhe vëllain, Vaskë Milkani

VËREJTJA

- Po si ka mundësi, mo shoku Piro, të biesh në gabime të tilla? I pezmatuar sa s'ka, mundohesha t'u shpjegoja se fustani i malësore Katrinë, nuk ishte fustan dasme, po një copë gri e çelët terital, prodhim i Kombinatis të Tekstileve. Se ajo copë e vogël fare nuk ishte vello, po një copë tili bardhë. Se gjatë gjithë filmit Katrina dhe shoqet e saj ishin të veshura me kominoshe. Si të bënim? Ta martonim me kominoshe?

parë, vendet e paangazhuara të Azisë, Afrikës e Amerikës Latine e, natyrisht, edhe Shqipëria). Ismail Kadare, Adelina Xhafa (Katrina), Piro Milkani dhe Ksenofon Dilo, në setin e xhirimit në Kinostudio, 1978. 87 Laboratori i filmit, në Kinostudio, prodhoi urgjentisht 26 kopje të filmit që u shpërndanë në gjithë rrethet e Republikës. Edhe shtypj nuk po e priste keq. Kënaqësi. Po tamam atë ditë, kur e shoqërova gruan time në maternitet për të lindur, në Kombinatin e Autotraktorëve, kryeministri i vendit, Mehmet Shehu, bashkëbisedonte me punëtorët sesi po shkonte puna me prodhimin e traktorit të parë shqiptar. E pikërisht në atë moment, një punëtor, anëtar i grupit të kontrollit punëtor (të tilla grupe kontrollësh kishin lindur në çdo ndërmarrje të vendit) e pyeti kryeministrin e tij nëse

saj ishin të veshura me kominoshe. Si të bënim? Ta martonim me kominoshe? A nuk duhej të ishte pak më ndryshe ajo që po mar-tohej me Xhavitin? Asgjë nuk i bindi. U larguan gati të zemëruar. Ishte ditë e diel. Duke shtëtitur si të shastitur rrugëve të Tiranës, kujtonim atë që na thoshte Kadareja: "Nuk e kanë me juve. E kanë me mua. I bien deriçkës që të dëgjojë dera. Më besoni!". Beso-beso, po ne do ta hamë. Kaluam diagonal "Parkun Rinia". Ajo e diel marsi kishte një diell përvëlues. Apo ndoshta kështu na duket ne. Ora e sahatit të madh të qytetit shënon-te 14:30. Dhe ja ai. I ulur në një stol. Ishte Dhimitër Tutulani. Vëllai i dëshmorëve të Beratit, Margarita dhe Kristaq Tutulani. Tip kontrovers. Llafazan i pashërueshëm. Nuk e zgjati, po na priti me të parat. - Hë mo ju. Pse sorollateni kot më kot? Apo bëni sikur nuk dini gjë? - Çfarë të dimë? - e pyeti Ksenofoni. - Atë mo, atë mbledhjen që do bëhet nesër në Pallatin e Kulturës... nesër pasdite në orën pesë do bëhet një mbledhje e madhe për ju. Do ju kritikojnë, pastaj ju do bëni kot fare autokritikë po vendimi njëjlojtë është marrë. Do shkoni për riedukim në gjirin e klasës punëtore. I kni tani se ma prishët qetësinë. Po kjo pikë e zezë? Ku i di ky i marrë këto gjëra?... Po sikur të jetë e vërtetë? Filluam të shqetësohemi. Pastaj na u kujtua Dragush Goxhi. Për disa vjet kishte punuar në Kinostudio, por më vonë e transferuan në Pallatin e Kulturës. Dragushi po, ai duhet të dinte diçka. Si të bëjmë? T'i shkojmë në shtëpi? Po sikur të jetë bluf, pse ta shqetësojmë në këtë orë të papërshtatshme? Të dalë ku të dalë. Kush pret deri nesër. E dim se ku banonte. Të bulevardit "Stalin", tek ato palaçinat karshi farmacieve. U ngjitem në katin e tretë dhe i ramë veshes. Pas pak Dragushi e hap derën. Dukej se i kishim prishur gjumin e pasdites. I ngrysur na pë në sy.

- Dragush! Na fal për shqetësimin, po takuam para një ore një budalla dhe seç na tha diçka për një mbledhje që do bëhet nesër në Pallat. Heshtje... Na shikonte dhe nuk fliste... po mendonte.

- Kush budalla jua tha? - Ai bre, Dhimitri, Dhimitër Tutulani. Këtë herë heshtja ishte më e gjatë. Nuk i lëvizte asnjë muskul i fytyrës.

- Kështu na thanë dhe ne... po dje pasdite na lajmëruan: "Mbledhja anulohet. Ditën e mirë!". Nuk dinim ç'të bënim. Të gëzohehim? As që bëhej fjalë. Po edhe të mërziteshim, nuk kishte tashmë arsye. Filmi vazhdoi të shfaqej edhe për disa kohë në kinematë e Shqipërisë. Shtypj nuk u mor më me atë film. As për mirë, as për keq. Vetëm shumë kohë më vonë e zbuluam sekretin. Ksenofoni kishte në Komitin Qendror të Partisë burrin e kushëririës së parë. Ato që Mehmet Shehu i kishte thënë në Kombinatin e shkuan në vesh edhe Ramiz Alisë. Nuk ishte Mehmet Shehu ai që pasi kishte parë në Berat ekspozitën e një piktori me mbiemrin Shelegu dhe kishte bërë titullin: "Çfarë shelegu ky more!!!! Me këto piktura ky është ujk". Dhe Shelegu shkoi për riedukim. Po tani? Ta linte parë në dorë të tij? Goditja e filmit e cenonte indirekt dhe atë, sekretarin e Komitetit Qendror dhe anëtarin e Byrosë Politike. I shkoi në zyrë direkt atij të madhit, Enver Hoxhës, dhe u ankuu se shoku Mehmet po ndërhynte në punët e sektorit të tij. Enver Hoxha i dha të drejtë. - Nuk kemi se çfarë t'i bëjmë. Ashtu është ai. Nganjëherë edhe trëmbëhet. Po ti vazhdo në punën tënde.

Unaza e Re/ "Të Paeksponuarit" publikoi mashtrimin e kompanisë në SHBA

Gjikhuri: Zgjidhim kontratën, nëse do konfirmohet falsifikimi

"Pres përgjigjen e autoriteteve amerikane"

Fill pasi emisioni "Të paeksponuarit" transmetoi mbremjen e së enjtes në "News 24", megaskandalin me tenderin e Unazës së Madhe, vjen reagimi i ministrit të Infrastrukturas dhe Energjisë, Damian Gjikhuri. "Atyre që duan të bëjnë politikë me Unazën e Re dhe kujtojnë se gjetën shtegun e revolucionit, pasi u katandisën me 100 protestues profesionistë të Bashkisë Kamëz nga mbrapa, u them kaq: Ndryshe nga ju që kur qeverisnit shisnit Shqipërinë me letra false, sot autoritetet e shtetit po bëjnë detyrën. ARRSH ka pezulluar projektin për lotin nr.1. Unë si ministër u jam drejtuar autoriteteve amerikane për verifikimin zyrtar të shqetësimit të bërë publik në media", shkruan Gjikhuri në "Facebook". Në vijim ministri Gjikhuri pohon se u është drejtuar autoriteteve amerikane për verifikimin zyrtar të shqetësimit të bërë publik në media. "Unë si ministër u jam drejtuar autoriteteve amerikane për verifikimin zyrtar të shqetësimit të bërë publik në media. Kompania në fjalë nuk ka marrë asnjë qindarkë nga Buxheti i Shtetit dhe garancia e saj fi-

nanciare do të sekuestrohet, në rast se dokumentet e paraqitura prej tyre në garë nuk janë autentike. Në fillimjavën e ardhshme presim përgjigjen e autoriteteve amerikane. Nëse përgjigja do të konfirmojë falsifikimin e dokumenteve nga kompania, atëherë pa diskutim do të reagojmë menjëherë me zgjidhjen e njëanshme të kontratës dhe referimin e rastit pranë organeve të drejtësisë", shkruan Gjikhuri.

POSTIMI I PLOTE

"Atyre që duan të bëjnë politikë me Unazën e Re dhe kujtojnë se gjetën shtegun e revolucionit, pasi u katandisën me 100 protestues profesionistë të Bashkisë Kamëz nga mbrapa, u them kaq: Ndryshe nga ju që kur qeverisnit shisnit



Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Damian Gjikhuri

Shqipërinë me letra false, sot autoritetet e shtetit po bëjnë detyrën. ARRSH ka pezulluar projektin për lotin nr.1. Unë si ministër u

jam drejtuar autoriteteve amerikane për verifikimin zyrtar të shqetësimit të bërë publik në media. Kompania në fjalë nuk ka marrë asnjë

qindarkë nga Buxheti i Shtetit dhe garancia e saj financiare do të sekuestrohet, në rast se dokumentet e paraqitura prej tyre në

garë nuk janë autentike. Në fillimjavën e ardhshme, presim përgjigjen e autoriteteve amerikane. Nëse përgjigja do të konfirmojë falsifikimin e dokumenteve nga kompania, atëherë pa diskutim do të reagojmë menjëherë, me zgjidhjen e njëanshme të kontratës dhe referimin e rastit pranë organeve të drejtësisë. Ky është dallimi i madh mes nesh dhe jush. Ne nuk i fshihemi asnjë përgjegjësi shtetërore dhe as kemi gjë për të fshehur. E thënë ndryshe, shqetësimi juaj është si të shisni baltë për të mbuluar të kaluarën tuaj, ndërsa qëllimi ynë është si të hapim sytë dhe zhvillimit të Shqipërisë që ju rrënuat". Shkruan Gjikhuri në "Facebook".



REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit".

1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË PARË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime në fushën IT.
- Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË DYTË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.

KËRKESA TË POSAÇME TË POZICIONIT "PËRKTHYES":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht- Shqip;
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTET PËR GJITHSHME PËR VENDET VAKANTE "SPECIALIST IT" DHE "PËRKTHYES"

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për të pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për të përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.


Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 12 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.



Kolë Bibë Mirakaj (1899 - 1968), ka punuar më sues, kryetar komune gjatë qeverisjes së Fan Nolit dhe Ministër i Brendshëm në periudhën Maj - Shtator 1943. Jeta e këtij Nolisti, "Fashisti", dhe intelektualit e atdhetari të shkëlqyer meriton të rishkruhet. Kjo për shkak anatemimit të pamerituar që i është bërë atij për më se pesëdhjetë vjet.

Në vitin 1943 kur forcat gjermane po mbërrinin në Shqipëri, Kolë Bibë Mirakaj ishte Ministër i Brendshëm. Në atë kohë një numër i konsiderueshëm hebrenjsh ndodhej në territorin shqiptar. Jeta e tyre ishte në rrezik serioz nga nazistët gjermanë. Por çfarë bëri Kolë Bibë Mirakaj, në atë kohë ministër i Brendshëm, për t'u shpëtuar jetën këtyre hebrenjve.

Këto dy faksimile të bëra të njohura nga Dr. Nevila

Nika dhe Faik Quku, autori i librit "Qëndresa Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botnore" (1941-1944) që po i ribotojmë sot flasin flasin vete.

Një urdhër i tij i datës 31 gusht të vitit 1943, detyronte pajisjen me pasaporta shqiptare për të gjithë hebrenjtë që ndodheshin në territorin e vendit tonë në atë kohë. Përmes pasaportave shqiptare ata mund të udhëtonin e të gjenin stre-

him në Italinë jugore, pjesë e çliruar në atë kohë prej forcave aleate anglo-amerikane. Me këtë gjest Kolë Bibë Mirakaj u shpëtoi jetën mbi 2000 hebrenjve që ndodheshin në Shqipëri të cilët u pajisën me pasaporta shqiptare dhe udhëtuan drejt Italisë.

Këto fakte shprehin nevojën urgjente të rishkrimit jo vetëm të historisë së jetës së Kolë Bibë

Mirakajt por të krejt historisë së Shqipërisë. Thënë me saktë, shprehin domosdoshmërinë për të pasur një tekst realist të historisë së Shqipërisë. Tekst i cili mund dhe duhet patjetër të jetë jashtë ndikimeve politike, qoftë në trajtimin e këtyre 30 viteve demokraci, ashtu dhe në trajtimin e së shkuarës sonë diktatoriale, monarkike apo dhe asaj koloniale.

Shqipëria ka gati 30 vjet që jeton në demokraci. Po të mos ekzistonin reminishencat e sjelljeve autoritare apo servilizmat ndaj politikave të çastit, të drejtuesve të institucioneve përgjegjëse për tekstat e historisë, këto gati tre dekada do të ishin mëse të mjaftueshme për ta zgjidhur përfundimisht këtë çështje. Por kjo çështje fatkeqësisht nuk u zgjidh.

Po sikur të bënim modelin irlandez për historinë!

Autori përcjell një ide interesante, duke pasur parasysh modelin e Irlandës. Ky shtet ka njohur një pushtim 700-vjeçar prej Anglisë, por duke ditur kredibilitetin e universiteteve angleze, ia dha për t'i shkruar historinë e saj... Oxford-it

→ Vijnë në faqen 14

Në këtë numër: MOIKOM ZEQO, ARIAN LEKA, NDREK GJINI, AGIM JANINA ETJ...

H

HISTORI

Autori përcjell një ide interesante, duke pasur parasysh modelin e Irlandës. Ky shtet ka njohur një pushtim 700-vjeçar prej Anglisë, por duke ditur kredibilitetin e universiteteve angleze, ia dha për t'i shkruar historinë e saj... Oxford-it.

Po sikur të bënim modelin irlandez për historinë!

NGA NDREK GJINI

Vijon nga faqja 1

NE DHE EUROPA LINDORE

Nuk dua të bëj këtu analizën e faktorëve që e kanë penguar këtë proces në Shqipëri. Por dua të nënvizoj faktin se shumë shtete të Europës Lindore që e përjetuan regjimin komunist e kanë zgjidhur këtë çështje. Metodat dhe institucionet që u përfshinë në rishkrimin e teksteve të historisë së tyre janë nga më të larmishmet. Nuk është rasti t'i rreshtoj këtu. Por një gjë është e vërtetë: ato kanë folur më pak se ne për këtë çështje, dhe kanë punuar shumë më shumë se ne. Ndofta ne si reminishencë të së shkuarës kemi sindromën e të folurit shumë dhe të punuarit pak. Po rreshtoj këtu disa mendime sesi mund të zgjidhet kjo çështje.

A MUND TË ADOPTOHEM NË SHQIPËRI MODELIN IRLANDEZ?

Modeli irlandez mendoj se do të ishte i përshtatshëm për një vend si Shqipëria. Irlanda ka përjetuar një pushtim gati 700-vjeçar nga Anglia.

Tekstet e historisë se këtij vendi nga vitet 1922-1923 e deri në mesin e viteve 1960 kanë vuajtur nga patetizmat, megalomanitë dhe shabllonizmat në favor rrymave nacionaliste, apo nga e kundërta e tyre, në mënyrë ekstreme. Sa herë ndërrohin partitë në pushtet ndërrohin edhe tekstet e historisë, rishkruheshin ngjarjet sipas orekseve të politikës së çastit etj. (tamam si në Shqipëri në këto 30 vitet e fundit).

Aty nga mesi i viteve '60, Parlamenti mori një vendim, dhe qeveria akordoi fonde, të cilat u dhanë Universitetit të Oksfordit për të shkruar tekstet e historisë së Irlandës. Këto tekste shërbyen si tekste bazë për shkollat filllore dhe të mesme, ndërkohë që në shkollat e larta u lejuan dhe lejohen përveç këtyre teksteve edhe tekstet alternative. Por, gjatë gjithë kësaj periudhe, asnjëri nuk pengoi, apo dhe nuk pengon, asnjë historian të majtë apo të djathtë të shkruajë e botojë tekste historie sipas oreksit apo bindjeve që ka.


ÇFARË GJELLE MUND TË NA GATUAJNË HISTORIANET E KOMANDUAR NGA POLITIKA?

Personalisht, mendoj se Edi Rama, apo cilido kryeministër shqiptar, do bënte punën më të mençur po t'i akordonte fondet, materialet dhe infrastrukturën e nevojshme një universiteti mirënjohur në Britaninë e Madhe, Gjermani apo SHBA, për të shkruar tekste bazë të historisë së Shqipërisë.

E them këtë, pasi kam bindjen më të plotë që, po t'i pajisë Edi Rama me fonde, materiale dhe infrastrukturë të bollshme institucionet që merren me shkrimin e historisë sot, nesër Basha, apo kushdo tjetër qoftë Kryeministër i së Djathtës, do të japë prapë fonde të tjera, për po këto institucione, të drejtuara nga të tjerë drejtues, për t'i rishkruar nga e para këto tekste histo-



Kole Miraka



Tekstet

Personalisht mendoj se Edi Rama, apo cilido kryeministër shqiptar, do bënte punën më të mençur po t'i akordonte fondet, materialet dhe infrastrukturën e nevojshme një universiteti të mirënjohur në Britaninë e Madhe, Gjermani apo SHBA, për të shkruar tekste bazë të historisë së Shqipërisë.




rie. Dhe kështu, sa herë që do ndërrohen partitë në pushtet, do të rishkruhen tekstet e historisë së Shqipërisë sipas orekseve të politikës së çastit. Dhe, për fat të keq, ky rishkrim do të prekë jo vetëm kapitujt e historisë së katër apo pesë shekujve të fundit, por do shtrihet deri në epokën e gurit. Kjo pasi, këta historianë shqiptarë të paguar, dhe me lidhje personale apo farefisnore me politikën qeverisëse, nuk mund të jenë kurrsesi objektivë.

E them këtë, pasi për arsye dhe motive të panumërta, shqiptarët nuk janë çliruar ende nga zelli i të shërbyerit verbërisht dhe as nga vetëmburrja (në kuptimin e asaj që

thonë se "jam unë ai që i di gjërat më mirë se ti..).

Shqipëria, si çdo komb tjetër i qytetëruar, e meriton t'i ketë tekstet e historisë së saj të shkruara në mënyrë objektive dhe shkencore. Ndërgjegjja profesionale e historianëve shqiptarë, për njëmijë e një arsye, nuk e ka arritur ende atë stad për t'i shkruar këto tekste me paanësi, dhe larg vesit të të shërbyerit ndaj politikës qeverisëse me pasion dhe verbërisht. Kjo është arsyeja se pse mendoj që adoptimi i modelit irlandez është më i përshtatshmi për momentin aktual.



T

TREGIM

A
GOOD
EUROPEANAcht Erzählungen von
Ilija Trojanow
Tanja Dückers
Nasrin Saeed
Vladimir Arsenijevič
Zinaida Lindén
Wilfried M. Sönke
Arian Leka
Oliver RoheFREI — RAUM
Ein Projekt des Goethe-Instituts

NGA ARIAN LEKA

Titulli do të jetë ndryshe. Por nuk ka rëndësi, përderisa fjalja e parë mbetet po ajo. Dita fillon keq! Kjo ishte? Pastaj mbërrin gruaja. Imiton buzëqeshjen e heshtur të Romy Schneiderit, të *Çiftja e vjetër* dhe flet. Vetëm flet. Kur nuk gjen shpjegim, përdor lotët: armën sekrete. Afrohu. Çfarë shikon? Asgjë? Atëherë lëre gruan të flasë. Mбай vesh se çfarë thotë para se të futet në banjë: – Jam aktore. 35 vjeç. Nuk kam qenë kurrë e lirë. As atëherë. As tani. [Gruaja hesht. Del nga dhoma. Hyn në banjë. Mbyll derën. Një. Dy. Tre. Katër herë. Prej thërret prej andej. E dëgjon? Dëgjohej. Edhe përmes mureve dëgjohej. Afrohu edhe pak.] – Sa ishja e vogël, më ruante babai. U bëra zonjushë gjasme, kur filloi të më përgjonte ai. Kush? Kush tjetër?! Im vëlla. Hëm!

Hyn brenda. Më duket se ta kam thënë, apo jo? Banja është vendi ku takohemi. Të gjithë. Sapo dalim prej aty, secili hyn në zgëqin, kuvlinë, skutën apo në vrimën e vet. E! Të papunë të të gjitha vendeve, bashkohuni! Në WC. Në qenef. Në halë. Në banjë. Në tualet. – Pastaj se nga na mbive ti...! Kaq tha gruaja. E dëgjoje?

Janë fjalët e saj apo dialogët nga roli të ri? Afrohu! Çfarë sheh? A duket prej aty një burrë në moshë? Ai është babai. Ta thotë vetë se çfarë mendon ai. Më vonë. Po një grua, që tundet tekta ecën, e sheh? Ajo është nëna. Tani për tani nuk ka asgjë për të thënë. Po një vajzë jo edhe që të vogël, e sheh? Po mua më dallon? Jam ai që po pi cigare në ballkon. Pres të kalojë vrulli i mëngjesit dhe shtëpia të bjerë në qetësi. Kaq është familja jonë? Jo! Janë dhe komshinjtë. Afrohu, që t'i shquash mirë. Nuk kanë ndonjë rol në këtë rrëfim, por nëse do të mësoh dikça për shtëpitë filloje nga muret. Janë aq të hollë sa pëshpëritjet, ofshamat, ulërimat, rënkimet, britmat dhe belbëzimet dëgjohej. Ja. Tani janë fqinjët e krahut të djathtë që po rrihen, duke kërcënuar njeri-tjetrin me jetë. Një javë më parë, irlandezi kuqalash, me të cilin ndaj murin e dhomës, përplas ballët e shtratit, sa herë që vë poshtë aziatikun e thatë me të cilën jeton. Kur balli i shtratit të tyre përplasat deri në shkallim pas murit tonë, vështroj babanë. – Drogohet, më thotë. Leksioni 1. Muret kanë veshë. Na dëgjojnë, i kam thënë sime bije. Drogohet, përsërit babai.

Babai di. Të gjithë. Për këdo. Mabajnë vesh. Përgjojnë. Kuptohet nga bisedat. Zërat e ulët. Kur flasin ulin kokën. Dhe sytë. I vetmi që guxon të ngrihet lart në gjithë atë shushamë është zëri i evgjijit (nëse na lejohej ta themi, ndryshe e prishim fjalën evgjijë dhe gjejmë një tjetër ndërkohë.) Na fton të dorëzojmë vjetërsirat që kemi në shtëpi. – Hajde hekra t'vjetra! Vështroj babanë. Ai është gjëja më e vjetër në shtëpi.

Shkrimtari shqiptar Arian Leka paraqitet në antologjinë “A Good European” me tregimin “Paranoja”, përkthyer në gjuhën gjermane nga Zuzana Finger. Tregimi nënvizon idenë se liria ekziston si një premtim, por mungon në jetën e përditshme. Në “Hyrjen” e antologjisë, shkruar nga Cristina Nord, e cila merr në shqyrtim edhe tregimin e Arian Lekës vërehet se kjo është jeta: për sa kohë që je i ri, ajo shfaq përballë teje shumë mundësi. Por koha shkon dhe sa më shumë vendime marrim, aq më shumë biem, rrëzoheni, mundësitë pakësohen, mbetemi mënjatë dhe, njëjloji si protagonist në tregimin e Arian Lekës “Paranoja”, vërejmë se kemi ndryshuar krejtësisht, e kemi humbur atë që kemi pasur, më së shumti lirinë, se jemi rënduar, nuk mundemi të fluturojmë si dikur dhe aty ku dikur priteshin të na dilnin flatra ka mbirë lesh i zi. Vazhdon zvarritja. Rënia. Antologjia “A good European” ka bërë bashkë 38 Institute “Goethe” në Europë dhe partnerët e tyre, për t'u marrë me çështjen e lirisë në qytetet e Europës dhe adreson pyetje të gjera si ç' do të thotë fjala liri në Europën e sotme? Çfarë vlere ka liria? Ku ndihet më fort kufizimi i lirisë? A është liria në rrezik? Titulli i kësaj antologjie i bëri bashkë këta shkrimtarë të njohur evropianë, të cilët janë shprehur mbi vetëdijen evropiane dhe mbi konceptin e lirisë, në kuadrin e një projekti të gjerë evropian, titulluar “Freiraum”.

“PARANOJA”



Kaloj nëpër korridor. – Kemi ndonjë gjë për të hedhur, baba? Më peshon me sy. Që nga koha e eksodit të marsit, kur flakëm në rrugë çdo gjë të vjetër që kishim, për t'i zëvendësuar me laminatë dhe llamarinë italiane, kam parë të njëjtën ëndërr. Një furrë të madhe. – Soba. Lavatrite Herka t'vjetra! – Ti po, vazhdon monologun ime shoqe nga banja. Liria vetë, ti. Më dhe liri atëherë. Por më ruaje. Në distancë. As kot nuk paska shpëtim. Nuk më ruan babai. As vëllai. As ti. Më është qepur vajza. Po, po. Vajza jonë. Ajo bukurshja. Që të ngjan ty. – Imë bijë...!, e plotësoj.

Ajo del. Fik dritën. Përplas derën. Banja bosh. Fjala atëherë, me të cilën ime shoqe filloi ankimet, përplasat pas cipës së timpanit të veshit tim. E ke vënë re? Askush nuk përdor fjalë të përpikta në shtëpinë tonë. As emra. *Dikush. Gjithkush. Kushdo.* Kuptoj. Time shoqe kur thotë: fshihemi të njëri-tjetri. E kuptoj. Thotë dikur. Shqipton fjalën atëherë, kur nuk dëshiron ta thotë fjalën diktaturë.

Ndez dritën. I pari objekt që shoh kur hyj në banjë është... Prej disa kohësh ime shoqe e ka pasuruar banjën. Me një objekt të ri. Meriton përshkrim. – Nuk është turk, as kinez, si ata regjistrorët e tu, më tha tekta e nxirrte nga kutia

gjithë kujdes. – Është Richard Salter. Punë, jo lodër!

Ishte peshore. E markës Richard Salter. Me një sy të madh prej xhami në mes. Pakashumë si sytë magjikë që çdokush montuar në derën e jashtme të shtëpisë. Syri i Salterit më vështron. Rreptë. Me qortim. Majtas 120. Djathtas 10. Zero në mes. Mes atyre shifrave rri unë. I gatshëm për peshë. Sa duhet të jem? Fishkëllej, tekta derdh ujët e hollë. *Stuck in the middle with you.* Klounë majtas / Xholë djathtas / Kam ngecur mes jush. – Do kisha dashur barometër...Në vend të peshores, i thashë sime shoqeje, kur Richard Salter i hyri në shtëpi. – Për të marrë dublurorin kryesor, Fionën të Shrek 3, zërin që bën Cameron Diaz, kupton, duhet të bie 7 kg.

Shtyp butonin shkarkues. Zbrazja e ujrave më çliron. Gjithçka që më ka ardhur në në majë të hundës dhe fel prej mëje bashkohet me ujrart e zezat, të bardha e të turbullta dhe, prej aty zhduket nëpër sifonë, kanale e gropa grumbullimi, për të mbërritur kushedi se ku, në kushedi se cilën pikë grumbullimi. Kthehem përballë Richard Salterit. Hipi. Shigjeta vërtitet mes 70 dhe 90. Kam rënë? As një grimë. Kam shtuar. 300 gramë. Kjo çmend. Gruan time, më

shumë se mua vetë. – Ç'të jenë ato 300 gramë që shton, kur nuk pi më alkohol, kur ke hequr brumërat?, do thotë. Dera e banjës troket. – Dil! Vajza vonë për shkollë.

Është ime shoqe. Troket mbi portë e parajsës sime. Jam gati, por nuk dal. Fik dritën. Ulem mbi WC. Fishkëllej. Gjithçka zhytet në errësirë. Shumë e errët për të parë. Gjithçka zhduket. Edhe Richard Salteri. Dëgjoj gruan time, që vazhdon të trokasë mbi derën e Heaven's Water Closed. Që nga viti 1973, kur linda, Bob Dylan më thotë të njëjtën gjë: dorëzohu; lësho armët; mos lufto. Ndez dritën. Orenditë e zhdukura zënë vendet e tyre në banjë. Një. Dy. Tre. Hap derën. Dal. Rëndë-rëndë. 300 gramët peshojnë. – Nuk je më si dikur!, tha ime shoqe, tekta më AF! Nuk ma përmend emrin. Jam përmerrë vetor. Dikush. Kushdo. Jo Richard Salter.

Kam dalë. Shtrihem në cep të shtratit. Jo në anën e saj. Fare pranë murit të përbashkët, ku irlandezi kuqalash përplas ballët e shtratit. Zaptoj gjysmën time. Vëzhgoj trupin. Në rregull si inventar. Gjithçka dyshe. Nga lart poshtë. Veshë dy. Dy sy. Dy duar. Dy krahe. Dy këmbë. Dy veshka. Mushkri e ndarë më dysh. Zemra me dy barkushe. Dy koqe. Dhe unë, që kam ngecur mes tyre.

Kaloj dorën nëpër flokë. Pastaj në të kundërt. Nga gjoksi në shpinë. Aty ndalem. Kuptoj. Më mirë. Time shoqe. Në vendin ku duhet të më kishin mbirë flatra, siç i kisha premtuar asaj se do të mbinin një ditë dhe se prej asaj kohe do të fluturonim bashkë, dalloj se ka filluar të mbijë... Afrohu! Më pranë! Çfarë pe? Qime të ashpra. Lesh i zi. Ja pse nuk mundem të fluturoj! Si dikur: Faji i 300 gramëve? Jo. Qimet? Leshi i zi? Jam burri. Djali. Babai që sjell bukë, por jo gëzim në shtëpi. Ka të drejtë. Ajo. Edhe im atë. Jam makinë që nxjerr tym. Punoj me elektrik? Me gymyr të zi? Me dru? Me avull? Me hidrogjen? Jo. Punoj me mërzë!

Kaq do ishte e mjaftueshme për ta helmuar vazhdimin e një rrëfimi që nis me... Dita fillon keq. Por jo. Hedh sytë drejt laptopit, ku me titullin DOKTORI, ruaj përkthimin e filmat Doktor Zhivago me Omar Sharif. Në ekran shënim: New e-mail.

Pamja 2: Ngrihem nga shtrati, marr laptopin mbi prehër dhe, derisa të hapet posta,

→ Vizion nga faqja 15

prej së cilës lexoj vetëm titullin URGENT, bëj gati cigaren, të cilën do e ndez në ballkon. Shoh lagjen. Nga lart poshtë. Taracat e pallateve me depozitat e ujit dhe një zorrë, që i bën të duken si elefantë mbi shkretëtirën prej betoni. Shoh rrugën dhe tregjet e frutave mbi trotuar. Lexoj: Zürich. Farmaci. Bruxelles. Parukeri. London. Flokë: Hair Extensions. Thonj & Qepalla: Nail & Eyelashes Extensions. Shoh edhe turmën që nxiton. Ajo më gëlltit babanë (që do të dalë të pijë kafënë me shokët) nënën (që do të dalë të bëjë pazar) gruan (që do të shkojë në audicion) dhe vajzën (që sapo është futur në banjë dhe po bëhet vonë për në shkollë.) Nuk do të jem në gjendje t'i mbroj. Do të mbetem në shtëpi. Vetëm me Richard Salterin. Më ka shkruar ndër mend ta ekzekutojë. T'ua jap ërvëjtëve [zëvendëse këtë fjalë] të hekrave t'vjetra për skrap. Por ime shoqe e do. Richard Salterin. Ka të drejtë të dashurojë Richard Salterin. Ta mbajë edhe në gj. Një ditë u qurravit edhe ime bijë. Erdhi drejt meje krahëhapur dhe kërkoi të më ulët në prehër. – Nuk ke vend të lirë?, më tha. Ai rri aty ku unë nuk jam ulur kurrë, shtoi dhe ia dha të qarit e duke goditur laptopin në prehrin tim.

E kam mbaruar cigaren, por kam dëshirë ta shoh sesi fundqja bie, pasi e kam flakur nga ballkoni. Kthehem. Drejt dhomës. E-maili i porsambërritur është ngatërruar mes uljeve të cmimeve, këshillave për kredi të butë, pyetësorëve dhe 10 porosive për të rënë në peshë. – Ndonjë ftesë?, pyet ime më, që pret radhën në korridor. Ka kohë që nuk mbërrin. – Të kanë harruar, thotë ajo. Të gjithë. Edhe faturat e dritave vijnë në emrin e babait, jo në emrin tënd. Mbërrin. Në dhomë. Teksa pres që në ekran të shfaqet teksti i ri, në vend të fjalës BOTUES – e vetmja që do kisha dashur të shoh, dëgjoj babanë që më thotë:

– Be Genius or...Vazhdimin e di. – ...or Find a Job...

Si do të tingëllonin, nëse im atë do të m'i thoshte në shqip? – Gjej punë, ose... Pirdhu...! Im atë nuk e ndyn gojën. Habitem! Si nuk ka plasur deri më sot?! Pa mallkuar! Pa sharë! Pa ulërirë! Për tim atë historia është mbyllur. Nuk ka më vend. Aq më pak për njerëz si unë. Që përkthejnë për bukën e gojës. Si përkthejë unë? Pa dëshirë. Njëlljoji siç përkthente dikur ai.

Pamja 3: Duhet të shoh se ku e kam lënë gruan dhe vajzën. Se ku ndodhet nëna e di. Sapo ka thënë: Të kanë harruar të gjithë! Kaq ishte roli i saj. [Duhet të kujtohem t'i jap një fjali edhe në fund.] Po babai? Afrohu. Lëre të flasë. Kam qenë përkthyes, të thotë. Nuk dëgjon. Ta ngre pak zërin? Flas rrallë. Në shtëpinë botuese "8 Nëntori", po. Kam emër të shkurtër. Të kujton diçka të vogël, që nuk rritet. Lec. Kam qenë njeriu i leximit të fundit. Syri i Ftohtë. Syri Tretë. Kështu më quanin. Nuk është pseudonim. Nuk ishte nevoja të isha spiun. Cila ishte detyra ime? Kontrolllova përkthimet e librave politikë. Mbikëqyra punën e të dënuarve, që përkthehen nga burgjet. Për llogari të pushtetit popullor. Emrat tyre nuk u shfaqën kurrë si përkthyes të literaturës marksiste. As emri i im nuk u shfaq. Në listën kombëtare të profesionëve, zanati im kishte shifrën 2634/01-07. Nuk ishte kod. Nëse vepra përkthehej gjermanishtja, syri i dytë e përballte me frëngjishten, ndërsa unë mbikëqyrja dy versionet e para me një version nga gjuha e tretë. Ndonjë kujtim? Po ja! Si ta them? Se nuk dua as të mburrem. Atë fjalinë e "Tetëmbëdhjetë Brymerit të Lui Bonapartit", atë që bën fjalë për personazhet që i shfaqen historisë dy herë, një herë si tragjedi dhe një herë si farsë, e kam sjellë në shqip unë. Po. Kaq. Çfarë t'i them sime bije? Se gjeniu që e gjeti zgjidhjen e Tetëmbëdhjetë Brymerit ishte gjyshi i saj, ky që sot më hakërrëhet duke ma përplasur në fytyrë:

– Be genius or...!

E di. Të gjej punë. Nuk e di. Thua ta ketë përmbushur im atë *Liberté – Egalité – Fra-*

ternité? Një pjesë po. I barabartë me shokët në shumën e pensionit mujor; Vëlla e motër me nënën time në shtrat; I lirë për të zgjedhur se ku do e pinte kafenë: në Bar Bruxelles apo në Zürich apo në Cafe-London? Për të historia është mbyllur. E di evolucionin e racës së tij. Nga gjembi, gjembi. Nga trandafil, trandafil. Vazhdimin e marr me mend:

– Nga përkthyesit, përkthim.

– Do të fitosh para? Milioner në një minutë? Përgjigjuni! Super-Gjuz...!

Banja e lirë. Ime bijë ka dalë.

Pamja 4: Askush në familje nuk e di se ajo që unë dua të bëj nuk ka lidhje me përkthimin. Nuk dua të kem të njëjtin profesion si im atë. Nuk dua të jem as sy i tretë as sy i katërt. Gjëja që dua është të shkruaj. Prandaj dhe mbaj shënime. Çdo muaj çoj një synopsis. Gruaja nuk di. Ndaj rri me veshët ngrehur. Përgjon e-mailin që nis dhe që mbërrin në inbox. Mendon se kam dashnore. Është e bindur. Nuk dyshon. Kërkon të dijë nëse është përkthyesja bythëvogël e redaksisë, që buzëqesh si Penelope Cruz apo ajo tjetra, që spërdridhet si Scarlett Johansson? Pres botuesin. Përgjigjen e tij. Pres të lidhet interneti dhe të lexoj e-mailin që ka mbërritur. Shtrihem sëris në shtrat. Prek trupin. Vëdin e caktoar për flatra, ku ka mbirë lesh i zi. Gruaja afrohet. Më vjen pranë. E di se çfarë mendon: Je shëndoshur! Je bërë punishte që prodhon mërzil! Nuk e thotë: – Si nuk bën një përpjekje të vogël për...! E di. Nuk bëj asnjë përpjekje për ndryshim.

Ngrihem nga shtrati. Vë kufjet. Më

rë thirrorët "baba", "nënë", gjyshe", "gjysh". – Jepi! Koha po mbaron! Edhe 10 sekonda, konkurrenti 1!

– Çdo force goditëse i përgjigjet e kundërta e saj, përgjigjet im atë nga banja.

– Gabim, i konkurenti 1! Sapo i humbët 100 milion! vazhdon ime bijë. Që të ngjan ty, ka thënë në fillim ime shoqe. Na ngjan. Është kokulur. Edhe në kokulur kishim qenë, por tjetër lloj. E vetmja gjë që kërkon janë bateritë. E dua atë fëmijë. Ndonjë ditë do e heq laptopin nga prehëri dhe do marr time bijë.

Pamja 5: Im atë ka hyrë në banjë. E dëgjoje çelësin kur u rrotullua? Katër herë. Im atë nuk hyn kurrë vetëm. Merr telekomandën. Telekomandim në distancë. Kështu ka ndodhur. Gjithmonë. Edhe ai, njëlljoji si vajza jonë, ka nevojë vetëm për bateri. Kaq. Bateria për aparatin e dëgjimit, që mban në vesh. Bateria edhe për telekomandën. E ka zgjedhur të bardhë. Krejt ndryshe është telekomanda e televizorit të vogël, që kemi në në dhomën tonë. Nuk shërben për të ndryshuar stacionet. Nuk është as kufiri ndarës mes meje dhe sime shoqëje. Zë vend mbi shtrat. Telekomanda duket si fëmija që ime shoqe aborton çdo natë.

E di mirë. Nuk ma fal. Ka të drejtën e botës. Në dhjetë vitet që jetojmë së bashku, trupi i saj është bërë gati 120 herë. E beson dot këtë? 120 fëmijë! 120 fëmijë prej barkut të saj do mungojnë përgjithmonë në popullsinë e botës! 120 fëmijë të zhdukur. Të paardhur në jetë. Vetëm e vetëm se unë, sipas saj, nuk i dua fëmijët dhe që, po sipas saj, kam kryer një

ai të dalë. – Fillojmë pa humbur kohë me titujt e faqes së parë... – Babaaa! Ulee! Im atë bindet. U! zërin e televizorit. Do kisha dashur të ulërinte. Dua një vdekje dinjitoze! Nuk dua të vdes këtu! Nuk dua të vdes këtu! Të madhe! Madhështore! Mësove diçka, i them vetes. Pavarësisht nga vendi se ku jemi ulur: para laptopit, si unë, në cep të shtrimit, si ime shoqe, mbi stol si nëna ime, mbi krahun e kolltukut, si vajza jonë apo mbi rrethin e halesë: ne bashkohemi rreth televizorit për të dëgjuar të njëjtën gjë: se po vdesim!

Pamja 6: Jam shtrirë. Përgjumem. E-maili është hapur. Nuk është BOTUESI, që pres pasi i kam dërguar synopsisin. Është punonjësi ambasade. Pas pune bën kërkime mbi të drejtën zakonore në Kanun. Lexoj tekstin e tij. Nuk kam shtuar 300 por 500 gramë. Lexoj deri në fund e-mailin. Fuck! Ishte çmendur? Nuk ishte hera e parë që porosiste tek unë, por këtë herë ishte kishite porositor kurrë më parë. Çfarë? Një vrasje. [I dukem vrasës? Me pagesë? Qenka kriminel, që përkthej? Si e do? Me tritol? Të telekomanduar? Apo me silenciator? I kthehem e-mailit. Nuk duhet të ishe aq i papërgjegjshëm, i them. Edhe vajza jonë e di se muret kanë veshë? Si t'u them? Na falni, zotërinj. Nuk e kishim fjalën për vrasje, por për gjueti për derra, shpezë dhe arinj? Kështu t'u them, kur të më marrin në pyetje? Zotëria nga ambasada studion Kanunin. Nuk porsit vrasje. Ju me siguri e dini se gjoha e vrasjes, njëlljoji si gjoha e fajeve të randa faqe katunditë zgjidhet njëlljoji si për trathiti? Por diplomatit qe çmendur. Kishte përdorur më të gabuarë dat e fshehin si porosi të thjeshtë, për të cilën vetëm strukturat e larta të NATO-s

“PARANOJA”



duhet të përfundojë normën ditore të dialogëve. Play. Fjalët e para janë të bolshëvikut të ri, që i thotë Doktor Zhivagos:

– That's right! Juri! I adapt yourself! E përsëris me zë të lartë, derisa të më pëlqejë përkthimi.

– Lëri filmat djalë, ma kthen im atë, duke lartuar nënën nga dera e banjes. – Kjo botë ka vend për njerëz të zakonshëm. Si unë dhe si ti. Ndaj gjej një punë ose...!

Ime bijë vrapon nëpër korridor. Kthehet nga dera e banjes dhe flet me tim atë: – Pyetje 100 milion! Cili është Ligji i Tretë i Newtonit? Ajo nuk i përdor kur-

holokaust. Aty ku duhet të ishin 120 fëmijë, që nuk erdhën në jetë për fajin tim, kemi një telekomandë. Të zezë. Si gjak të mpiksur menstrual.

– Ku u gjet kjo shëmtirë? Ta kishim së paku të bardhë, kishte thënë ajo.

Mbaj këmbët. Para televizorit. Stacionet ndryshohen sikur xhindi të ketë hyrë në shtëpi. Babai qenkësh gjallë. Film. Emisione gatimi. Mund të mos i ketë mbetur fuqi për të ndryshuar botën, siç kishte mësur nga Manifesti komunist, por mbledh forcat nga haleja për të ndryshuar stacionet. Fillon rubrika e dashur. Leximi publik i gazetave në TV. E di. Ka ardhur koha që

dhe as *dispatch*. Kishte tjetër emër: *Execution*.

Vonë, i them, duke u kthyer në krahun tjetër. I sheh ata spurdhjakët që thejnë passwordet. Po ish-fuksat, që janë strehuar si ekspertë nëpër banka, i sheh? Fërkojnë duart nga kënaqësia, që na futën të dyve në lak! E kanë hapur e-mailin tënd. Nuhatën kërrmën! Si të sillen tani: si dinakë si tu hafë? Mos ndoshta pas naivitetit tonë fshihet kurthi i mbuluar me goja 50 guetarë, gjysma me armë si gjysma pa armë, që vrasin së bashku veç një lepur dhe e ndajnë në 50 pjesë. Ndonjë raport i koduar, që ambasadat e fshehin si porosi të thjeshtë, për të cilën vetëm strukturat e larta të NATO-s

dhe INTERPOL-it kanë dijeni? Si? Të duket si filmi *A Beautiful Mind*, ku Russell Crow dekodon mesazhet e fshehura në revista dhe gazeta të rëndomta? Kam parë shumë filma? T'i lë filmat? Paska të drejtë im atë?

Hap sytë. Shija që ndjej në qiellzë, është e përafërt me atë që duhet të lërë grepi i ndryshkur në gojën e peshkut. Më halet. Kam nevojë. Të përtyp. Më duhet t'i jap zemër vetes. Kë përgojnë? Mua? Po them diçka për veten: Jam njeri i rëndomtë. Njeri që përkthen ç't'i vijë ndoresh. Filma të vjetër: Biblën në version të thjeshtuar për fëmijët. Etiketa ilaçesh. Fjalëkryqe. Doracakë përdorimi të elektroshtëpiakeve. Jam paguar si përkthyes ligjesh europiane për afërsi institucionale me Europën. E di. Emri im si përkthyes nuk do të shënohet askund. As në ndonjë kapak libri. As mbi varr: Ka nisur që herët. Tek im atë.

Ngrihem. Bëhet gati të zbrësë për ta pirë kafënë. Tri mundësi. Zürich-London-Bruxelles. E di. Nëse pas këtij e-maili më gjen ndonjë gjë e ligë, të bie në dashuri me përkthyesen që spërdridhet apo të bie në burg, nuk mund të mbështetem tek ai. Edhe po erdhi të më vizitojë, vjen të ma plasë në fytyrë:

– Ta kisha thënë! Gjej punë! Be geniouos or Find a job! Nuk je gjen!

Fjala bir do mungojë.
– Ke ngjyrë të zbehtë. Bëji analizat. Feçe. Urinë.

Pamja 7: Dolën të gjithë. Babai për kafe. Vajza për në shkollë. Gruaja për të zgjatur flokët me flokë falsë dhe për të vënë thonj e qerpikë artificialë për rolin e ri të princeshë Fionës. Del edhe nëna për pazar. Mbetem vetëm. Me dashnorin e sime shoqeje. Richard Salterin. Megjithatë shtëpia është e ngushtë, nuk e duroj dot vetminë. Mbërrinj në ballkon. Prej aty shoh edhe kafenenë e vogël, ku shokët e fëmijërisë mblihen për baste, konjak, raki dhe birrë vendi të lirë vendi. Dëgjoj Jarin, që përdorur fjalët me kursim: – Jaro, birrë, raki: meze salcë e sallatë! – Erdhi...! – Pa qepë...! – Kuptohet...! – Me vaj...! – E di...! – Jaro! – Krizë!

Zbres shkallët. Në të gjitha dyer ka sy magjikë. Kush hyn e kush del, kush shan e kë pëshqytin dhe kush i flak plehurat nga ballkoni. Jo vetëm unë. Të gjithë mendojnë se dikush i përgjon. Në sheshpushimin e katit të tretë takoj fqinjin. Më këshillon të ruhem. Nuk e humb kohë.

– Nga të gjithë, më thotë. Sidomos nga shitësit ambulante. Duken si të këputur, por na spiunojnë fort. Na e bëjnë skanerin nga ato që fusim në çantë. Pse, thua ti, u shpikën qeset plastike, vazhdon? Kushtokan më lirë...? Joo! Qeset plastike u shpikën që të na kenë nën kontroll. Radiografi. E di si u zbatua skema? Kam parë një dokumentar. CIA investoi. Dha para. Që kur qeset plastike hynë në jetën tonë ata e dinë se cilët jemi. Se në çfarë çfarë hamë, apo jo, profesor?!
Nuk di pse më quan ashtu. Për të më fyer, ndoshta.

– Dikur na përgjonte vetëm Sigurimi. Tani na përgjonnë të gjithë, dëgjova me t'u futur në kafenenë e Jarit.

– Ja, shikoje, tha njëri prej shokëve, duke treguar Jarin me sy. Mendon se mund ta blesh me bakshish? Sado që t'i japësh, i duket pak.

– Ruh! Nga të vjetrit, sidomos.
– Ul! Pse nuk ulesh. Prit ta pastrojme tavolinën, tha shoku tjetër dhe filloi të kontrollonte me gishtrinjin nën mbulesë.

– Pastër?
– Pastër.
Zër vend.

– Lypsit janë edhe më të këqij, vazhdoi ai. Tre turne punojnë. Ata që lajnë xhamat e makinave të semaforët janë hic. Tjesh mbledhi informacion. Kaq. Lypsit janë të rrezikshëm. Apo jo?

Mbledh supet. Jam si ai që po i zbulohet një botë.

– Ç'pandeh ti se bisedojnë, kur mblihen te klubi i lagjes në mbrëmje? Të dukun gjë si qyqarë? Veç t'i dëgjosh. Ky ka! Ky nuk ka! Ky ka, nuk jep! Ky nuk jep se nuk ka!

Këto po bisedonin edhe para se të vijja unë apo e kthen bisedën kur hyra? Përse tani? Dinë gjë për e-mailin? T'u them se më përgojnë? T'i këshilloj të mos bëjnë kurrë

pazar me qese plastike?

Paguaj edhe nga një raki, birrë me meze për shokët dhe marr rrugën drejt redaksisë.

Pamja 8: Do jem këtu derisa të vijë mesnata. Derisa të mbyllet edhe faqja e fundit e fjalëkryqeve. Që të mos më pyesin pse e kam zbehtësi në fytyrë, filloj t'u rrëfej kolegëve të redaksisë mbi paranojnë që ka pllakosur dhe se nga lagjia ime mund të na molepsë të gjithë.

– Si te filmi Verberri, e kujtoni, pakashumë?

Në vend që të cuditeshin, ata më vështronë në sy. Ngultazi. Hetueshëm. Nuk

timet e tyre i kalojnë shtetit dhe shteti. Falë romëve dhe evgjitëve, shteti di gjithçka për ne. – As këtë nuk e kupton? Romët dhe evgjitët mbajnë shtetin në këmbë. – Janë aset. Kupton? – Shtetin, thotë. Botën, duhet thënë. – Shteti është pjesë e organizmave euroatlantike, apo jo? Shteti përpilon lista. Raporte. – CIA. NATO. OKB. OSBE. KFOR. UNCHR. – Të gjithë. – E kupton tani se ku përfundojnë plehurat tona!? – Merr vesh se asgjë nuk është mbeturinë apo vjetërsirë. Çdo gjë riciklohet? E sheh se evgjitët dhe romët që ti nënvlefeson janë të rëndësishëm për ndërkomëtarët? – Aty mbërrijnë të

erët, as policët, as lypësit dhe as ndërkomëtarët. Kupton?

Tund kokën.
– E fundit fare dhe e lëmë për sot! Bli një trastë leckë, si të gjyshërve. Torbë. Jemi të rrethuar, vëlla! Por, por t'ua them të tjerëve më marrin për të çmendur. Nga të gjitha anët na survejojnë. Më keq se atëherë. Dhe ai, njevoj si ime shoqe, nuk e përdor fjalën diktaturë. Thotë atëherë.

Pamja 9: Ka zbardhur. Kthehem. Në shtëpi. Më pret e-maili që mbërriti mëngjesin që shkoi. Kam tri mundësi. *Delete!* *Spam!* *Archive!* Njëlloj si im atë. Kafë Zürich. Bruxelles. London. Çfarë duhet të bëj me e-mailin



marr vesh se kush flet dhe kush hesht, ngaqë flasin të gjithë:

– Shaka? – Vërtet nuk di gjë, apo bën si trap? – Do na kujtosh të drejtat humane tani? Përbuzjet raciale? Paragjykimet? Homofobitë? – Lëri lypësit dhe kamerierët? Po romët, romët dhe evgjitët e vegjël, i njeh ti? [Pas korigjimit të fundit rreshti me vizë dhe prej këtej e deri në fund fjalët me vizë duhen fshirë] – Nuk na lënë as t'u zbrazemi e t'u themi evgjitë!

– Nuk i njeh ti ata? Mirë që na zgjojnë duke kërkuar hekra t'vjetra me altoparlant, por edhe na spiunojnë kur i fusim në shtëpi gjoja si hamallë? Kujton se janë në pikë të hallit, eë? – Romët dhe evgjitët nuk janë as evgjitë dhe as romë. Janë spiunë! Dhe mos më thuj se nuk të paralamërova! – As mos u gënje? – Mos u bëj sentimental, kur t'i shohësh të zhytur me kokë në kazanët e plehrave! – Të vika keq, kur i sheh si ecin me karrocet e fëmijëve bosh?! Të gjojë! Nuk shumohen dot? Në vend që të përkundin fëmijë, shëtisin me karrocet e mbushura me kanoçe e bidonë!

– Na hapët barkun me gjithë karrocet shterpë të evgjitëve pa fëmijë?! – Detyra e romëve dhe evgjitëve nuk është të mbledhin kanoçe, por t'i bëjnë sytë katër se çfarë hedhim në plehra ne. – Për këtë paguhen. Ja ashtu, me këngë në gojë e me buzë në gaz, sikur shkojnë në aksion, ata gërmojnë qeset tona: lexojnë faturat, kontratat, pagesat, bashkojnë letrat e grisura, grisin ambalazhet, lexojnë çmimet mbi etiketa dhe i çojnë aty ku duhet. – Shkurt, romët dhe evgjitët na njohin më mirë se ç'e njohim ne veten. Ata e dinë se cilat ushqime na bëjnë alergji. Glutenin. Laktozën. Kolesterolin. Përgjindjen e yndyrës. – Evgjitët dhe romët bëjnë inventarin e shtëpisë dhe njoftojnë... – Ku? Kë njoftojnë?, i pyes pa e përmbytur dot veten. – Kë njoftojnë, se më çmendët? – Hajdutët, kë tjetër? – Pse, ç'të tha mendja?! – Njoftojnë dhe vrasësit im pagesë. – Kur policia i kap, zbrërthehen, këndojnë. – Raport

gjitha, ta dish. Ata dinë. Na numërojnë. Edhe pordhët. – Kot ruhesh! Kot! Hiq dorë! Ata e dinë edhe se çfarë po bluanë në mendje dhe se po çfarë po bisedojmë tani. – Sa herë që shtypim butonin e shplarjes së mutit në halë, domethënë, sa herë që dhjesim, kupton, njoftimi shkon taze drejt tyre. Në ndërmarrjen e kanalizimeve, të pusetat që mbledh mutrat e qytetit janë po ata: romët dhe evgjitët, domethënë. Aty luftohet informilitetit. Na bëhet analiza se çfarë hamë e çfarë pimë, sa shpenzojmë dhe çfarë sëmundjesh kemi. – Kot ruhesh! Kupton? Nuk mbrohesh dot! – Edhe se çfarë prezervativ përdor ti: të shtrenjtë apo të lirë, me aromë luleshtrydesh apo trëndafllash, e dinë?, tha ajo që qesh me dhëmbët rruazë, si Pelelope Cruz.

Ndjek përfytyrimin që më çon drejt gropave septike, drejt kanaleve, drejt koshave dhe kavaletave me plehra, drejt porgjeve me jashtëqitjet prej letre, prej qelqi, inertesh, ushqimet e prishura dhe plasmatet e qytetit. Prej aty shoh vendin ku janë propusur ilaçet e skaduara, dorezat e gjakosura të kirurgëve, melçitë dhe tëmthet e hequra, gurët në veshka, këlbazat e veremlinjve, lafshat e syneteve, qelbi e gangrenave, dylli i veshëve, lythet, lesirat e rruara e të qethura para operacionit, thonjtë, nishanet, tumorët dhe gungjet e gishtrinjeve e të këmbëve.

Po të tregoj edhe të fshehtën e fundit, nëse do të shpëtosh. Nëse do paqë, bëje larg pazarin! Sa më larg. Shko aty ku nuk të njeh njeri. Edhe qesen e plehrave. Sa herë që ta duhet ta flakësh jashtë, mos shko në kazanët e plehrave të lagjes! Mos përto! Shko sa më larg! Në lagjen tjetër. Edhe aty mos u ngut t'i flakësh menjëherë. Hape qesen e plehrave ngadalë dhe shpërndaje pjesë-pjesë në qeset e plehrave të tjera. Fut mbeturinat e tua aty dhe nuk kuptohesh kurrë as se çfarë ia dhe as se çfarë pi. Kështu nuk të gjejnë dot as evgjitët, as kameri-

e diplomatit, që ka kërkuar të dijë mbi vrasjet? T'i prish? T'i bëj *Delete!*? Prishen? A zduken? Po sikur edhe brenda koshit të plehrave kompjuterike, aty ku shkruhet *Trash apo Rdeycle Bin* të jetë strehuar ndonjë komunitet romësh dhe evgjitësh, që mezi pret t'i flak në kosh e maillet? Ja, sikur i shoh. Përkjojnë duart gjithë gëzim.

Futem në dhomë. Flënë. Të gjithë. Nëna del në korridor. Më pyet nëse i bëra analizat. Feçe. Urinë Si t'ia shpjegoj? T'i them se është e kotë! Se nuk i bëj analizat. Se dikush duhet të rrijë përmbys, me siguri, derisa të zbulojë se masa që shtohet brenda trupit tim nuk është tumor, as gangrenë e zmadhuar. Është ajo që ime shoqe e ka pikasur në krye ka pasur të drejtë. Jam punishte. Punoj pa rrymë elektrike. Pa avull. Pa naftë. Pa qymyr. Pa erë. Pa bateri. Prodhoj vetëm një mall. 700 gramë mëzri të pastër çdo ditë!

Pamja 10: Duhet ta rifilloj punën aty ku e kam lenë. Vë kufijt në vesh. Minuta 1.30.56. Play. Mbjaj vesh bolshevikun e ri, që po këshillon Doktor Zhivagon.

– Jury! Adapt yourself! Mbjaj shënim: – Përshtatu, Jur! Duhet të përshtatesh!

Dëgjoj zhurma. Dal në korridor. Janë mbledhur të gjithë aty. Im atë. Gruaja. Nëna. Vajza. Richard Salter. Diplomati i huaj. Jari. Shokët e fëmijërisë. Spiunët dhe ata që përgojnë. Njerëzit me të cilët punoj. Komshiu pesimist. Cameron Diaz. Fiona e Shkrekut. Scarlett Johansson. Penelope Cruz. Romët. Evgjitët. Më pyesin se çfarë duhet të bëjnë. Të flasin? Të heshtin? Si vazhdon?

Babai nisat drejt banjës. Me telekomandën në dorë: Para se të hyjë, më thotë:

– Si nuk gjetë një punë për të qenë?
Thuaje fort, e nxis, duke e parë drejt e në sy. Thuaje, atë që dua ta dëgjoj prej teje dhe prej të gjithëve. Thuaje siç e di. Pirdhuni! Zhdukuni! Babai nuk çmendet. Kurrë. Nuk kam harur. Titulli nuk është Paranoja. Më duhet të gjej një tjetër. Zvarritja. Rënia. 300 gramë. Fla-tura dhe lesh i zi.

– ... Gjej punë... Gjej punë, se na çmendë! Dëgjo.

A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Cështja e prishjes apo jo të godinës së Teatrit Kombëtar tregoi se mund të ketë protestë të artistëve, shumë konsekuencë të idesë së tyre, por asesi revoltë për të drejtat. Kjo fjalë e fundit në fjalor gjendet me këtë perifrastim: *Kundërshtim i një grupi njerëzish, që shpërthen me zemërim e me dhunë kundër pushtetit politik ose kundër rendit në fuqi; kryengritje (zakonisht në vendet me sistem shtypës e shfrytëzues).* Shqipëria nuk e ka këtë sistem, por aman ka një drejtim shtetëror që lë shumë për të dëshiruar, sa i përket menaxhimit të problematikave me të cilat hasen fashat shoqërore të ndryshme. Mes tyre janë artistët, që janë nëpërkëmbur shpesh goftë edhe përmes miklimit të tyre apo më shumë akoma komfortit që i është afruar përfaqësuesve të tyre të ndryshëm. Por larg këtyre, arti shqiptar megjithë arritjet e mëdha është shumë i brishtë dhe i pamundur të provokojë revolta, ku të përfshihen dhe fasha të tjera shoqërore. Shqipëria nuk është se e ka shumë prioritet artin dhe më keq akoma në emër të tij abuzohet nga sharlatanët të ndryshëm.

Protesta e artistëve, në fillim të viteve 2000 me një strukturë qeveritare jo shumë të largët me ditët e sotme (*Rama ishte Ministër Kulturë dhe ideatori i një reforme që e përçau komunitetin kulturor, kurse Ilir Meta ishte kryeministër i vendit*), në mësoi se ky komunitet është i paqartë, lehtësisht i shantazhueshëm dhe shumë gati për lirtë.

Zhënjimi i komunitetit të artistëve shtohet edhe për faktin e pagesës së trishtë, por edhe ajo që nuk është bërë gjatë qeverisë socialiste, e cila mëtoi në fillim me titullarët e saj dhe grupin drejtues të bënin një fushatë të gjerë për t'i takuar dhe folur nga afër me komunitetet. Por, gati gjashtë vjet më vonë nga mandati socialist, artistët i frikësohen paq të ardhmes, që lidhet me frikën nga shkurtimet, kontratat, fakte që i bëjnë ta mendojnë çdo gjë ndryshe. Po a mund t'i bashkohen kësaj revolte, që po nis pak nga pak. Kjo mbetet akoma për t'u parë...

A mund të ketë një revoltë të artistëve?!



Mësimet e vitit 2018 na e treguan plotësisht këtë. Ashtu si mendohej nga gjykimi i kthjellët edhe ky mandat qeveritar nuk është se tregoi ndryshime të mëdha për komunitetin artistik, ku problematikat më të mprehta mbesin veç atyre të trajtimit dhe ato ligjore. Libri vazhdon të jetë i mbushur nga pesha e taksave, që po e varfëron shumë autorin dhe njerëzit e procesit të bërjes së librit, kurse komuniteti artistik ka mbetur i kapur në një tollovi të frikshme. Pësia kryesore e vlerësimit mbetet te eprorët e

institucioneve që tashmë e shprehin cinizmin afër dhe jo shumë larg shprehjes së vetë z.Rama. Nuk ia vlen të flitet për Galerinë e Arteve sepse tashmë mënyra e sjelljes së eprorit të saj e tregon hapur këtë, por shqetësimet reale që ka nxjerrë komuniteti i artistëve të operës, vatrës ku filloi protesta e madhe e artistëve dikur. Ata kërkojnë që rregullorja e brendshme të mos jetë mbi dispozitat ligjore, të vlerësohen në borde dhe në rrog, por edhe të kenë kontrata kolektive. Duket se vëmendja ndaj e tyre mbetet jashtë

interesit të titullarëve kurse propozimi i tyre që bordi artistik të jetë më përfaqësues të barabartë nga institucioni dhe komuniteti artistik, nuk po dëgjohej. Artistët e besojnë mundësinë e kontratës kolektive, pasi në këtë kërkesë përkonte edhe një propozim i njërit nga titullarët e Ministrisë së Kulturës, i cili jo vetëm e ka trajtuar por dhe ka dhënë udhëzim të respektohet kontrata kolektive e punës. Varfëria e vendit, e ardhmja e pasigurt dhe kursi pa logjikë ku po shkon ekonomia e bën shqetësimin e artistëve të jetë real, pasi nuk kanë kontrata në xhep. E fundit gjë, që u mbetet, është që t'i drejtohen Gjykatës Administrative si sindikatë.

Zhënjimi i komunitetit të artistëve shtohet edhe për faktin e pagesës së trishtë, por edhe ajo që nuk është bërë gjatë qeverisë socialiste, e cila mëtoi me titullarët e saj dhe grupin drejtues të bënin një fushatë të gjerë për t'i takuar dhe folur nga afër me komunitetin. Por, gati gjashtë vjet më vonë nga mandati socialist, artistët, i frikësohen paq të ardhmes, që lidhet me frikën nga shkurtimet, fakt që i bën ta mendojnë çdo gjë ndryshe. Po a mund t'i bashkohen kësaj revolte, që po nis pak nga pak. Kjo mbetet akoma për t'u parë.

Në stilin e zakonshëm tejet epigramatik, autori i njohur sjell një cikël krijimesh të periudhave të tij të shkuara

“LEXIMI I MURGUT”

Cikli poetik i mbijetesës

NGA MOIKOM ZEÇO

Një murg po lexon, - trupi i Homerit rrëzohet - diku në Jeruzalem, - a në malin e Sinajit, - një buri e të vdekurve - s'nxjerr tinguj, - por proverba të Solomoni! - Dhe murgu lexon - edhe sikur rreth tij - të lëvizin dhe të ikin shekuj! - Murgu hesht, - nga Apokalipsi - dalin ca kuaj me koka gaforesh! - Erdhi koha, - që një kohë tjetër - të vijë - më në fund! - Kush kërcen - tek **Zotërimet e Përrjetësisë?** - Një Hënë inkandeshente - tani rri nën det! - Erdhi koha, - për një tjetër hapësirë - ku bredhin mendime të fshehta! - Erdhi koha, erdhi koha, - që murgu t'i djegë pergamenat antike! - Ca shqyte të - ndryshkura të pikëllimit - janë rrezuar në stralle! - Kush i ruan amanetet - e zogje të vdekur - njëmijë vjet më parë? - Digjen qirinjtë - dhe këmbanat gjëmojnë, - por qyteti ka mbetur pagan, - rrugët e tij - janë të hapura - si subjekte të **Dyshit të Madh!** - Skelete kuajsh - janë grumbulluar - në fushën e muzgut! - Si skelete zotash! - Si hieroglifë - të genieve, - që s'i pamë - dhe s'i pamë kurrë! - Murgu - ngriti ballin - drejt pishtarit të ndezur - të qelës së vetmisë! - Sy të bardhë, - sy të verbër, - si sytë e Jehovait, - që s'u

shfaq asnjëherë - në formën e vërtetë, - Moisiu ju shfaq në mal - si një shkurre, - që digjej, - por s'konsumohej, - më pas - u shfaq si Krishti, - pa asnjë imunitet - nga rrahja e turpeshme - dhe kryqëzimi i frikshëm, - për të mos u shfaqur kurrë më! - Murgu i fandaksur - s'del dot - nga qela! - Mjekra e tij - veç gurëzohet - dhe gjithçka përfundon - në një kaleidoskop stalagmitesh!

1996

SHPIRTRAT E LUMIT

Shpirtra të lumit! - Pse doni - të shkoni - në det? - Shpirtra të lumit, - me supet plot gjethe, - me gjokset plot zogj të vegjël! - Ka mbetur - në kodër - skeleti i një peme - si një timon detar, - i një anijeje, - që s'është më, - pa kapiten, - pa marinarë, pa busull, - pa vela! - Një anije - e së **Panjuhurës**, - që i ka tundur - të parët tanë, - por jo pasardhësit!

1996

DELFINËT PËRRALLORE

Ai e artikulonte - fjalën "**det**", - si askush, - që brenda saj të lëviznin, dhe të vezullonin delfinët përrallorë!

1996

FUGA E VDEKJES

Paul Celan mendon, - për **fugën e vdekjes**, - njerëzit pinë - qumështin e zi - të dritës së natës, - e pinë në agim, - në mesditë, - në mesnatë, - pastaj mihin një varr - në hapësirat e ajrit, - ku nuk është ngushtë, - për t'u shtrirë. - Diku banon një njeri - në një shtëpi me nepërka, - ai dëfrehet dhe shkruan! - Gjermania është gërsheti i artë i Margaritës - të veshur me mug! - Njeriu që shkruan - del nga shtëpia nën yje, - ndjell qentë e zinj - pastaj na urdhëron! të hapim një hendek - e mbi të të kërcëjmë! - Qumështin e zi - të dritës së natës - njerëzit e pijnë, - e pijnë në agim, - në mesditë, - në mesnatë, - e pijnë - e pijnë - dhe njeriu që shkruan zbatimet - mes nepërkave - dhe Gjermania - është prej gërsheti të një bukurie - të veshur me mug! - Na urdhëron - të gërmojmë - më thellë hendekun, - ai tund një revolver, - bërtet, - sytë i ka të kaltër! - Qumështin e zi - të dritës së natës - njerëzit e pijnë, - gërsheti i artë i Margaritës - përhapet si hiri i kohës, - një luan na urdhëron, - vdekja është një usta gjerman, - bërtet, - që edhe varri në hapësirë - të hapet, - atje, ku s'është ngushtë! - Ah, qumështin e zi, - të dritës së natës - të tërë e pijnë, - në agim, - në mesditë,

- në mesnatë - dhe njeriu me nepërka - e me sytë e kaltër, - i ndjell qentë - ai qëllon me plumb - drejt e në shenjë, - një varr qiellor - u dhuron - njerëzve - të gremisur në hendek!

1996

AMFORAT

Në banketin e Kohës, - gostitën Zotat, - të rrethuar nga amforat! - Zotat pijnë me fund, - miliona sy, - që shohin, - por edhe sytë e të verbërve, - zemrat e sundimtarëve - dhe të hijeve, - ditët dhe netët, - i ngrenë amforat - dhe ato janë bosh, - dhe Zotat janë më të fortët e pijancëve, - ata çojnë tek buzët, - zbrazëtinë, - dhe s'derdhin shkumën, - as piklat, - se Zotat s'pijnë - si vdekëtarët e brishtë!

1996

GJËRA QË KALUAN PA U VËNË RE
Claude Roy thotë, - në intimitet, - se ka gjëra të fshehta, - që kanë ngjarë, - njerëzit, - që i panë - dhe i përjetuan, - kanë dyshuar më pas, - dhe gjërat mbetën të fshehta, - përgjithmonë! - Në 12 prill 1883, - në Katanzaro të Kalabrisë - një çunak arbëresh, - dymbëdhjetë vjeç, - i quajtur **Benvenuto Vergilio**, - ndërsa peshkonte - mbi ujërat e

një lumi, - befasi i bëhet, - se hapësira ka katër përmasa, - pra i fekon në tru, - ai zbulim, - që më vonë - do të quhej **Teori e Relativitetit**. - Po çunakut - si i mbeti në kujtesë - më pas - asgjë! - Më 1913, - ai u bë nëpunës - i Zyrës së Tatimeve, - në Regio di Calabria, - u vra në 1915, - në Piava, - i veshur - me uniformë bolsolier! - Më 1979 - kozmonautët amerikanë - në raketën **Apollo** - panë se një skaj - të Galaktikës, - një burim, - që rrjedh, - me një murmurimë të mekur, - sigurisht, - që del - nga muzika e sferave, - që e përfytyroi Pitagora, - dhe Kolonel **Gregu**, - komandant i anijes kozmike - e njoftoi këtë zbulim, - në sallën e kontrollit të NASA-s, - por informata u hodh poshtë, - kjo dukuri - u shpjegua - me kondensimin e avullit, - që mbështille - atë çast, - gallustrat e kabinës raketore! - Në 22 nëntor 1937, - në Pittsburgh të Ohio-s, - me skenën e **Comedy Hall-it**, - iluzionisti Samuel Philips, - me pseudonimin **Profesor Misterili**, - gjatë dhënies së numrit "**Gruaja e sharruar dhe e ringjallur**", - vë re, - se një sharrë e njehmendë, - e mprehtë si brisk roje, - ka zëvendësuar sharrën e rreme, - që ka përdorur çdo mbrëmje, - Ai do të ndërprejë gjithçka, - një forcë e papërbalueshme, - e detyron të vazhdojë, - ta lëvizë sharrën, - kështu i jep fund numrit, - i bindur se ka bërë një vrasje. - Por asnjë pikë gjaku - s' del nga trupi i partneres, - që ngrihet në këmbë, - e pacënuar, - ajo i thotë Profesor Misterilit, - s'e s'ka ndërjerë asgjë, - ndoshta diçka - e ka guduulitur lehtë. - Këto gjëra kanë mbetur të fshehta, - për shumë kohë, - ose për gjithmonë!

1996

DETI ËNDËRRON

Deti ëndërron - për t'u shndruar - në një shumësi formash, - po kush mund të bëjë - nga geometria e kristaleve të borës, - një shtëpi futuriste - për lejeleku e Mjedës? - Tani mjegulla, - kafshë vizuale, - si e ardhur - nga psikika e të pagjumëve! - Muzgu vë flatrat - e një lakuriqi natë! - Dhe kudo ka zambakë - ngjyrë kozmosi! - Vjeshta klith - si grua e kapur nga leshërat! - Para vjeshtës është emblema, - një mburojë bronxi, - ku është vizatuar, - një kokë tigri! - Shumë e vështirë, - t'i afrohes! - Dëgjo: po më rrëfëhet - një portokall - dhe unë s'kam indulgjencja për të! - Po një kalë diçka më paralajmëron - si Kryeengjëlli Gabrieli! - Si po hyjnë tani - këto qiparisë viganë - në të mbretërinë e të folurit njerëzor? - Këta shkëmbë - analfabetë janë, - por dinë t'i lexojnë - fytyrat tona!

1996

KOPËSHTI I MËNDJES

Mendja - është kopështi, - ku prashisin - më shpesh djajtë! - Kthehem tek vetvetja - si statuja - tek origjinali prej mish! - Edhe metaforat plaken - ashtu si kuajt! - Një i vdekur - mori formën e një zogu - dhe më ulet mbi sup!

1996

GJUMI

Adami dhe Eva - po flenë - pranë njëri-tjetrit, - Vetmi e pafund - dhe ja befasi dy drurë - po ecin në pllajë - drejt Zenitit - dhe Hëna po i vështron - e habitur - si të ishin subjekti i dyfishtë - i ëndrës së përbashkët - të Adami dhe Evës! - Tek lulet - dritëson - një mistikë e panjohur! - Adami dhe Eva - po flenë - si dy personazhe - të një teatri, - që ende s'është konceptuar - dhe askush s'e di, - nëse do të ndodhë - diçka e bukur, - apo e tmerrshme! - Adami dhe Eva po flenë! - Dhe s'e kanë idenë, - se jo shumë larg - rrinte zgjuar - Gjarpëri i Madh, - nëse Zoti, Zoti - ka krijuar gjithçka, - ahere dhe Gjarpëri i Madh - është krijim hyjnor, - i padiskutueshëm! - Adami dhe Eva po flenë! - Po flenë, - po flenë - është e lemeritëshme - të zgjohesh! - Ah, të mos zgjoheshin, - të mos zgjoheshin urrë! - Se zgjimi - do të thotë - të lëvizte veprimi - i programuar, - padyshim i pashmangshëm! - Gjarpëri do të tundonte Evën - dhe Eva Adamin - për të prekur sakralen, - të paprekëshmen, **Mollën e Njohjes!** - Dhe Zoti, Zoti, - do t'i ndëshkonte - duke i përzënë - Adamin dhe Evën - nga kopështi i Edenit! - Por tani, - Adami dhe Eva - po flenë, - mos t'i preki askush, - as era të mos fryjë, - asnjë kafshë - mos të ulër-

ijë, - s'ka gjë më të shenjtë, - më të pakufishme, - se gjumi!

1996

QELQI KOZMIK I HESHTJES

Ulu Hënë, - eja, - t'i biesh tastave - të kësaj organoje të habitëshme, - që s'e di asnjëri - se si ka ardhur këtu - në këto shkrepë alpinë! - Ulu Hënë, - s'durohet të heshtja, - thyeje qelqin kozmik, - të heshtjes!

1996

ËNDËRRA DHE REALITETI

Pse **Claude Roy** ka shkruar: - "**Jam në Kioto, - duke ëndërruar - se jam në Kioto?**" - Në një **Natë Halluinu** - unë jam në Durrës, - pa qenë në Durrës! - Mbaje do të jem në Tempujt - e Atlantidës, - që s'dihet, - por të shpikur në ëndërra! - Jam edhe në shekullin XII, - e kam përpara një labirint të Kaosit, - mbas tetë shekujsh, - më duhet ta përfytyroj - nënën dhe babain tim, - në një grackë të rastësisë! - Dhe ëndërroj të jem biri i tyre, - pikërisht për të qenë - biri i tyre!



1996

MBI UJËRAT E MËDHA

Dhimbja ime, - e padukshme, - mbi ujërat e mëdha! - Stuhia, - rri pas shpinës time, - si Fama! - Djersa e yjeve - është për mua, - vuajtja dhe shqetësimi im ekzistencial, - Dora ime errësohet si pishari kur shuhet! - Në këtë vis të zanafillës - dhe pemët kanë ADN njeriu! - Me këtë dorë - nuk mund ta gris - perden e realitetit, - të shoh Zotin, Zotin, - apo veten time!

1996

ZOTAT NA KTHEJNË SHPINAT

Zotat na kthejnë shpinat - pafundësia është e pakapshme! - Ja një ide, - e rrugëtar me mish njeriu, - e arratisur në tru zgogjsh! - A mund ta ribësh këtë det - veç me vështrimin tënd e dashur? - O, natyra fluturuese e fjalëve, - mistika s'ka pranga! - mendoj, - pse vallë - nuk mund të rroj në pambarim? - Këto agime - më grishin - të zhdukem - më në fund!

1996

POMPEU I KUJTESAVE

Rrjedh magma e ndezur - e trurit tim - për të mbyllur, - për të mbuluar - **Pompeun e Kujtesave!** - Dhe unë rrezohem - në shtegun e rrezikshëm - të **Bukurisë në flakë!** - Njëqind jetët e mia, të dikurëshme - unë i fal - veç për një ditë të vetme ngazëllimi - dhe përkorje plot hare!

1996

FJALË TË NDËRMJETME

Zogjtë, - i kam - në dorëshkrime, - si fjalë

të ndërmjetme! - Shumë larg, - shumë larg - qetësia kalbet si mollët! - Dera është e mbyllur, - si valle - je nën lekurën time e dashur?

GAFORET SARKOFAGË

Përpikmëria, - m'i ka skalitur idetë! - Nuk i përkas askujt, - veç fëmijërisë time, - asnjë moshë tjetër, - veç fëmijërisë! - Aty jam - me gaforet, - që ushqehen - me trupin tim! - Gaforet detare - më mbartin - si sarkofagë të vegjël, - bronxi të shndritshëm, hyjnor, - për të mos fshehur, - në thellësitat e Harresës!

1996

KOHA SI MIDIASI

Ca princër të tulipanëve - vijnë të më krijojnë një përrallë! - Në shkretëtira - më purpurohen ëndërrat, - zhapikët qajnë - dhe Koha - si Midiasia - rëren e klepsidrave - e kthen në grimca ari!

1996

DUAR FLUTURUESE

Ja, duart e mia fluturuese - rreth e qark planetit! - Ndërsa yjet - i nuhasin - shputat

1996

DEGË FLLADI

Fluturon një pllëbardhë, - duke zgjatur flurudhën - si një film hollivudian! - Dhe gjethesohet - një degë e kaltër flladi - mbi dritaren e detit!

1996

SYRI I CIKLONIT

Pasthirrat e mia - ngjyrosin akuarele ankthi - mbi botën! - Po syrin e ciklonit - e kam amuletë, - të varur, - mbi gjoks!

1996

FYTI I THARË I KOHËS

Ulërima e tablosë së Munkut - është hieroglifi jashtëtokësor! - Blerimi po derdhet - si doli gëzimi - mbi fytin e tharë të Kohës! - Zogjtë kanë vendosur - të na qullin krejt - në shiun e beftë të cicërimave!

1996

S'DO TË BËHEM MBRET

Dhe nëse më prek rastësisht - krahu i një engjëlli - e di, - që s'do të bëhem mbret! - Ajri shket - nëpër shpinën e zogut, - si një mendim poetik - mbi botën. - Fallosi, - që shumëzon jetët, - është më i plotfuqishëm, - se hesh-ta e shën Gjergjit!

1996

JAM KËTU

Jam këtu, - këtu, këtu, - sy-det dhe vesh-breg, - krahë-kaktuse, - gju-guackë, - shputë-shkumë, - jam këtu, - këtu, këtu, - ball-kometë - dhe pëllëmbë-shtrëngatë!

1996

KARAOKE

Egoizmi i poetit - është i rremë! - Tërë krijimet e tij - s'i përkasin më atij. - Ai vdes, - sapo e lind një libër. - Mbas shumë shekujsh, - tërë librat sëbashku, - mundet, - që vdekjen e tij - ta paraqesin - si një lindje të re, - të pashmangëshme!

1996

FILOZOFIA DHE REALITETI

A është filozofia, - e padobishme - sa dhe loja e shahut? - E nëse filozofia - është interpretimi hipotetik - i realitetit, - s'është pra - vetë realiteti!

1996

PËR FERRIN DHE QJELLIN

Borgesi thotë, - se Zoti, Zoti, - s'ka nevojë për zjarrin përvëlues, - kur trumpetat e **Gjyqit të Fundit**, - do të buçasin, - toka do të nxjerrë mbi sipërfaqe rrupullitë, - të vdekurit e kombeve - do të çohen, - një mal kokë-poshtë, - s' do t'i tregojë nëntë rrrathët, - askush s' do të shohë zambakët, - mbi pllajën e zbehtë, - ku harkëtarit fantazmë, - gjuan drerin fantazmë, - askush s' do ta vështrëjë - ujku prej zjarri, - në pjesën e poshtme - të sketerrës islamike, - as Adamin, - as dhe terrin e ndrithshëm - të poet Miltonit! - Me ankth - e një labirinti të lemeritshëm, - një zjarr ndëshkimi, - do t'i bëjë të nxjerrin tym - shpërtrajt e të mallkuarve! - Në Ferr - humb koncepti i ardhmërisë, - s'ka kuptim - dhe pamja magjike - e një kopështi sekret! - Për të vlerësuar, - të shijnë ditë të virtytshme - Zoti, Zoti - s' do të ketë nevojë - për rrrathët e Ferrit, - për teori koncentrike, - që engjëjt dhe kerubinët - për artin iluzor të muzikës, - nuk do të përdorë, - shkëlqimin e kobshëm të tigrave - nuk do të përdorë - as të verdhën delikate - të perëndimit të Diellit, - mbi dunat e shkretëtirës, - apo për shijen e stër-lashtë - dhe natyrore - të ujit. - Në sublimin e tij - Zoti, Zoti, - nuk ka kopështe, - nuk ka dritë shprese - apo përkujtim! Ferrin e vërtetë të vdekjes - mund ta konceptosh - në kristalin e një ëndërrë, - për ditën fatale, - kur nën trumpetat e Gjyqit të Fundit - vetë planeti mëkatat - do të tronditet! - O Kohë e Njeriut, - me piramidat e mëdha - me ngjyrat e së shkuarës - do të veçohet në hije, - një ftyrë që fle, - besnike - e patjetrueshme, - e palëvizëshme, - ndoshta fytëra, - që do të jetë Ferri, - për të dënuarin, - për të zgjedhurin, - o Parajsë!

1996

MEGJITHATË DO TË VDES

Me një sapun fishekzjarresh - e laj kokën time - të pluhurosar nga shekujt! - Dhe megjithatë, megjithatë, - do të vdes - si zhapiku i vockël - me ëndërrën e lashtë të dimosaurin, - si ushtari i shahut, - i rrezuar mbi skakierë - si një gjeneralisumus, - që kurrë nuk u bë!

1996

B

REVUE

Autori bën një përshkrim të librit të historianit të fotografisë. Duhet përgëzuar z. Vroni për durimin dhe temat interesante që kap herë pas here dhe që e tregojnë një studiues me interesa të larta për foton...

“Pikëllim në një foto të vjetër”

NGA AGIM JANINA*

Titulli “Pikëllim në një foto të vjetër” është një gjetje artistike, shpreh brendinë e librit të studiuesit të pasionuar dhe serioz Qerim Vroni. Është libri i radhës. Pikëllimi si ndjenjë emocionale, mbart në vetvete dhimbjen. Është dhimbja nga humbja. Humbja është thelbi i saj. Humbjet janë të shumta dhe të shumëllojta.

Nga kjo dhimbje vjen edhe krijimtaria e autorit. Si e tillë ardhja e librit nuk është një rastësi. Çfarë e lidh autorin me fotografinë? Ku janë zanafilla dhe rrënjët e tij?

Fëmijëria e njeriut është laborator i më i madh, ku mbrunjtën e gjakohen dëshirat dhe ëndrrat më të mëdha dhe më të bukura.

I vogël, Qerim Vroni ka parë në arkivin e familjes shumë fotografi. Ishin në to të parët e tij. Kishin mbajtur poste të rëndësishme e të larta qeveritare dhe shtetërore. Si të tillë ishin dokumentuar në foto të ndryshme. Djalë i ri, dëgjonte me gjysëm zëri, zulmet dhe bëmat e tyre...

Në njërin prej fotove nga arkivi i familjes ndalej gjatë, shumë gjatë. Emocionohej. E zverdhur nga koha ajo mbante një peshë të madhe. Paraqitej përcjellja e eshtrave të Çerciz Topullit dhe Muço Qullin nga Beratit në shtator të vitit 1936. Tek arkemorti dy burra hijerëndë. Tek njeri i mbesnin sytë. Ishte i ati. Sa krenari ndjente, por nuk mund ta tregonte, nuk mund ta dëshmonte...

...Shpesh do të dëgjonte nga prindërit, “Kujdes me këto foto. Mos ia trego njeriut!”

“Mos ia trego njeriut!” – ishte slogani i shumë familjeve gjatë rregjimit komunist. Ishte i dënuar, i persekutuar. Kjo i sillte vuajtje, jo thjesht shpirtërore, por mbi të gjitha intelektuale, artistike, dokumentare dhe historike. Kërkonte të dëshmonte dhe nuk mundte. Pamundësia kur ia di vlerën është tejet e rëndë. Peshën e saj e mbajti në vite të gjatë.

Sa shumë foto janë retushuar, fshehur dhe dënuar gjatë regjimit komunist! Dhunimi historik ishte i shumëfishtë. Mungonin autorë, foto, studio, vula negativë, filma... pikëllim i thellë.

Takimin me fotografinë Qerimi e ktheu në një synim, në qëllim të jetës. Pasioni rritej çdo ditë. Asht dhe ëndrra se një ditë do ia dilte mbanë t'i botonte.

Rritur në qytetin e Vlorës, ai bashkëjeton dhe e lidh jetën me artistët më të mirë vlonjatë të pikturës, teatrit, muzikës, shkencës. Ky mjedis artistik do t'i japë ëndërrim, por jo krahe.



Në atë sistem as që bëhej fjalë, që ai të botonte apo paraqiste për botim ndonjë studim. Në arshivën e mendjes ato flinin të gjalla. Ishin shumë dhe shtoheshin gjithmonë.

Ishte demokracia që i dha krahe dhe sot, ai numëron me dhjetëra e dhjetëra artikuj studimorë dhe libra të botuar mbi artin e fo-

tografisë. Në vitin 2005 boton librin studimor “Fotografia një grusht diell” dhe më pas bëhet bashkëpunëtor i albumit fotografik “50 Year of University of Tirana in 100 foto” dhe më 2009 boton librin “150 vjet Fotografisë Shqiptare”, si dhe merr pjesë në ekspozita brenda e jashtë vendit.

Fotografia

Nëse ka një art shqiptar bashkëkohor me atë botëror është pikërisht fotografia. Qerimi i ishte drejtuar studimit dhe pasqyrimit të saj natyreshmë, duke sjellë e risjellë në vëmendjen e lexuesve personalitete të shumta të fotografisë shqiptare dhe asaj botërore, të munguar dhe mënjeluar tragjikisht, kur fare mirë mund të përfaqësonin fotografinë shqiptare.



Një vend të veçantë zë botimi i “Fjalorit të fotografisë”, i pari në llojin e tij, në gjuhën shqipe, një vlerë e bukur, që i shërben të gjithë atyre, që merren me studimin e fotografisë.

Nëse ka një art shqiptar bashkëkohor me atë botëror është pikërisht fotografia. Qerimi i ishte drejtuar studimit dhe pasqyrimit të saj natyreshmë, duke sjellë e risjellë në vëmendjen e lexuesve personalitete të shumta të fotografisë shqiptare dhe asaj botërore, të munguar dhe mënjeluar tragjikisht, kur fare mirë mund të përfaqësonin Fotografinë Shqiptare.

Duke iu kthyer librit, autori i drejtohet një teme tejet të prekshme në artin botëror, siç është ajo e vdekjes. Duke iu drejtuar asaj kapet vetë thelbi i jetës. Është binom i përhershëm, ekzistencial, domethënës.

Në libër vijnë të detajuar, që nga foto “Gjon Pali me të bijën”, të cilës i bëhet një studim shterues e deri tek kryevepra e Mikellaxhelos “Pieta” në Vatikan, tabloja “Masakrat” e Zef Kolombit, grupi skulpturor “Shokët e Odise Paskalit, analiza e fotove “Duke u venitur” e fotografit Robinson, “Vdekja e Bismarkut”, ekzekutimi në karigjer elektrike, fotografuar nga Tom Howard, “Vdekja e republikanit”, nga i famshmi Robert Capa dhe deri autorët shqiptarë Kristo Shuli, “Në ditën e varrimit të Papa Llabro Ballamacit, “Vajtimi i Nasim Elshanit” etj., duke u ndalur gjatë tek foto e Kolë Macës, që për nga realizimi, të kujton tablotë e piktorit të madh holandez Rembrandt.

Libri të rrëmben gjatë leximit, jo thjeshtë për informacionin e thellë e të shumanshëm, për temën e patrajtuar më parë, por është edhe një udhëtim profesional përshkrimor dhe analitik i fotografisë.

Duke qëmatur me kujdes e durim Vroni ia del mbanë të dëshmojë historinë e fotografisë, kohën dhe personazhet në të. Është një udhëtim i bukur e mbresëlënës nëpër revista e gazeta të kohës, në Shqipëri e jashtë saj.

Duke qenë një udhëtar vizionar, Vroni zhytet në gjetjen e vërtetësisë së fotografisë, në ndërjegjësimin e vlerës fotografike, si dokument i shkallës së parë. “Hidhet” në Itali dhe shfleton gazetën e kohës dhe gjen në gazetën “La domenica del Corriere” fotografinë Macës... nuk ndalet këtu. Për ta shteruar historinë e fotografisë, bën takime, shfleton revista, gazeta etj., etj., një rrugëtim i gjatë, që shpëllohet bukur dhe me emocion në libër.

Vlerë mbi vlerë e punës hamngjitesë të studiesit Qerim Vroni është qëmtimi, gjetja dhe përrurimi i personaliteteve të fotografisë dhe fotove deri më sot të fshehura, të panjohura për publikun e gjërë, si në rastin e fotografit Kol Maca.

Punëtor i përkushtuar Qerim Vroni po përgatit librin e radhës...

* Studiues arti

Opinioni *i* Ditës

Pse dhe si fitoi zonja AKK, pasardhësja e Angela Merkel?

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... kryetaren e tyre të re, Annegrete Kramp Karrenbauer. Kësisoj, mori fund drejtimi 18-vjeçar i CDU-së nga Kancelarja Merkel, me fjalimin e saj prekës, që u përcoll me ovacione të gjata. Siç dihet, muajt e fundit ato u tronditën deri në kufijtë e mbijetesës politike nga grindjet e brendshme me CSU-në, tatëpjeta e CSU-së "motër", fuqizimi i të Gjellbërve, e sidomos ekstremistëve të AfD-së, që kulmuar me rënien drastike të CDU-së/CSU në zgjedhjet lokale të tetorit në Bavari dhe në Hessen. Në këtë terren të rënduar rrëshqitës, Merkel tërhoqi rikandidimin e saj si kryetare e CDU-së dhe njoftoi se ky do të jetë mandati i saj i fundit si kancelare deri në vitin 2021. Me këtë akt politik vizionar, ajo i çeli rrugën rinovimit të CDU-së, bashkë me alternativat dhe elementet e rinj.

Fushata njëmuajore brenda CDU-së për liderin e ri ishte e gjallë, transparente dhe pa kurrfarë trysnie politike mbi tre kandidatët për kryetar të CDU-së. Ajo qëtesoi ndjeshëm situatën brenda CDU-së, e cila shënoi rritje në sondazhe së bashku me forcimin e mazhit dhe të vetë Kancelares Merkel. E përbashkëta e madhe pozitive për të tre kandidatët ishte mbështetja për Evropën dhe Euro-Atlantizmin, shtimi i rolit ndërkombëtar shumëpalësh gjerman dhe kundërshtimi i ekstremizmit populizmit; gjithashtu, të tre premtuan se do ta ngjisin sërish partinë në kuotën e mëparshme të "artë" 40 për qind, nga 27 që është aktualisht. Debatet e shuma publike, partiake dhe mediatike ndërmjet tyre u karakterizuan nga respekti, kultura, toleranca dhe atmosfera konstruktive, një model i vërtetë për partitë e tjera në Evropë; plus që për herë të parë në 80 vitet e fundit gara zhvillohej mes tre kandidatëve. Kësisoj, demokracia e brendshme u bë fituesja e parë.

Që të kuptohen më mirë "pse"-të dhe rëndësia e fitores së zonjës Karrenbauer, brenda dhe jashtë Gjermanisë, le t'i hedhim një vështrim kalimthi profilit dhe karakteristikave kryesore të të tre kandidatëve.

38-vjeçarja Jens Spahn, ministër federal i Shëndetësisë është deputeti më i ri i Bundestagut, në moshën 22-vjeçare. Njihet si kritikëri i Merkelit qysh kur ishte me Organizatën Rinore të CDU-së. Ai nuk e ka fshehur synimin që të ishte i pari kancelar gjerman, i deklaruar dhe martuar me homoseksual. Në vitin 2008 ai u bë objekt i sulmeve dhe kërcënimeve për shkak të propozimeve aspak favorizuese për pensionistët. Po kështu, ka qenë skeptik dhe kundërshtar i koalicionit me SPD-në. Edhe tezat mbi liberalizimin ekonomik dhe ori-



entimin e CDU-së më djathtas nuk i dhanë rezultat, sepse këtë fushë e dominonte Fridrich Merz me përvojën e tij të gjatë. Ndonëse pretendonte të bëhej kancelar i ri si Sebastian Kurz i Austrisë, i mungonte simpatia publike, duke u cilësuar dhe si "mishërim i padurimit". Për pasojë, Spahn e kishte pothuajse të humbur garën qysh në fillim dhe asnjëherë nuk shkoi më shumë se 10 për qind, madje as në vendlindjen e tij.

Favoriti 63-vjeçar Friedrich Merz është eksponent i njohur i CDU-së, avokat korporatash financiare, orator dhe polemist "par excellence". Europarlamentar dhe deputet në Bundesag nga viti 1989-2008. Pati mbështetjen e hapur të Presidentit të Bundestagut, Wolfgang Schauble, që mesa duket më shumë u prishi punë të dyve. Por: në këtë fushatë, Merz u ballafaqua me disa disavantazhe. Në vitin 2004, kur ishte kryetar i Grupit Parlamentar të CDU-së, ai u "dorëhoq" përballë kundërshtares së tij, Merkel, në garën për kreun e CDU-së. Në vitin 2008, duke mos u pajtuar me Merkel, ai u largua nga politika aktive. Gjatë 10 viteve të fundit, krahas shumë korporatave dhe fondacioneve financiare, Merz ishte kryetar i bordit të "Blackrock", kompania gjigante imobilare dhe u bë multimilioner. Në një intervistë mbi këtë fakt, Merz deklaroi se ai "i përket pjesës së epërme të shtresës së mesme", që nuk "ngjiti" në publik. Problem tjetër për Merz, veç faktit që nuk ka pasur asnjëherë post qeveritar lokal ose federal ishte se për shkak të kaluarës me Merkel, ardhja e tij si "revanshist" në krye të CDU-së mund të ndikonte në largimin e parakohshëm të saj dhe rënien e koalicionit qeveritar, duke provokuar zgjedhjet e parakohshme, aspak të dëshiruara për gjermanët. Edhe pse Merz ka pohuar se nuk do ta bënte

një gjë të tillë, sërish skepticizmi publik ishte i ndjeshëm. Një deklaram tjetër negativ ishte ai lidhur me rishikimin e së drejtës gjermane të azilit. Reagimet e shumta negative që krijoi e detyruan Merz të mohonte veten qysh të nesërmen, por dëmi tani ishte bërë. Ndonëse avantazhi i madh krahasues i tij është kompetenca në fushën e liberalizimit konservator ekonomik, kjo nuk ngriti peshe, sepse me gjithë problemet ekzistuese në disa fusha, në nivelin makroekonomik, gjatë qeverisjes Merkel, Gjermania ka njohur lulëzim dhe begati ekonomike, është përgjysmuar papunësia, ekonomia ka vazhduar të rritet në mënyrë të qëndrueshme etj. Së fundi dhe më e rëndësishmja, ndryshe nga Merkel, Merz kërkonte spostimin e CDU-së më djathtas. Mirëpo, me gjithë nevojën për ndryshim, kjo e trembte shumicën e CDU-së. Sepse vërejtjet e tyre ndaj Merkel kishin të bënin kryesisht me qëndrimin e saj ndaj krizës së azilit në vitin 2015, kur ajo lëshoi deklaratën problematike "Ne do t'ia dalim!" (Wir schaffen das). Ndërsa për ndryshime të tjera, shumica në Gjermani thonë "Nein, danke" (Jo, faleminderit).

Fituesja 56-vjeçare Annegrete Kramp Karrenbauer, ose zonja AKK, siç i referohen shkurt në media, shkoi në fushatë me shumë avantazhe si në aspektin familjar, edhe politik. E rritur në një familje të madhe, bashkëshorte dhe nënë e tre fëmijëve, katolike e zellshme, mbrojtëse e familjes tradicionale, me këmbë në tokë, ose "njëra nga ne" sikurse mendon shumica e elektoratit. Me një përvojë qeveritare të pakrahasueshme me dy konkurrentët e tjerë; në periudhën 2000-2011 mbuloi katër portofole ministrore, të punës, familjes, rendit dhe shëndetësisë, ndërsa nga viti 2011

deri sivjet ishte kryeministër e Landit Saarland. Në zgjedhjet e 2017-ës në atë land CDU fitoi 40 për qind ose numrin më të madh të të votave, falë AKK që është "makinë zgjedhore". Në shkurt të këtij viti, me propozim të Merkel, ajo u zgjodh sekretare e përgjithshme e CDU-së, kësisoj njëh më mirë edhe in-granazhet e makinerisë së CDU-së si në nivel lokal, edhe federal.

Ajo njihet si mbështetëse e vijës centriste të Merkel, ndaj i referohen si "Mini-Merkel", "Merkel bis", "Merkel e Saarland" etj.. Megjithatë, kjo nuk rezultoi ndonjë pengesë apo minus për zonjën AKK, falë dhe fleksibilitetit të saj dhe fushatës pa gabimin më të vogël. Aludimeve si e "përkëdhelura" e Merkel, ajo u përgjigj qartë se "nuk ka qenë asnjëherë në jetën e saj e përkëdhelura e askujt, madje as e nënës së vet, por dhe se nuk mund të ndahet në mënyrë artificiale nga liderja emblematike e ÇU-së dhe Gjermanisë". Ndërkohë, pa mohuar vijën merkeliste, zonja AKK bëri disa propozime alternative për shmangien e mungesave dhe mangësive dhe rinovimin e CDU-së, sidomos lidhur me ashpërsimin e masave ndaj azilantëve të paligjshëm. Në debatet e shumta gjatë muajit nëntor në të tetë rajonet mes mijëra delegatëve, ajo kërkoi t'u jepej fund grindjeve të brendshme, CDU-ja të hapej më shumë ndaj diskutimeve në parti dhe të udhëheqin së bashku. Ndërkohë, kërkoi të diskutoheshin tema të reja, me përgjigje të reja dhe jo të mbeteshin në hullitë ku duan populistët dhe ekstremistët. Së fundi, por jo më pak e rëndësishmja, ndryshe nga 20 vite më parë, kur ishte "parti burrash", falë kontributit të Merkel, sot CDU-ja dhe lidhshipit i saj mbizotërohet nga vajza dhe gra, si në nivel federal, ashtu edhe lokal. Kjo i shtoi pluset për zonjën AKK,

duke krijuar kështu për herë të parë në historinë e asaj partie me Merkel një duo politike të djathtë të spikatur zonjash. Falë këtyre avantazheve, zonja AKK kryesoi vazhdimisht sondazhet, madje me një diferencë mbi 10 për qind ndaj Merz, ndjekësit të saj më të afërt. Kulmin e arriti me fjalën e saj, që ngriti peshtë të 1001 delegatët në Hamburg.

Zgjedhja e saj në krye të CDU-së është mirëpritur menjëherë brenda dhe jashtë Gjermanisë. Ajo jep siguri dhe garancitë e duhura për ecurinë e CDU-së si partia më e madhe gjermane që ka udhëhequr proceset historike në qeverisjen e vendit, në skenën ndërkombëtare dhe ribashkimin evropian, duke drejtuar vendin për 50 nga 70 vitet e pasluftës. Ripërtëritja e forumeve drejtuese do të bëjnë që CDU-ja e Adenauer, Kohl dhe Merkel ta rimarrë veten dhe të vazhdojë të mbetet forca drejtuese e qendrës së djathtë në Gjermani dhe në Evropë. Është një ogur i mirë edhe për zgjedhjet e ardhshme evropiane, sfida më serioze për forcat demokratike të moderuara.

Por edhe pas tyre, do të jenë zgjedhjet lokale në tri lende me plot të panjohura, në një kohë kur dhe SPD-ja në tatëpjetën e saj të pandalshme pas këtyre ngjarjeve madhore ka gjasë të dalë nga koalicioni, duke çuar në fundin e mandatit Merkel dhe në zgjedhje të reja të parakohshme. Gjithsesi, edhe në skenarin më të zymtë, CDU-ja gjermane me zonjën AKK në krye nuk do të "vuajë" më për kandidatën e re për kancelare.

Rrjedhojë tjetër pozitive është se koalicioni qeveritar me Merkel në krye mund të vijojë të punojë, ndonëse mes turbullirash politike, ndoshta deri në fund të mandatit në vitin 2021, të paktën i çliruar nga debatet shterpë dhe grindjet e brendshme që kanë çuar një në mullirin e populistëve. Kjo është tejet e rëndësishme, sidomos në aspektin ndërkombëtar, ku Gjermania dhe Merkel do të vijojë të luajë rolin e saj me një mbështetje dhe më efikase të lidhshipit të CDU-së.

Zgjedhja e zonjës AKK është pritë mirë sidomos Francë, kjo ngaqë veç të tjerash, ajo është frëngjishtfolëse dhe ka qenë për vite në drejtim të forumit frankogjerman. Vijueshmëria e koalicionit të kryesuar nga Merkel është shumë e dëshiruar dhe për rajonin/vendin tonë, sidomos tani kur përballlemi me sfida të mëdha. Ndihma prej 164 milionë euro që qeveria gjermane na akordoi disa ditë më parë është shembulli më i freskët, por jo i fundit i kontributit gjerman.

Po që e rëndësishme, dueti i ri politik Merkel-AKK shton besimin dhe mundësitë që Procesi i Berlinit, që vetë Merkel inicioi katër vite më parë të vijojë dhe konkretizohet në mbështetje të paqes, stabilitetit, demokracisë dhe anëtarësimit në BE.

Opinion i Ditës

Pas protestës së studentëve, ky vend ka prapë shpresë

Nga Blendi Fevziu

(vijon nga faqja 1)

... vërtet. E rikthyen ata që shumë veta nuk i konsideronin prej kohësh. 18-20 vjeçarët. Ata që kanë befasuar me oratorinë, me sjelljen e kujdesshme, me respektin ndaj vetes dhe ndaj të gjithëve në këto 5 ditë.

Ky vend ka shpresë! E ka treguar besimi dhe këmbëngulja e atyre që nuk largohen nga sheshi i tyre, atje, përballë Ministrisë së Arsimit. Duke kërkuar një të drejtë që besojnë se u takon. Ose duke denoncuar një padrejtësi që janë të sigurt që ua kanë bërë.

Ky vend ka shpresë. E tregon fantazia mahnitëse e pankartave që mbajnë në dorë, e parullave që brohorasin dhe e memeve që po bëjnë xhiron e rrjeteve sociale.

Ky vend ka shpresë! Sepse solidariteti nuk paska vdekur ende. Është tek ajo gruaja që u fut në mes të studentëve për t'ju çuar ushqimin që kishte në çantën e saj, te qytetarët që kanë dalë dhe rrinë në trotuaresh anash, te qytetarët në kafene që ngrihen në këmbë ndërsa vargani i studentëve ecën përpara tyre drejt vendit të takimit dhe mbi të gjitha, te qindra mijëra veta, që pavarësisht bindjeve politike, po postojnë çdo ditë në rrjetet sociale imazhet dhe videot e protestës.

Ky vend ka shpresë! Sepse për herë të parë një protestë është thjeshtë dhe vetëm e studentëve. Pa ndërhyrje politike, pa manipulime, pa frymëzime që synojnë tjetër gjë. Është një protestë e studentëve, e tyre dhe vetëm kaq.



Ky vend ka shpresë! Ka shpresë pa hyrë fare në debatin nëse studentët kanë apo jo të drejtë, nëse disa gjëra qëndrojnë e disa jo, nëse janë ngelës apo nxënës ekselentë. Ky vend ka shpresë, sepse tregoi që nuk ka harruar të protestojë. Nuk ka harruar të ngrihet kur beson se i bëjnë një padrejtësi. Se nuk mund të nëpërkëmbet dhe se ka dinjitet. Protesta është dinjitet. Heshjtja dhe

kokulja është nënshtrim, skllavëri. Këto 5 ditë treguan edhe një herë se vlerat demokratike të këtij vendi nuk kanë vdekur ende. Janë aty. Edhe pse duheshin studentët për t'i ngjallur sërisht.

Ndaj duhet t'u themi sot atyre faleminderit! Faleminderit që nuk u bëtë si ne, që nuk ulët kokën, që nuk u bindët kur nuk jeni të bindur për atë që po ju

ofrojnë, që rezistuat e rezistoni në shesh, duke i bindur të gjithë që nuk ka fund pa një zgjidhje.

Faleminderit që jeni dhe ndiheni të lirë! Sepse siç thoshte Albert Kamy: "Liria nuk është asgjë më shumë se sa shansi për një jetë më të mirë!"

Faleminderit që i kthyet këtij vendi shpresën që po i mungonte!

BLUE TOOTH
THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

çdo të shtuar falas me GAZETA SHQIPTARE

HOROSKOPI

DASHI

Ata që janë në një lidhje do marrin vendime shumë të rëndësishme gjatë kësaj dite, të cilat do ua ndryshojnë tërësisht jetën. Me financat tregoni kujdes.

DEMI

Sot debatet në çift do jenë të pashmangshme. Asgjë nuk do shkojë ashtu si ju e keni menduar në këtë plan. Problemet mund të lindin për shkak të situatës financiare.

BINJAKET

Do kaloni momente shumë të lumtura sot pranë partnerit tuaj. Do e keni më të lehtë të flisni hapur dhe qetësisht me të.

GAFORJA

Jeta sentimentale do jetë me e bukur gjatë kësaj dite. Do flisni më hapur me personin që keni në krah dhe me pak durim e qetësi do i zgjidhni edhe disa probleme të vogla që kishit pasur.

LUANI

Me paratë keni një raport jo shumë të mirë. Në dashuri duhet të hidhni hapat e parë drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe debateve.

VIrgjeresha

Dashuria në çift do influencohet pozitivisht nga yjet gjatë kësaj dite. Do ndiheni më së miri dhe do i kushtoni më tepër kohës jetës intime.

PESHORJA

Sot marrëdhënia në çift do jetë pak e tensionuar. Përpuni të zgjidhni problemet me komunikim. Sa u përket financave, gjithçka duket e qëndrueshme.

AKREPI

Dita mund të nisë me debate sot për çiftet, por me kalimin e orëve, situata do përmirësohet. Fatmirësisht partneri do tolerojë më tepër dhe do hapë rrugë.

SHIGJETARI

Edhe pse jeni në një lidhje, do tundoheni jashtë mase sot nga një person që do takoni. Nuk do i mendoni pasojat, por shumë shpejt do e kuptoni gabimin.

BRICJAPI

Ditë e paqëndrueshme kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Nuk do jeni me humor të mirë dhe për çdo gjë do debatoni me partnerin.


UJORI

Ditë shumë e paqëndrueshme kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Nuk do bini dakord për asgjë me partnerin dhe debatet do jenë të pafundme.

PESHQIT

Shmangni debatet në çift. Yjet nuk janë në favorin tuaj në raportet e dashurisë. Në çështjet financiare keni nevojë për një ndihmë të fortë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Janë llogari.
8. Kufizojnë një trup.
10. Janë nocionet e para.
13. Janë vendet si Katar.
14. Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
16. Një pije... dardhe.
17. Janë me marka në armatura.
19. Artikull spanjoli.
20. Një pjesë e sadistëve.
22. Janë shemra.
25. Mund të jenë informacioni.
27. Fillojnë javën.
28. Janë gratë në Marrakesh.
30. Janë dhoma.
32. Një Ardan guvernator i Bankës.
33. Demek s'ka kufij.
35. Janë centralët si Chernobyl.
38. Mbyllin një dyqan.
40. Një impiant hi-fi.
42. Rolet pa re.
44. Një pjesë e parlamentit.

46. Kufizojnë një send.
47. De Filippi e Amici.
49. Pagëzoi Shën Palin.
52. Ushtrohet një me trysni.
54. Victorien dramaturg.
55. Eshhtë edhe ai i Zi.
56. Fillojnë tatëpjetën.

VERTIKAL

1. Hunt aktore.
2. Nolde piktor.
3. Gjysmw siklet.
4. Marsi në Areopag.
5. Janë antena satelitore.
6. Rrihet në fund.
7. Pak tebaizëm.
8. Janë taksat.
9. Një test.
10. Ferrara regjisor.
11. Eshhtë luftë.
12. Kufizojnë citatet.
15. Një lëndë e organizmit.
18. Qureshin edhe Eumenide.
21. Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
23. Eshhtë si baba.
24. Julia i Familja Addmas.
26. Jules shkrimtar.
28. Mafia pa zë.
29. Role pa zë.
31. Eshhtë zbukurim në skenë.
33. Inicialet e Morricone-s.
34. Irene aktore.
36. Kufij në Oslo.
37. George shkrimtare.
39. U shkrua nga Emile Zola.
41. U shit për një pjatë thjerza.
43. Film shqiptar.
45. Me të nxjerrin trarë.
47. Bega komik.
48. Eshhtë yll i skuadrës.
50. Fillojnë ndeshjen.
51. Satelit i Uranit.
52. Inicialet e Dukas kompozitor.
53. Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Ndan kapitujt
8. Emri i Gonçarov.
12. Eshhtë e hollë dhe therëse.
13. Inicialet e Stone regjisor.
14. Eshhtë edhe ajo mistral.
15. Kryeqyteti i Marokut.
16. Ki Moon në OKB.
18. Eshhtë lloj papagalli.
19. Një pjesë e amerikanëve.
20. Gjysmë tandem.
21. Hapet me trapano.
23. Një sigël maunesh.
24. Ishte djali i Odiseut.
26. Eshhtë sherr në shtyp.
27. Artikull spanjoli.
29. Eshhtë zog i verdhë.
30. Mund të jetë kuzhine.
31. Inicialet e Lattuada regjisor.
33. Eshhtë shtet i papës.
35. Mbeten në fund.
36. Pesci aktor.

VERTIKAL


1. Një bukanier.
2. Mosketieri jezuit.
3. Janë zënë në lustë të tillë.
4. Pak analogji.
5. Gishti pa shi
6. Në radhë të parë.
7. Tiriac që qe tenist.
9. Tregohet nga busulla.
10. Kaçaturian kompozitor.
11. Fillojnë natën.
16. Vallëzon me tutu.
17. Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
18. Mund të jenë kursimi.
20. Janë katër në violini.
21. Janë vendet e pazëna.
22. Në mes të Edgar dhe Poe.
24. Janë ato që na përkasin.
25. Këngëtare italiane.
26. Një pjesë e pavjionit.
27. Braktisi Didonën.
28. Mune të jenë lubrifikantë.
32. Lumë në Francë.
34. Kush është... do të pijë.
37. Nolde piktor.
40. Parashitësë zvogëluese.
42. Zanore arabe.
43. Rastet pa set.
44. Pak dramatikë.
45. Maket pa kufij.
47. Inicialet e Nolte aktor.
48. Inicialet e Moravia-s.
50. Kështu përfundin një polic.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

2	9		8	1				
8			4		7	9		2
		1		2	6			
						7	8	1
	7	3		4				
5		2				3	4	
					9	4	7	8
6						5		
4	7			5				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	1	3	4	8	6	5	7	9
7	9	8	3	1	5	4	2	6
4	5	6	9	7	2	8	3	1
3	6	4	1	5	8	2	9	7
9	7	5	6	2	3	1	4	8
1	8	2	7	9	4	3	6	5
5	2	7	8	4	9	6	1	3
6	4	9	5	3	1	7	8	2
8	3	1	2	6	7	9	5	4

Argëtim filozofik

-Gratë vishen për gratë dhe zhvishen për burrat.



-Dinaku më i madh është burri që zgjon dashurinë në shpirtin e një gruaje, pa pasur qëllimin ta dashurojë.

-Kur dikush të largohet, është për shkak se dikush tjetër do të vijë"

"Ndonjëherë ne përpigemi të sklavërojmë gjithçka që duam, thua se egoizmi është e vetmja mënyrë për ta mbajtur botën në ekuilibër".

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	A	M	A	R	S	H	P	R	T
K	A	O	S	I	M	W	K	U	R	A	
S	H	E	N	D	E	T	I	A	N	E	T
A	T	A	T	E	L	E	F	O	N	A	T
K	U	V	E	R	T	A	R	I	T	E	T
A	N	E	R	V	I	S	E	L			
A	R	A	S	M	A	T	R	O	N	A	
R	E	V	O	L	T	A	N	E	S	O	N
K	L	E	R	E	D	G	D	C	R	T	
A	L	I	T	A	R	E	M	A	M	I	
T	A	K	T	E	M	I	L	E	R	A	K
A	R	I	K	T	A	P	I	N	V	A	
B	E	S	N	I	K	U	A	R	R	E	S
A	D	T	M	A	T	E	R	I	A	L	L
T	R	I	M	E	R	I	T	E	D	E	
P	A	R	A	K	A	L	I	M	F	A	T
A	L	I	T	E	R	A	C	I	O	N	I
T	E	M	T	E	H	V	L	I	K		
E	E	A	S	T	O	K	A	T	T	L	A
N	E	T	K	A	L	L	E	P	I		
T	E	S	A	R	A	J	E	M	I	R	O
A	E	M	R	I	K	A	P	A	K	E	T
T	O	T	A	M	A	R	A	A	T	I	

FJALËKRYQI (1)



Thënie të mençura

- Njerëzit duan të ndryshojnë gjithçka dhe në të njëjtën kohë duan që gjërat të mbeten ashtu siç janë.
- Vetëm ata që kanë guxim për të shkruar fjalën "Fund" mund të gjejnë forcën për të shkruar fjalën "Fillim" !!!
- -Për miqtë tuaj në nevojë, dilni përpara. Dhe në qoftë se j'u tradhëtonë, mos u merzit. Ndjeh keqardhje për të që nuk kishin forcën tënde.
- -E kaluara nuk ndryshon, dhe e ardhmja nuk është e nevojshme të ndëshkohet për këtë.

